



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

PUBLIKIM MUJOR | NUMRI 12 / DHJETOR 2014



VËSHTRIM PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR TË KOSOVËS

PËRMBLEDHJE E PUBLIKIMEVE MUJORE
PËR VITIN 2014

**VËSHTRIM PERIODIK MBI
SEKTORIN FINANCIAR
TË KOSOVËS**

PËRGATITUR NGA:

PETRIT BALIJA,
Drejtor Ekzekutiv

KRESHNIK KOSUMI,
Zyrtar për Politika dhe Statistika

Shoqata e Bankave të Kosovës

DATA E PUBLIKIMIT,
29 Janar 2015



**SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION**

Bajram Kelmendi nr.15,

Prishtinë, 10 000,

Republika e Kosovës

Tel. +381 38 246 171

email: contact@bankassoc-kos.com

www.bankassoc-kos.com

PËRMBAJTJA

PJESA I - PUBLIKIMET MUJORE PËR VITIN 2014

VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR - JANAR 2014	5
Sistemi Financiar në Kosovë	5
Asetet e sektorit bankar	5
Depozitat e sistemit bankar	7
VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR - SHKURT 2014	9
Detyrimet e sistemit bankar në Kosovë	9
Struktura e detyrimeve	9
Struktura e depozitave	10
Raporti ndërmjet kredive dhe depozitave	11
VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR - MARS 2014	12
Depozitat sipas maturitetit në sistemin bankar në Kosovë	12
Kreditë sipas maturitetit	13
Kreditë e reja	13
Kreditë sipas aktivitetit ekonomik	14
VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR - PRILL 2014	16
Sistemi i pagesave në industrinë bankare në Kosovë	16
Infrastruktura në industrinë bankare	17
Remitenat	18
VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR - MAJ 2014	19
Të hyrat e industrisë bankare në Kosovë	19
Shpenzimet e industrisë bankare	20
Të ardhurat neto operative të industrisë bankare	22
VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR - QERSHOR 2014	24
Norma efektive e interesit në industrinë bankare	24
Norma efektive e interesit për kreditë e korporatave jo-financiare dhe ekonomitë familjare	25
Norma efektive e interesit për depozitat e korporatave jo-financiare dhe ekonomitë familjare	27
VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR - KORRIK 2014	29
Çka janë kreditë joperformuese dhe si ndikojnë ato në industrinë bankare?	29
Kreditë joperformuese në Kosovë	29
Niveli i kredive joperformuese në Kosovë, vendet e rajonit, evropë dhe botë	31
VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR - GUSHT 2014	33
Çka është SWIFT-i dhe IBAN-i?	33
Anëtarësimi i Kosovës në SWIFT dhe IB AN	34
Regjistri i kredive të Kosovës	35

VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR - SHTATOR 2014 **39**

Historiku i Panairit Financiar	39
Panairi Financiar 2014	40
Konferencat dhe Forumi në Panairin Financiar 2014	41

VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR - TETOR 2014 **51**

Trendet e treguesve kryesor të industrisë bankare	51
Asetet e industrisë bankare	51
Depozitat e Industrisë bankare	52
Treguesit e performancës së industrisë bankare	53
Kreditë jo performuese të industrisë bankare	56
Norma efektive e interesit e industrisë bankare	52

VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR - NËNTOR 2014 **58**

Numri i bankave dhe i të punësuarve në industrinë bankare	58
Depozitat në raport me kreditë e industrisë bankare	59
Depozitat e ekonomive familjare në raport me gjithsej depozitat	60
Kreditë për ekonomitë familjare dhe kreditë sipas sektorëve ekonomik në raport me gjithsej kreditë	61

REFERENCAT **64**

PJESA II - LAJME NGA INDUSTRIJA BANKARE **67**

Lajme nga industria bankare për muajin JANAR 2014	68
Lajme nga industria bankare për muajin SHKURT 2014	70
Lajme nga industria bankare për muajin MARS 2014	72
Lajme nga industria bankare për muajin PRILL 2014	74
Lajme nga industria bankare për muajin MAJ 2014	76
Lajme nga industria bankare për muajin QERSHOR 2014	80
Lajme nga industria bankare për muajin KORRIK 2014	84
Lajme nga industria bankare për muajin GUSHT 2014	87
Lajme nga industria bankare për muajin SHTATOR 2014	91
Lajme nga industria bankare për muajin TETOR 2014	93
Lajme nga industria bankare për muajin NËNTOR 2014	96

VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR

JANAR 2014

SISTEMI FINANCIAR NË KOSOVË

Asetet e sistemit financiar në Kosovë kanë shënuar rritje të vazhdueshme nga viti në vit, duke treguar kështu një trend të qëndrueshëm pozitiv.

Vlera e aseteve të korporatave financiare në Kosovë në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013 arriti në 4.0 miliard euro. Kjo vlerë paraqet një rritje prej 8% të aseteve të korporatave financiare krahasuar me periudhën e njëjtë nga viti i kaluar.

Në kuadër të aseteve të korporatave financiare, sektori bankar në këtë periudhë përbën pjesën kryesore të sistemit financiar me 2.9 miliard euro, e cila krahasuar me periudhën e njëjtë nga viti kaluar ka shënuar rritje prej 6.1%.

Fondet pensionale përbëjnë 854 milion euro të gjithsej aseteve të sistemit financiar, përderisa asetet e institucioneve mikrofinanciare kanë vlerën prej 111.8 milion euro. Vlera e aseteve të kompanive të sigurimit ka arritë në shumën 131.6 milion euro, që krahasuar me vitin e kaluar paraqet një rritje vjetore prej 0.9%.

ASETET E SEKTORIT BANKAR

Nga struktura e aseteve të sistemit bankar pjesën kryesore të saj e përbëjnë kreditë dhe lizingu me 61.2% të tyre. Pas kësaj rradhiten paraja e gatshme dhe bilanci me Bankën Qendrore të Kosovës me 14.9%, bilanci me bankat komerciale me 10.2%, letrat me vlerë 9.4%, përderisa pjesën tjetër e përbëjnë asetet fikse dhe të tjera.

Asetet e sistemit bankar në Kosovë (Fig. 1) kanë shënuar rritje të vazhdueshme nëpër vite si rezultat i performancës së mirë të treguar nga bankat komerciale. Kjo rritje ju atribua përveç rritjes së kredidhënies dhe investimeve të bankave në letrat me vlerë, poashtu edhe si rezultat të parasë së gatshme dhe bilancit me bankën qendrore.




Fig. 1 | Burimi: BQK Raporti vjetor 2012 dhe vlerësimi tremujor i ekonomisë nr.4

STRUKTURA E ASETEVE TË SISTEMIT BANKAR

Përshkrimi	Dhjetor 2009 Milionë euro	Dhjetor 2010 Milionë euro	Dhjetor 2011 Milionë euro	Dhjetor 2012 Milionë euro	Dhjetor 2013 Milionë euro
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	322.2	307.5	331.5	425.7	427.2
Bilanci me bankat komerciale	405.6	439.0	329.5	287.9	294.0
Letrat me vlerë	97.0	173.4	202.0	256.6	276.0
Kreditë dhe lizingu	1,289.0	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,798.0
Asetet fikse	43.1	44.0	47.4	57.7	54.4
Asetet tjera	47.7	32.3	41.3	38.1	26.1
Gjithsej	2,204.6	2,454.9	2,649.8	2,829.4	2,875.7

Tabela nr.1 | Burimi: BQK Raporti vjetor 2012 dhe vlerësimi tremujor i ekonomisë nr.4




Figura nr.2 | Burimi: BQK Raporti vjetor 2012 dhe vlerësimi tremujor i ekonomisë nr.4

Siç shihet edhe nga tabela nr.1, aktiviteti kryesorë i bankave nëpër vite ka qenë kreditimi. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013 vlera e kredidhënies arriti në 1.77 miliard euro. Kreditimi nëpër vite ka treguar se ka trend pozitiv të rritjes, përdërisa ky trend i rritjes ishte me 2.2% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013 që krahasuar me vitin e kaluar paraqet nivel më të ulët të rritjes, meqenëse në tremujorin e tretë të vitit 2012 kjo rritje ishte prej 2.8%.

“Vlera e asetëve të korporatave financiare në Kosovë në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013 arriti në 4.0 miliard euro. Sektori bankar përbën pjesën kryesore të sistemit financiar me 2.93 miliard euro apo 72.5% të gjithë asetëve”

Ky trend i ngadalësuar në zgjerimin e kredidhënies mund të jetë si rezultat i zvogëlimit të kërkesës fizibile për kredi apo edhe si rezultat i rritjes së kërkesave dhe kritereve nga bankat në procesin e aplikimit për të marrë kredi, si masë parandaluese të rritjes së mundshme të kredive joperformuese.

Krahas kësaj, bankat komerciale kanë vazhduar trendin e zgjerimit të rrjetit të pikave shitëse të tyre (POS – Point of Sales), bankomatëve dhe numrit të shfrytëzuesve të llogarive e-banking.

Si rezultat i rritjes së rrjetit të pikave, bankat komerciale kanë ofruar edhe kushte më të favorshme për përdoruesit e këtyre shërbimeve. Në figurën nr. 3 mund të vërehet një rritje e dukshme e përdorimit të pagesave elektronike

sidomos të e-banking. Në fund të vitit 2012 janë realizuar 1,499 milionë euro pagesa përmes e-banking, që krahasuar me vitin paraprak paraqet një rritje prej afërsisht 20%. Ky trend i rritjes ka vazhduar edhe gjatë vitit 2013.

E gjithë kjo me qëllim të zvogëlimit të përdorimit të parasë së gatshme e cila është pjesë e strategjisë së industrisë bankare dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Asetet fikse dhe asetet e tjera të bankave kanë shënuar zvogëlim të vlerës së tyre. Kjo vjen si rezultat i zvogëlimit të degëve të bankave krahasuar me periudhën e njëjtë nga vitet e kaluara.

Bankat komerciale janë duke i orientuar aktivitetin e tyre tek shërbimet elektronike, pra tek përdorimi sa më shumë i instrumenteve elektronike të pagesave përmes kartelave, ATM-it, e-banking, debitimit direkt etj.

Sistemi bankar në Kosovë është zhvilluar me sukses dhe sot konsiderohet si një nga sektorët më të qëndrueshëm dhe stabil në ekonominë e saj.




Fig nr. 3 | Burimi: BQK Raporti vjetor 2012 dhe vlerësimi tremujor i ekonomisë nr.4

DEPOZITAT E SISTEMIT BANKAR NË KOSOVË					
Përshkrimi	Dhjetor 2009	Dhjetor 2010	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Shtator 2013
Milionë euro	1,744.8	1,936.9	2,104.0	2,279.1	2,344.7

Tabela nr.2 | Burimi: BQK Raporti vjetor 2012 dhe vlerësimi tremujor i ekonomisë nr.4

DEPOZITAT E SEKTORIT BANKAR NË KOSOVË

Depozitat e sektorit bankar në Kosovë kanë shënuar rritje të vazhdueshme ndër vite dhe në fund të muajit shtator 2013 kanë arritë vlerën në 2.3 miliardë euro. Kjo vlerë krahasuar me periudhën e njëjtë nga viti i kaluar ka shënuar rritje prej 6.3%.

Në kuadër të strukturës së depozitave pjesën kryesore të tyre e përbëjnë depozitat e ekonomive familjare të cilat paraqesin afër 70% të totalit të tyre, përderisa pjesa e mbetur i përket depozitave të ndërmarrjeve private dhe publike, qeverisë dhe të tjera.




Fig. 4 | Burimi: BQK Raporti vjetor 2012 dhe vlerësimi tremujor i ekonomisë nr.4

VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR SHKURT 2014

DETYRIMET E SISTEMIT BANKAR NË KOSOVË

STRUKTURA E DETYRIMEVE

Detyrimet e sistemit bankar në dhjetor 2013 arritën vlerën prej 3,057.5 milionë euro që paraqet rritje vjetore prej 8%. Kjo rritje e detyrimeve është më e lartë se sa ajo e vitit paraprak prej 6.8%. Struktura e detyrimeve vazhdon të dominohet nga depozitat të cilat në fund të vitit 2013 përbëjnë afërsisht 80.1% të gjithsej detyrimeve të sistemit bankar.

Depozitat e sistemit bankar në fund të vitit 2013 arritën vlerën në 2,449 milionë euro dhe që paraqet një rritje vjetore prej 7.5%. Nga tabela nr.1 dhe figura nr.1 e paraqitur mund të vërehet se kemi një trend të vazhdueshëm të ngritjes nëpër vite të vlerës së depozitave, megjithëse kjo ngritje në fund të këtij viti ishte me një përqindje më të ulët se sa viti paraprak.

Kategoria e dytë në kuadër të strukturës së detyrimeve janë mjetet vetanake të cilat përbëjnë 278.5 milionë euro apo 9.1% të gjithsej detyrimeve që paraqet një rritje vjetore 2.9%, gjë që paraqet një burim të rëndësishëm të financimit për bankat afariste.




Fig. 1 | Burimi: BQK - Raporti vjetor (2012) dhe Bilanci i Gjendjes për korporatat e tjera depozituese (2013)

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË SISTEMIT BANKAR					
Përshkrimi	Dhjetor 2009	Dhjetor 2010	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Shtator 2013
Bilanci nga bankat jera	58.5	94.0	40.0	6.0	16.5
Depozitat	1,744.8	1,936.9	2,104.0	2,279.1	2,449.0
Huatë tjera	0.0	0.1	30.4	18.9	13.4
Detyrimet tjera	171.3	160.0	190.1	223.6	243.8
Borxhi I ndërruar	24.4	33.5	31.0	31.0	56.3
Mjetet vetanake	205.6	230.5	254.3	270.7	278.5
Gjithsej (milione euro)	2,204.6	2,455.0	2,649.8	2,829.3	3,057.5

Tab. 1 | Burimi: BQK - Raporti vjetor (2012) dhe Bilanci i Gjendjes për korporatat e tjera depozituese (2013)

STRUKTURA E DEPOZITAVE

Nga struktura e depozitave të sistemit bankar 1,774 milionë euro janë depozita të ekonomive familjare apo 72% të gjithsej depozitave, 397.8 milionë euro apo 16% e gjithsej depozitave e përbëjnë depozitat e korporatave jo-financiare, përderisa 276.3 milionë euro të depozitave e përbëjnë të tjerat. Në tabelën nr. 2 mund të gjeni të dhënat e detajuar mbi strukturën e depozitave në fund të vitit 2013 sa i përket afatit të maturimit dhe ndarjes së tyre sipas kategorive të depozitorëve.

Për nga struktura e afatit të maturimit, depozitat e afatizuara përbëjnë pjesën kryesore të depozitave prej 46.7%, depozitat e transferueshme përbëjnë 36.8%, përderisa depozitat e kursimit përbëjnë 16.5% të gjithsej depozitave.

STRUKTURA E DEPOZITAVE NË SISTEMIN BANKAR 2013									
Përshkrimi (milione euro)	Qeveria Qëndrore	Qeveria lokale	Korporatat tj. Financiare	Korporata tj. Publike	Korporata financiare	Ekonomi familjare	OJSHEF	Jo-rezidentët	Gjithsej
Depozita e transferueshme	0.6	0.1	11.8	16.4	299.6	506.6	22.8	42.9	900.8
Depozitat tjera	0.1	1.0	73.9	55.7	81.0	896.2	3.8	32.3	1,143.9
Depozitat e kursimit	0.1	0.0	0.7	0.1	17.2	372.1	0.2	13.9	404.3
Gjithsej	0.8	1.1	86.4	72.2	397.8	1,774.9	26.8	89.1	2,449.0

Tab. 2 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes për korporatat e tjera depozituese (2013)

“Nga struktura e depozitave të sistemit bankar 1,774 milionë euro janë depozita të ekonomive familjare apo 72% të gjithsej depozitave, 397.8 milionë euro apo 16% e gjithsej depozitave e përbëjnë depozitat e korporatave jo-financiare, përderisa 276.3 milionë euro të depozitave e përbëjnë të tjerat.”

Me gjithë rritjen e vazhdueshme të totalit të depozitave, nga tabela nr.3 mund të vërehet se në fund të vitit 2013 depozitat e afatizuara përbëjnë 46.7% të gjithsej depozitave, përderisa në fund të vitit 2012 kjo përqindje ishte më e lartë apo 51.4% e gjithsej depozitave. Edhe pse kemi përqindje më të ulët në vitin 2013 në lidhje me përqindjen e depozitave të afatizuara, bankat vazhdojnë të kenë një përqindje të konsiderueshme të depozitave të afatizuara në raport me totalin e depozitave.

STRUKTURA E DEPOZITAVE NË SISTEMIN BANKAR 2009 - 2013

Përshkrimi (milionë euro)	2009	2010	2011	2012	2013
Depozita e transferueshme	515.0	670.9	699.0	751.9	900.8
Depozitat tjera	1,229.8	923.2	1,056.8	1,172.1	1,143.9
Depozitat e kursimit	0.0	342.7	348.2	355.0	404.3
Gjithsej	1,744.8	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0

Tab. 3 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes për korporatat e tjera depozituese (2013)

Depozitat e transferueshme në fund të vitit 2013 u ngritën për 6.5%, përderisa në vitin 2012 kjo ngritje ishte prej 2.5%. I njëjti trend i ngritjes ishte edhe për depozitat e kursimit të cilat në fund të vitit 2013 shënuan ngritje për 49.3 milionë euro apo 2.2%, përderisa në vitin 2012 kjo ngritje ishte prej 0.3%.

RAPORTI NDËRMJET KREDIVE DHE DEPOZITAVE

Raporti ndërmjet kredive dhe depozitave në fund të vitit 2013 arriti në 73.7% që nënkupton se shkalla e likuiditetit në sistemin bankar vazhdon të jetë në nivel të mirë.

Siç mund të vërehet edhe nga tabela 4, raporti ndërmjet kredive dhe depozitave në katër vitet e fundit ka një trend në vazhdimësi të pandryshueshëm, gjë që tregon një performancë stabile kur kemi të bëjmë me raportin ndërmjet depozitave dhe kredive. Bankat vazhdojnë të jenë të kujdesshme në procesin e aprovimit të kredive, duke marrë për bazë të gjitha kriteret e nevojshme që klientët duhet t'i përmbushin, në mënyrë që të zvogëlohet sa më shumë ekspozimi ndaj rrezikut dhe të sigurohet performancë sa më e mirë e kredive.




Fig. 2 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes për korporatat e tjera depozituese (2013)

RAPORTI NDËRMJET KREDIVE DHE DEPOZITAVE

Përshkrimi (milionë euro)	2009	2010	2011	2012	2013
Depozita	1,744.8	1,936.9	2,104.0	2,279.1	2,449.0
Kreditë	1,289.0	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8
Përqindja	73.9%	75.3%	80.7%	77.4%	73.7%

Tabela. 4 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes për korporatat e tjera depozituese (2013)

VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR

MARS 2014

DEPOZITAT SIPAS MATURITETIT NË SISTEMIN BANKAR NË KOSOVË

Në fund të muajit shkurt 2014 totali i depozitave në sistemin bankar ka arritur vlerën mbi 2.4 miliardë euro. Nga tabela e prezantuar mund të shihet se në kuadër të totalit të depozitave, pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë depozitat e ekonomive familjare.

Depozitat e ekonomive familjare përbëjnë 68.9% të gjithsej depozitave. Sistemi bankar në Kosovë burim kryesorë të të hyrave i ka depozitat e kësaj kategorie, pra të ekonomive familjare.

Në kuadër të gjithsej depozitave, një shumë të konsiderueshme të tyre e përbëjnë edhe depozitat e korporatave tjera jo-financiare. Depozitat e kësaj kategorie kanë arritë vlerën 323.2 milionë euro që paraqet 7.54% të gjithsej depozitave.

Një burim të rëndësishëm të depozitave paraqesin edhe depozitat e personave jo-rezidentë që në total kapin vlerën mbi 102 milionë euro. Krahasuar me totalin e depozitave, jo-rezidentët përbëjnë 4.1% të gjithsej depozitave.

DEPOZITAT SIPAS MATURITETIT (SHKURT 2014)										
Nr. Sektori	Depozita në jo-euro	Depozita të transferueshme	Depozita të kursimit	Depozita tjera						Totali
				Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vite	Mbi 2 vite	
1. Qeveria		0.6	0.1	0.1	-	-	1.0	-	-	1.8
2.Korporatat tjera depozituese		5.1	-	-	-	-	-	-	0.7	5.8
3.Ndërmjetësit tjerë financiarë		1.9	0.8	1.0	-	1.6	7.1	0.1	0.4	12.9
4.Kompanitë e sigurimit		5.9	-	1.9	0.4	4.9	33.7	13.1	12.0	71.7
5.Fondet Pensionale		0.8	10.5	-	-	-	4.2	0.2	0.3	16.1
6.Ndihmësit Financiar		0.2	-	-	-	-	0.3	-	-	0.4
7.Korporatat publike jo-financiare		10.7	0.2	4.4	6.5	22.0	1.3	1.0	12.2	58.4
8.Korporatat tjera jo-financiare		243.4	7.0	8.0	1.3	2.1	48.5	6.9	6.0	323.2
9.Ekonomitë familjare		466.6	365.3	6.4	15.6	23.3	440.0	191.5	173.8	1682.5
10.OJSHEF		25.1	0.1	-	-	0.1	1.9	-	1.7	28.9
11.Jo-rezidentët		59.0	13.6	-	0.2	0.2	16.7	5.2	7.1	102.1
12.Depozitat në jo-euro	135.0	-	-	-	-	-	-	-	-	0.0
Total	135.0	819.4	397.7	21.6	24.0	54.1	554.7	218.0	214.2	2438.8

Tab. 1 | Burimi: BQK – Depozitat në euro sipas maturitetit (shkurt, 2014)

Kompanitë e sigurimit si dhe korporatat publike jofinanciare përbëjnë poashtu një vlerë të rëndësishme në kuadër të gjithsej depozitave. Më saktësisht kompanitë e sigurimit përbëjnë 2.9% të gjithsej depozitave, përderisa 2.3% e përbëjnë korporatat publike jo-financiare.

Nga totali i depozitave të sistemit bankar, 33.5% janë depozita të transferueshme, 16.3% janë depozita të kursimit, përderisa 44.5% janë depozita të afatizuara. Depozitat në valutë jo-euro përbëjnë 5.5% të totalit të tyre. Pjesa më e madhe e depozitave të afatizuara e përbëjnë ato me afat prej 6-12 muajë apo 22.7% të gjithsej depozitave. Depozitat me afat maturimi prej 1-2 vjet përbëjnë 8.9% të gjithsej depozitave, përderisa ato mbi 5

vjet me afat maturimi e përbëjnë 8.7%.

Sistemi bankar në Kosovë me këtë nivel, përkatësisht strukturë të depozitave, ku pjesën më të madhe të depozitave e ka të transferueshme, duke shtuar depozitat e kursimit dhe ato të afatizuara prej 6-12 muajë, tregon se sistemi bankar nuk mund të jap kredi me afat të gjatë maturimi.

“Nga totali i depozitave të sistemit bankar, 33.5% janë depozita të transferueshme, 16.3% janë depozita të kursimit, përderisa 44.5% janë depozita të afatizuara. Pjesa më e madhe e depozitave të afatizuara e përbëjnë ato me afat prej 6-12 muajë apo 22.7% të gjithsej depozitave.”

KREDITË SIPAS MATURITETIT

KREDITË SIPAS MATURITETIT (SHKURT 2014)							
Nr. Sektori	Kredit në jo-euro	Kreditë sipas maturitetit					Totali
		Deri 1 vit	1-2 vit	2-5 vite	5-10 vite	Mbi 10 vite	
1.Ndërmjetësit tjerë financiarë	-	3.8	0.1	12.9	-	-	16.7
2.Kompanitë e sugurimit	-	2.0	0.3	-	-	-	2.4
3..Korporatat publike jo-financiare	-	0.1	-	-	0.1	-	0.2
4..Korporatat tjera jo-financiare	-	366.5	90.5	474.9	243.1	15.1	1,190.0
5.Ekonomitë familjare	-	60.1	32.7	216.3	212.7	37.6	559.3
6.OJSHEF	-	-	0.1	0.3	0.2	-	0.6
7.Korporatat tjera jo-depozitare	-	-	0.1	2.2	16.7	0.1	19.1
8.Korporatat tjera jofinanciare	5.9	-	-	-	-	-	5.9
Total	5.9	432.4	123.7	706.6	472.9	52.8	1,794.2

Tab. 2 | Burimi: BQK – Kreditë në euro sipas maturitetit (shkurt, 2014)

Në muajin shkurt 2014 vlera totale e kredive të lëshuara nga sektori bankar arriti në 1.79 miliardë euro.

Pjesa më e madhe e kredive të lëshuara nga sektori bankar kanë maturitet prej 2 deri në 5 vite, që në gjithsej totalin e kredive të lëshuara e përbëjnë 39.3%.

Kreditë e lëshuara me afat maturimi prej 5 deri në 10 vite përbëjnë 26.3% të gjithsej kredive të lëshuara, kurse 24% e përbëjnë kreditë me afat maturimi deri në një vit.

Në kuadër të kredive të lëshuara për ekonomitë familjare, pjesa më e madhe e kredive kanë afat maturimi prej 2-5 vite dhe që përbën 38.6% të gjithsej kredive të lëshuara për ekonomitë familjare, përderisa 38% janë kredi me afat maturimi 5-10 vite.

Edhe tek korporatat jo-financiare kreditë e lëshuara me maturitet prej 2-5 vite përbëjnë pjesën më të madhe, respektivisht 39.9% të gjithsej kredive të lëshuara për këto korporata, përderisa 30.7% kanë afat maturimi deri në një vit.

KREDITË E REJA

Gjatë muajit shkurt 2014 janë lëshuar gjithsej 57.8 milionë euro kredi të reja, prej të cilave 36 janë lëshuar për korporata jo-financiare, përderisa 21.8 janë lëshuar për ekonomi familjare. Nga totali i kredive të reja të lëshuara për këtë periudhë, 27% e tyre kanë afat maturimi prej 1-5 vite.

KREDITË E REJA (SHKURT 2014)

Përshkrimi	Kreditë investuese			Kreditë jo-investuese			Kredit me kushte favorizuese	Total
	Deri 1 vit	1-5 vite	Mbi 5 vite	Deri 1 vit	1-5 vite	Mbi 5 vite		
Korporatat jo-financiare	0.7	13.6	3.0	2.6	8.6	1.2	6.3	36.0

Përshkrimi	Kreditë konsumuese	Kreditë Hipotekare			Kredit me kushte favorizuese	Kredit tjera	Total
		Deri 1 vit	1-5 vite	Mbi 5 vite			
Ekonomitë familjare	15.4	-	2.1	1.6	1.8	0.9	21.8

Tab. 3 | Burimi: BQK – Kreditë e reja (shkurt, 2014)

KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK										
Viti	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restorantet	Tregti tjetër	Shërbime tjera	Total
Shkurt 2014	45.3	20.7	135.1	16.7	114.0	643.5	47.8	19.5	169.0	1211.5
Shkurt 2013	44.7	15.6	135.5	14.3	126.3	640.3	40.3	22.8	159.4	1199.2
Shkurt 2012	39.4	17.8	131.7	14.1	126.5	605.5	39.6	25.6	147.7	1147.9
Shkurt 2011	37.6	12.5	128.4	12.3	115.3	542.2	38.9	21.7	137.4	1046.2
Shkurt 2010	38.1	13.5	132.9	9.2	98.8	456.7	37.4	24.8	107.6	918.9

Tab. 4 | Burimi: BQK – Kreditë sipas aktivitetit ekonomik (shkurt, 2014)

Sipas aktivitetit të tyre ekonomik janë lëshuar gjithsej 1.2 miliardë euro kredi deri në fund të muajit shkurt 2014. Nga totali i kredive të lëshuara, pjesën më të madhe të kredive e përbëjnë kreditë e lëshuara për tregti prej 53.1%. 3.7% e gjithsej kredive të lëshuara sipas aktivitetit ekonomik e përbëjnë ato që janë lëshuar për sektorin e bujqësisë.

Është e rëndësishme të pohohet se kreditë bujqësore në vlera reale kanë shënuar rritje të vazhdueshme, megjithëse në mënyrë graduale, përderisa pjesëmarrja e tyre në kuadër të totalit të kredive të lëshuara sipas aktivitetit ekonomik ka mbetur afërsisht e njëjtë.

Prodhimtaria është një sektor tjetër i rëndësishëm si për zhvillimin ekonomik në vend dhe poashtu edhe në përbërjen e kredive të lëshuara në kuadër të sektorit bankar.

KREDITË SIPAS SEKTORËVE

Nga kreditë e lëshuara të sektorit bankar deri në muajin shkurt 2014, 66.3% e përbëjnë kredi të lëshuara për korporatat jo-financiare. Është rëndësishme që të theksohet se përbërja e njëjtë e këtyre kredive në kuadër të gjithsej kredive ka qenë afërsisht e njëjtë edhe në vitet që kemi lën pas.

Ekonomitë familjare vazhdojnë të kenë pjesëmarrje të konsiderueshme në kuadër të gjithsej kredive të lëshuara me 31.1% në vitin 2014. Edhe tek këto lloj kredie të lëshuara, përbërja ka qenë afërsisht e njëjtë në kuadër të gjithsej kredive në krahasim me vitet e kaluara.

KREDITË SIPAS SEKTORËVE 2010 - 2014					
Nr. Sektori	Shkurt 2014	Shkurt 2013	Shkurt 2012	Shkurt 2011	Shkurt 2010
1 Ndërmjetësit tjerë financiarë	16.7	16.1	14.6	7.6	1.5
2 Kompanitë e sigurimit	2.4	3.0	1.5	2.9	0.8
3 Korporatat publike jo-financiare	0.2	0.4	1.3	0.3	7.5
4 Korporatat jo-financiare	1,190.0	1,176.9	1,130.7	1,032.7	907.6
5 Ekonomitë familjare	559.3	540.9	504.6	436.0	377.4
6 OJSHEF	0.6	0.4	0.8	0.1	0.2
7 Korporatat tjera depozitare	-	-	1.0	1.0	1.0
8 Korporatat tjera jo-depozitare	19.1	20.9	31.1	0.7	-
9 Korporatat tjera jofinanciare	5.9	7.0	6.6	2.7	1.5
Total	1,794.2	1,765.6	1,692.2	1,483.9	1,297.5

Tab. 5 | Burimi: BQK - Kreditë sipas sektorëve ekonomik (shkurt, 2014)

VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR

PRILL 2014

SISTEMI I PAGESAVE NË INDUSTRIJË BANKARE NË KOSOVË

Sistemi i pagesave në kuadër të industrisë bankare ka shënuar progres të mirë ndër vite, çoftë kjo përmes rritjes së numrit dhe vlerës së pagesave, e po ashtu edhe përmes zgjerimit të gamës së produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga kjo industri, duke bërë kështu që shfrytëzimi i shërbimeve elektronike në Kosovë të rritet në mënyrë të ndjeshme.

Në fund të vitit të kaluar (2013), vlera e pagesave të realizuara në industrinë bankare ka shënuar vlerën nominale prej 10,234 milionë euro që do të thotë rritje prej 19.5%, krahasuar me fundin e vitit 2012. Përderisa rritja në fund të vitit 2012, krahasuar me vitin 2011 ishte 12.3%.

Rritja e shfrytëzimit të shërbimeve elektronike është pjesë e strategjisë kombëtare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, përmes së cilës synohet që të zvogëlohet ekonomia jo-formale në Kosovë. Andaj edhe sektori bankar në hap me këtë strategji është duke investuar shumë në avancimin e teknologjisë, në mënyrë që të ju ofroj klientëve përdorimin e shërbimeve më bashkëkohore, duke ofruar në të njëjtën kohë siguri më të madhe në përdorimin e këtyre shërbimeve, lehtësi dhe shpejtësi. Kjo e gjitha bëhet me qëllim që të ju përshtatet nevojave të klientëve.

SISTEMI I PAGESAVE					
Përshkrimi (milione euro)	2009	2010	2011	2012	2013
Sistemi ndërbankar i Pagesave	3,976	4,660	5,087	5,681	6,435
Tërheqjet përmes ATM-ve	438	508	608	673	710
Tërheqjet jashtë vendit përmes ATM-ve	144	132	182	200	226
Pagesat përmes POS-ve	58	78	121	150	159
Pagesat jashtë vendit përmes POS-ve	11	16	22	27	33
Pagesat përmes E-banking	607	782	1,192	1,499	2,671
Totali	5,234	6,176	7,212	8,230	10,234

Tab. 1 | Burimi: BQK - Sistemi i Pagesave (dhjetor, 2013)

Nga tabela nr.1 mund të shihet se në kuadër të sistemit të pagesave, rritje më të madhe në raport me vlerën paraprake të saj kanë shënuar pagesat të cilat janë realizuar përmes shërbimit të e-banking. Në fund të vitit 2013, vlera e pagesave të realizuara përmes këtij shërbimi ishte 2,671 milionë euro, vlerë kjo që paraqet rritje prej 43.8%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2012. Të gjitha llojet e shërbimeve elektronike të ofruara nga sektori bankar kanë shënuar rritje të vazhdueshme, krahasuar me periudhat paraprake.

“Në kuadër të sistemit të pagesave, rritje më të madhe në raport me vlerën paraprake të saj kanë shënuar pagesat të cilat janë realizuar përmes shërbimit të e-banking, me rritje prej 43.8%, krahasuar me vitin paraprak të paraqitur në figurën nr.1”




Fig. 1 | Burimi: BQK - Sistemi i Pagesave (dhjetor, 2013)

INFRASTRUKTURA NË INDUSTRIJË BANKARE

Infrastruktura e industrisë bankare në Kosovë në pesë vitet e fundit ka vazhduar të reformohet sipas nevojave të tregut me përqendrim në uljen e kostove operative dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve, me ç'rast vërehet se shërbimet elektronike kanë mundësuar reduktimin e numrit të degëve në disa banka.

Për më shumë, industria bankare në Kosovë në përputhje edhe me strategjinë kombëtare të Bankës Qendrore është duke ofruar gjithnjë e më shumë produkte dhe shërbime të reja elektronike, që nënkupton se klienti gjithnjë e më pak ka nevojë që të shkoj fizikisht tek degët bankare për të kryer një shërbim bankar, duke mundësuar kështu që këto shërbime t'i realizoj nga shtëpia (përmes e-banking) apo drejtpërdrejt nga vendi ku klienti e merrë produktin apo shërbimin (psh. përmes POS apo ATM).

RRJETI I DEGËVE BANKARE NË KOSOVË					
Përshkrimi	2009	2010	2011	2012	2013
Regjioni i Prishtinës	97	100	102	101	102
Regjioni i Prizrenit	46	49	50	50	46
Regjioni i Pejës	52	57	59	59	53
Regjioni i Gjilanit	64	66	64	67	63
Regjioni i Mitrovicës	36	39	35	33	35
Totali	295	311	310	310	299

Tab. 2 | Burimi: BQK - Rrjeti i korporatave tjera depozituese dhe numri i te punësuarve (shkurt, 2014)

Në përputhje me këtë strategji, pra të investimit të bankave në shërbime dhe produkte elektronike, ka bërë që proceset në kuadër të këtij sektori të bëhen më të sigurta dhe më lehtë të realizueshme, duke mundësuar kështu që procesi të automatizohet.

Si rezultat i përdorimit të shërbimeve dhe produkteve elektronike edhe numri i të punësuarve në kuadër të industrisë bankare në pesë vitet e fundit ka mbetë afërsisht i njëjtë, megjithëse industria bankare ka ofruar shërbime dhe produkte të reja në treg, pa pas nevojë që numri i të punësuarve të rritet. Gjithashtu edhe vlera dhe numri i shfrytëzimit të këtyre.

NUMRI I TË PUNËSUARVE NË SEKTORIN BANKAR					
Përshkrimi	2009	2010	2011	2012	2013
Spektori bankar	3459	3610	3728	3727	3549

Tab. 3 | Burimi: BQK – Rrjeti i korporatave tjera depozituese dhe numri i te punësuarve (shkurt, 2014)

REMITENCAT

Remitenat në Kosovë në vazhdimësi kanë shënuar rritje në vlerën e tyre, përderisa këto dërgesa janë transferuar kryesisht përmes sektorit bankar, mirëpo edhe përmes kanaleve tjera sikurse që janë ato për transfere parash apo forma tjera të evidentuara. Rritja e këtyre dërgesave është e evidente nga viti në vit.

Remitenat duke shfrytëzuar kanalet e industrisë bankare në fund të vitit 2013 u rriten për 6.8% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2012.

REMITENCAT - SIPAS KANALEVE					
Përshkrimi (milionë euro)	2009	2010	2011	2012	2013
Bankat	148.8	141.3	139.7	126.5	158.9
ATM	213.1	213.1	225.3	218.5	211.4
Tjera	223.8	229.9	219.8	260.6	250.5
Total	585.7	584.3	584.8	605.6	620.8

Tab. 4 | Burimi: BQK – Remitenat sipas kanaleve (dhjetor, 2014)

REMITENCAT – SIPAS VENDIT					
Përshkrimi	2009	2010	2011	2012	2013
Gjermania	38%	34%	34%	34%	33%
Zvicra	22%	22%	22%	21%	22%
Italia	10%	7%	7%	9%	20%
Austria	5%	5%	5%	6%	2%
Belgjika	3%	3%	3%	3%	1%
SHBA	2%	3%	4%	4%	5%
Suedia	3%	4%	3%	3%	2%
Franca	4%	4%	4%	3%	4%
Norvegjia	3%	3%	3%	2%	2%
Kanada	2%	2%	2%	2%	1%
Britani e Madhe	1%	1%	1%	2%	2%
Danimarka	1%	1%	1%	1%	0%
Finlanda	1%	1%	1%	1%	0%
Holanda	1%	1%	0%	1%	2%
Slovenia	1%	4%	4%	4%	1%
Vendet tjera	2%	5%	5%	6%	2%

Tab. 5 | Burimi: BQK – Remitenat sipas vendeve (dhjetor, 2014)

Pjesa më e madhe e dërgesave të diasporës në Kosovë kanë hyrë nga Gjermania, Zvicra dhe Italia. Vetëm Gjermania dhe Zvicra përbëjnë mbi 55% të totalit të dërgesave të diasporës. Të hyrat nga Italia kanë shënuar rritje nga 9% sa ishte në vitin 2012, në 20% në vitin 2013.

Është e rëndësishme të theksohet se dërgesat e pranuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në pesë (5) vitet e fundit kanë shënuar rritje të vazhdueshme, me ç'rast në fund të vitit 2013 ato paraqesin mbi 5% të totalit të dërgesave të emigrantëve.

VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR

MAJ 2014

TË HYRAT E INDUSTRIJË BANKARE NË KOSOVË

Industria bankare në Kosovë nga viti në vit ka shënuar rritje të vazhdueshme të të hyrave, ku kjo rritje në fund të vitit 2013 ishte për 0.8 milionë euro apo 0.3% më e lartë se sa ajo e fundvitit 2012. Në tabelën nr.1 për dallim nga ajo e vitit 2012 mund të vërehet se në fund të vitit 2013 të hyrat nga interesi për kredi kanë shënuar ulje për 2.4 milionë euro apo 1.2% të gjithsej të të hyrave nga interesi i kredive të lëshuara, përderisa rritje të lehtë kanë shënuar të hyrat nga jo-interesi për 3.9 milionë euro apo 6.2% më shumë se sa në vitin 2012. Kjo tregon se megjithë rritjen e shumës totale të kredive të lëshuara nga kjo industri (2012-2013), të hyrat nga interesi për kredi kanë shënuar ulje, që reflekton se edhe norma efektive e interesit për kredi është ulur. Përderisa të hyrat nga tarifat dhe komisionet kanë mbetur afërsisht të njëjta me periudhën e vitit 2012.

TË HYRAT E INDUSTRIJË BANKARE							
							Milionë euro
Periudha	Të hyrat nga interesi				Të hyrat nga jo-interesi		Totali
	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifa dhe komisionet	Të ardhura tjera operative	
2010	169.6	2.7	3.1	0.4	37.5	3.9	217.2
2011	186.3	4.1	4.2	0.5	41.7	3.3	240.1
2012	194.9	2.0	3.0	0.6	44.2	2.4	247.0
2013	192.5	1.4	2.3	2.0	45.6	3.9	247.8

Tab. 1 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave (prill, 2014)

Siç tregon tabela 1 dhe figura 1 dhe 2 më poshtë, në fund të vitit të kaluar, industria bankare pranoi gjithsej 247.8 milionë euro, me ç'rast pjesa kryesore e të hyrave ka ardhë nga të hyrat nga interesi për kredi të lëshuara në vlerën prej 192.5 apo 77.6% të gjithsej të hyrave. Në fund të vitit 2013, 80% e gjithsej të hyrave të industrisë bankare e përbënin të hyrat nga interesi, ku bëjnë pjesë këtu të hyrat nga interesi i kredive, plasmanet me banka, letrat me vlerë dhe të tjera.




Fig. 1 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave (prill, 2014)




Fig. 2 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave (prill, 2014)

Nga totali i të hyrave, 18.4% e përbëjnë të hyrat nga jo-interesi, përkatësisht të hyrat nga tarifat dhe komisionet, kurse të ardhurat e tjera operative me 1.6%.

Sa i përket vitit 2014, siç shihet në tab. 2 pjesën kryesore të të hyrave të industrisë bankare e përbëjnë të hyrat nga interesi i kredive të lëshuara, përderisa një pjesë të konsiderueshme të këtyre të hyrave e përbëjnë poashtu edhe të hyrat nga tarifat dhe komisionet.

TË HYRAT E INDUSTRIË BANKARE PËR VITIN 2014

							Milionë euro
Periudha	Të hyrat nga interesi				Të hyrat nga jo-interesi		Totali
	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhurat tjera operative	
Prill 2013	63.6	0.5	0.9	0.6	14.5	1.1	81.2
Prill 2014	61.5	0.5	0.8	1.1	14.5	1.1	79.5

Tab. 2 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave (prill, 2014)

Deri në fund të muajit prill 2014 gjithsej të hyrat e industrisë bankare arritën vlerën në 79.5 milionë euro.




Fig. 3 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave (prill, 2014)

Nga totali i këtyre të hyrave, siç shihet në fig. 3, 77.4% e përbëjnë të hyrat nga interesi i kredive të lëshuara, përderisa 22.6% e përbëjnë të hyrat e tjera. Të hyrat nga tarifatat dhe komisionet e përbëjnë 18.2% të gjithsej të hyrave të kësaj industrie. Strukturë afërsisht e ngjashme e të hyrave është edhe në vitet paraprake.

SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE

Totali i shpenzimeve të industrisë bankare, siç shihet në tab. 3, deri në fund të muajit prill 2014 arriti në 65.5 milionë euro.

SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE PËR VITIN 2014

SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE PËR VITIN 2014									Milionë euro
Periudha	Shpenzimet e interesit			Shpenzimet e jo-interesit		Shp.të përgjithshme dhe admin.			Totali
	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp.personale	Shp.të përgjithshme	Shp.tjera nga jo-interesi	
Prill 2013	19.9	0.9	0.7	3.1	15.1	13.8	11.9	7.1	72.4
Prill 2014	15.6	0.8	1.5	3.9	11.5	13.9	11.6	6.8	65.5

Tab. 3 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave (prill, 2014)

Për dallim nga të hyrat e industrisë bankare, struktura e shpenzimeve (fig.4) është më e shpërndarë, me ç'rast shpenzimet e interesit e përbëjnë 27.3% të gjithë shpenzimeve (depozita, huamarrje dhe të tjera), 23.5% e përbëjnë shpenzimet e jo-interesit (tarifat, komisionet dhe provizionet për humbjet e kredive), si dhe 49.3% e gjithë shpenzimeve e përbëjnë shpenzimet e përgjithshme dhe ato administrative.




Fig. 4 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave (prill, 2014)

Shpenzimet e industrisë bankare ndër vite (tab. 4), ashtu sikurse edhe të hyrat, kanë shënuar rritje, megjithëse në fund të vitit 2013 totali i shpenzimeve ishte 219.8 milionë euro apo 2.1% më i vogël se sa shpenzimet e vitit 2012.

SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE

SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE									Milionë euro
Periudha	Shpenzimet e interesit			Shpenzimet e jo-interesit		Shp.të përgjithshme dhe admin.			Totali
	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp.personale	Shp.të përgjithshme	Shp.tjera nga jo-interesi	
2010	49.4	4.8	1.1	7.7	28.3	37.8	37.6	12.6	179.4
2011	51.3	5.6	1.5	8.5	34.8	40.7	33.5	22.9	198.8
2012	57.6	3.2	2.3	8.7	50.3	42.3	35.5	24.5	224.6
2013	58.0	2.6	3.2	9.4	46.1	42.3	35.6	22.5	219.8

Tab. 4 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave (prill, 2014)




Fig. 5 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave (prill, 2014)

Ajo çka ndikoj në uljen e shpenzimeve për vitin 2013 në krahasim me 2012 ishte zvogëlimi i shpenzimeve në provizionet për humbjet e kredive për 4.2 milionë euro apo 8.3% më pak se viti 2012 si dhe zvogëlimi i shpenzimeve tjera nga jo-interesi për 2 milionë euro apo për 8.1% më pak shpenzime.

TË ARDHURAT NETO OPERATIVE TË INDUSTRIËS BANKARE

TË ARDHURAT NETO OPERATIVE TË INDUSTRIËS BANKARE							
							Milionë euro
Periudha	Të hyrat	Shpenzimet	Të ardhurat neto	Fitimet neto (humbja)	Zërat e jashtëzakonshëm	Provizioni për taksat	Fitimi/humbja neto për periushën
	A	B	A-B=C	D	E	F	C+D+E-F
2010	217.2	179.4	37.8	-0.6	-0.1	4.3	32.8
2011	240.1	198.8	41.3	-0.4	-0.7	4.2	36.0
2012	247.0	224.6	22.5	-0.6	-	3.3	18.5
2013	247.8	219.8	28.0	1.2	-	3.2	26.0

Tab. 5 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave (prill, 2014)

Të hyrat e industrisë bankare në Kosovë vazhdimisht kanë shënuar vlera pozitive në raport me shpenzimet e realizuara ndër vite (tab. 5), gjë që tregon se industria bankare në Kosovë ofron një siguri dhe qëndrueshmëri financiare, faktor ky shumë i rëndësishëm në stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik të vendit tonë.




Fig. 6 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave (prill, 2014)

Në fund të vitit 2013 fitimi neto pas provizionit për taksat ishte 26.0 milionë euro, gjë që paraqet një rritje në krahasim me vitin 2012 për 7.5 milionë euro apo 40.5% më shumë. Nga figura numër 6 mund të vërehet se kemi një ulje të fitimit të realizuar nga viti 2011 kur ishte 36 milionë euro, në 18.5 milionë euro apo 48.6% fitim më pak se sa fundviti 2011. Mirëpo trendi rritës ka vazhduar në vitin 2013, përderisa trendi i ngjashëm vazhdon të jetë edhe përgjatë vitit 2014.

TË ARDHURAT NETO OPERATIVE TË INDUSTRIËS BANKARE							
							Milionë euro
Periudha	Të hyrat	Shpenzimet	Të ardhurat neto	Fitimet neto (humbja)	Zërat e jashtëzakonshëm	Provizioni për taksat	Fitimi/humbja neto për periudhën
Prill 2013	81.2	72.4	8.8	0.2	-	1.3	7.7
Prill 2014	79.5	65.5	14.0	0.2	-	1.7	12.5

Tab. 6 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave (prill, 2014)

Të ardhurat neto operative të industrisë bankare pas provizionit për taksat në muajin prill 2014 arritën në vlerën 12.5 milionë euro, gjë që tregon një trend rritës në krahasim me periudhën e vitit të kaluar.

VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR QERSHOR 2014

NORMA EFEKTIVE E INTERESIT NË INDUSTRIJË BANKARE

Industria bankare në Kosovë ka arritë vlerën më të lartë të kredive të shënuar ndonjëherë deri më tani 2013 prej 1,805 milionë euro të lëshuara për ekonominë e Kosovës, përderisa depozitat ishin në vlerë prej 2,449 milionë euro në fund të muajit dhjetor 2013. Sikurse çdo biznes tjetër që vepron në Kosovë edhe industria bankare është ballafaquar me vështirësi dhe sfida të ndryshme gjatë veprimtarisë së saj në 13 vitet e fundit, gjë që ka bërë që shpenzimet operacionale dhe niveli i rrezikshmërisë së tregut në të cilin operojnë të jenë të larta. Sidoqoftë viteve të fundit disa përmirësime janë bërë në këtë aspekt dhe trendet tregojnë që normat e interesit me një trend të ngadaltë janë duke shënuar ulje deri në atë nivel që janë të përshtatshme edhe për bizneset dhe ekonominë familjare në Kosovë.

Nga tabela nr. 1, mund të vërehet që norma efektive e interesit për kredi (paraqet totalin e kostos vjetore të kredisë - interesi dhe komisionet tjera) e industrisë bankare në Kosovë në fund të vitit 2010 ishte 14.31%, përderisa norma efektive e interesit për depozita ishte 3.38%.

NORMA EFEKTIVE E INTERESIT (2010 – 2013)			
Përshkrimi	Kredi	Depozita	Margjina
2010	14.31%	3.38%	10.93%
2011	13.86%	3.62%	10.24%
2012	12.86%	3.74%	9.12%
2013	11.07%	2.39%	8.68%

Tab. 1 | Burimi: BQK - Norma efektive të interesit (dhjetor,2013)

Nga tabela nr.1 dhe nga figura nr. 1 e prezantuar, mund të vërehet se norma efektive e interesit për kredi ka një trend të vazhdueshëm të uljes, sikurse edhe norma efektive e interesit për depozita ka shënuar ulje veçanërisht në pjesën e fundit të vitit që e lam pas (2013).




Fig. 1 | Burimi: BQK - Norma efektive të interesit (dhjetor, 2013)

Ajo çka është interesante dhe e rëndësishme të potencohet është se margjina e normës efektive të interesit ndërmjet kredive dhe depozitave nga viti 2010 ka shënuar ulje nga 10.93% në 8.68% në fund të vitit 2013.

Zvogëlimi i vazhdueshëm i normës efektive të interesit për kredi tregon se industria bankare është duke performuar mirë dhe në mënyrë të vazhdueshme mundohet që për klientët e saj të ofroj kushte më të favorshme, në përputhje edhe me rrethanat dhe ambientin në të cilin afarojnë këto institucione financiare.

NORMA EFEKTIVE E INTERESIT PËR KREDITË E KORPORATAVE JO-FINANCIARE DHE EKONOMITË FAMILJARE

Norma efektive për kreditë e korporatave jo-financiare

Varësisht nga natyra e biznesit, lloji dhe produkti i shërbimit, norma efektive e interesit për kredi për korporatat jo-financiare dallon nga ajo me vlerë më të ultë që është 5.97% (2013) deri tek ajo më e larta 12.90% (2013).

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT PËR KREDITË PËR KORPORATAT JO-FINANCIARE										
Përshkrimi	Kreditë investuese			Kreditë tjera jo-Investive			Mbitërheqje	Linja kreditore	Kredi me kushte favorizuese	
	Deri 1 vit	1-5 vite	Mbi 5 vite	Deri 1 vit	1-5 vite	Mbi 5 vite			Kredi me mbulesë depoziti	Kredi tjera
2010	16.13%	13.95%	-	18.66%	14.44%	-	12.65%	13.27%	7.69%	-
2011	17.07%	13.55%	-	16.40%	13.80%	-	11.78%	12.12%	6.10%	9.88%
2012	15.37%	12.03%	10.19%	15.29%	13.66%	-	10.70%	11.90%	5.92%	-
2013	12.29%	10.93%	9.46%	11.62%	12.90%	-	9.36%	11.03%	5.97%	-

Tab. 2 | Burimi: BQK - Norma efektive të interesit (dhjetor, 2013)

Kjo nënkupton që për klientë që përfaqësojnë rrezik më të ultë dhe kanë një plan biznesorë më të mirë, bankat ofrojnë norma më të mira të interesit.

Nga tabela nr. 2 mund të nxjerrim konkludim se pothuajse të gjitha llojet e kredive të lëshuara për korporatat jo-financiare kanë shënuar ulje nga viti 2010 deri në fund të muajit dhjetor 2013.




Fig. 2 | Burimi: BQK - Norma efektive të interesit (dhjetor, 2013)

Gjithashtu në figurën nr.2 mund të vërehet trendi rënës i normës efektive për kredi për korporatat jo-financiare, veçanërisht i kredive investuese deri në 1 vit, ku nga 16.13% që ishte në fund të vitit 2010 është zvogëluar në 12.29% në fund të muajit dhjetor 2013.

Norma e interesit për kreditë e ekonomive familjare

Edhe tek kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare sikurse tek kreditë për korporatat jo-financiare, norma efektive e interesit ndryshon varësisht nga lloji i produktit dhe kushteve që klienti i bankës i plotëson. Në tabelën nr. 3 të paraqitur në këtë publikim, mund të shohim se vlera më e madhe e normës efektive të interesit në fund të muajit dhjetor 2013 ka qenë 14.41% e lëshuar për produktin e mbitërheqjes, përderisa vlera më e ulët e kësaj norme ka qenë 7.28% për kreditë e lëshuara me kushte favorizuese.

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT PËR KREDITË EKONOMITË FAMILJARE							
Përshkrimi	Mbitërheqja	Kredi me kushte favorizuese		Kredi konsumuese	Kredi hipotekare		
		Kredi me mbulesë depoziti	Kredi tjera		Deri në 5 vite	5-10 vite	Mbi 10 vite
2010	22.57%	6.57%	8.56%	14.56%	-	11.67%	10.26%
2011	16.44%	6.01%	8.58%	14.02%	14.31%	11.99%	10.83%
2012	12.46%	6.11%	7.97%	13.06%	-	10.78%	9.79%
2013	14.41%	4.59%	7.28%	11.69%	-	10.43%	9.00%

Tab. 3 | Burimi: BQK - Norma efektive të interesit (dhjetor, 2013)

I njëjti trend i zvogëlimit të normës efektive të interesit për kredi të ekonomive familjare është përcjellë pothuajse në të gjitha llojet e kredive të lëshuara nga 2010-2013, përfshirë këtu kreditë konsumuese, hipotekare, mbitërheqja apo kreditë me kushte favorizuese. Industria bankare ofron kushte më të mira kreditimi për klientët që ofrojnë siguri më të madhe gjatë tërë procesit të maturimit të asaj kredie.




Fig. 3 | Burimi: BQK - Norma efektive të interesit (dhjetor, 2013)

Nga figura nr. 3 e prezantuar në këtë publikim, mund të shohim se krahas të gjitha llojeve të kredive të cilat kanë shënuar ulje të normës së interesit, mbitërheqja si produkt i veçantë i kreditimit ka shënuar uljen më të madhe nga viti 2010 dhe deri në fund të vitit 2013.

NORMA EFEKTIVE E INTERESIT PËR DEPOZITAT E KORPORATAVE JO-FINANCIARE DHE EKONOMITË FAMILJARE

Sikurse çdo shpenzim tjetër i industrisë bankare edhe depozitat e deponuara brenda kësaj industrie paraqesin një kosto të financimit për vet këtë industri. Kjo për faktin që për depozitat e pranuar, bankat janë të obliguara të paguajnë një normë të interesit.

Margjina e krijuar ndërmjet normës së interesit për kreditë e lëshuara nga industria bankare dhe normës së interesit për depozita të pranuar, paraqesin margjinën e interesit për industrinë bankare. Industria bankare në mënyrë të kujdesshme e mirëmban këtë hendek me qëllim të realizimit të qëllimeve strategjike të saj, ku njëra ndër objektivat më të rëndësishme krahas fitimit është edhe qëndrueshmëria dhe stabiliteti financiar i cili i mundëson qytetarëve të ndihen të sigurtë me mjetet e tyre të cilat i menaxhon ky sektor.

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT PËR DEPOZITA PËR KORPORATAT JO-FINANCIARE

Përshkrimi	Depozitat e transferueshme	Depozitat e tjera											Depozitat e kursimit	
		Më pak se 250.000 euro						E barabartë ose më shumë se 250.000 euro						
		1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6 muaj – 1 vit	1-2 vite	Mbi 2 vite	1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6 muaj – 1 vit	1-2 vite		Mbi 2 vite
2010	0.63%	2.44%	3.08%	3.87%	4.96%	-	5.14%	-	3.74%	-	-	-	-	2.07%
2011	0.86%	2.22%	2.91%	3.53%	4.90%	-	5.05%	2.63%	3.88%	-	5.25%	-	-	2.20%
2012	0.83%	-	2.79%	-	-	-	-	2.67%	4.02%	-	4.75%	-	-	2.15%
2013	0.47%	0.83%	-	1.57%	0.48%	2.86%	-	-	-	-	-	-	3.42%	1.74%

Tab. 4 | Burimi: BQK – Norma efektive të interesit (dhjetor, 2013)

Në tabelën nr. 4 mund të vërehet se krahas uljes së normës efektive të interesit për kredi, industria bankare ka qenë e obliguar të bëjë edhe uljen e shpenzimeve të përgjithshme të financimit të tyre, me ç'rast ka bërë uljen e normave të interesit për depozita nga viti në vit. Mirëpo ajo çka duhet potencuar është se kjo margjinë e interesit ndërmjet kredive dhe depozitave në baza të vazhdueshme ka shënuar ulje.

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT PËR DEPOZITAT PËR EKONOMITË FAMILJARE

Përshkrimi	Depozitat e transferueshme	Depozitat tjera						Depozitat e kursimit
		1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6 muaj – 1 vit	1-2 vite	Mbi 2 vite	
2010	0.55%	2.58%	2.63%	3.15%	4.49%	4.77%	5.14%	2.21%
2011	0.48%	2.49%	2.47%	2.88%	4.21%	4.56%	5.36%	2.06%
2012	0.54%	2.30%	2.46%	2.84%	4.20%	4.52%	4.76%	2.06%
2013	0.50%	1.66%	1.75%	2.03%	2.93%	3.38%	4.01%	1.66%

Tab. 5 | Burimi: BQK – Norma efektive të interesit (dhjetor, 2013)

Edhe tek norma efektive e interesit për depozita, varësisht nga lloji i produktit ndryshojnë përqindjet e tyre. Ajo çka mund të vërehet nga figura nr. 4 dhe tabela nr. 5 është se uljen më të madhe të normave të interesit për depozitat tek ekonomitë familjare e kanë shënuar depozitat me afat maturimi mbi 2 vite, ku nga 5.4% sa ka qenë në fund të vitit 2011, kanë rënë në 4.0% në fund të muajit dhjetor 2013.




Fig. 4 | Burimi: BQK - Norma efektive të interesit (dhjetor, 2013)

VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR KORRIK 2014

ÇKA JANË KREDITË JOPERFORMUESE DHE SI NDIKOJNË ATO NË INDUSTRIJË BANKARE?

Një nga aktivitetet kryesore të industrisë bankare është kreditimi. Bankat gjatë gjithë procesit të kreditimit dhe deri në fazën e maturimit të saj përballen me rrezikun nëse klienti ka potencialin për t'a kthyer kredinë brenda afatit apo kushteve të përcaktuara në kontratë. Në rast se klienti nuk arrinë që të kthejë atë kredi brenda afatit të përcaktuar në kontratë, atëherë themi se ajo kredi është problematike dhe nëse ky problem nuk zgjidhet brenda afatit prej 90 dite, atëherë kjo kredi konsiderohet si joperformuese.

Pasojat në industrinë bankare si rezultat i kredive joperformuese mund të jenë të mëdha, në rast se nuk ndërmerren hapa parandaluese. Kreditë joperformuese ndikojnë negativisht në performancën dhe stabilitetin e industrisë bankare, duke rritur provizionimin, tkurrë kreditimin dhe në raste më të rënda mund të sjellë një institucion financiar në gjendje insolvente.

Gjatë procesit të kreditimit, industria bankare ballafaqohet me rrezikshmëri të ndryshme, përfshirë këtu: rrezikun kreditor, rrezikun e likuiditetit, rrezikut e tregut, rrezikun operacional, rrezikun e reputacionit dhe rrezikun ligjor. Prandaj kemi të bëjmë me një industri shumë të ndjeshme ndikimi i së cilës mund të ketë pasoja të mëdha ekonomike në vend. Në këtë drejtim për këtë industri duhet të ketë mbikqyrje të veçantë nga rregullatori që në rastin e Kosovës është Banka Qendrore e cila e mbikqyrë këtë industri përmes legjislacionit ekzistues në fuqi, por edhe përmes rregulloreve që aprovohen për këtë industri.

Bankat komerciale në Kosovë me qëllim të mbrojtjes nga kreditë joperformuese, ndërmarrin hapa parandaluese në mënyrë që pasojat të jenë sa më të vogla dhe këto të mos kenë ndikim të madh në performancën e tyre.

Rezervat e detyrueshme, ku çdo bankë është e detyruar të deponoj në Bankën Qendrore të Kosovës, paraqesin hapin e parë në mbrojtje të rrezikut dhe i cili përdoret vetëm në rastet kur bankat nuk janë në gjendje që të mbulojnë obligimet e tyre. Provizionimi i kredive është një masë tjetër, ku bankat për çdo kredi të lëshuar paguajnë provizione në BQK. Përveq kësaj bankat janë të obliguara që të mirëmbajnë gjithashtu edhe nivelet e likuiditetit për të qenë në gjendje të paguajnë në çdo kohë obligimet që i kanë ndaj klientëve.

Përveç masave ligjore të cilat janë obligative për bankat komerciale, gjatë procesit të kreditimit për të siguruar kthimin e kredisë kërkojnë që klienti të lejoj si peng për bankën pasuri të patundshme apo kolateral në emër të asaj kredie dhe në rast të moskthimit, banka mund ta përvetësojë atë pasuri deri në masën e dëmit që i shkaktohet bankës nga mos kthimi i asaj kredie.

KREDITË JOPERFORMUESE NË KOSOVË

Në Kosovë kreditë joperformuese kanë shënuar rritje të lehtë nga viti në vit, përderisa në fund të vitit 2013 vlera arriti në 8.5% në raport me bruto totalin e kredive të lëshuara nga industria bankare. Në fund të muajit mars 2014, kreditë joperformuese shënuan vlerën prej 8.4% (BQK - Raporti i Informatave Mujore të Sistemit Financiar nr.5).

Në figurën nr.1 vërehet se rritja e normës së kredive joperformues është zvogëluar në 18.1% në vitin e fundit në krahasim me vitin paraprak kur kjo rritje ishte 35.8%.




Fig. 1 | Burimi: Banka Qendrore e Kosovës –Raporti Vjetor 2013




Fig. 2 | Burimi: Banka Qendrore e Kosovës –Raporti Vjetor 2013

Vlera e kredive joperformues është shumë me e lartë tek ndërmarrjet se sa tek ekonomitë familjare. Kjo mund të vërehet nga figura nr.2 e paraqitur, përderisa sektori i cili ka vlerën më të lartë të kredive joperformues është prodhimitaria me 15.2%, përderisa tregtia me 12.2%. Ekonomitë familjare kanë normën më të ulët të kredive joperformuese me 2.6%.

Industria bankare nga totali i kredive të lëshuara, 66.3% të tyre e përbëjnë kreditë e lëshuara për korporatat jo-financiare (SHBK - Vështrimi Periodik mbi Sektorin Financiar të Kosovës nr.3), që nënkupton se kjo pjesë e konsiderueshme e kredive i atribuohet një mesatareje të kredive joperformuese të ndërmarrjeve norma e secilës është më e lartë. Kjo tregon se bizneset në Kosovë ende nuk ofrojnë siguri dhe qëndrueshmëri financiare, përmes secilës industria bankare do ta kishte më të sigurtë procesin e kreditimit për ndërmarrje.




Fig. 3 | Burimi: Banka Qendrore e Kosovës –Raporti Vjetor 2013

Sikurse e trajtuam në pjesën e parë të këtij publikimi, një nga masat parandaluese që bankat i ndërmarrin për t'u mbrojtur nga rreziku kreditor, përkatësisht nga kreditë joperformuese është provizionimi i kredive të lëshuara. Figura nr.3 e paraqitur, tregon se në fund të vitit 2013 bankat kanë ndarë provizione deri në 110.6% për të mbuluar humbjet e mundshme nga kreditë joperformuese. Kjo nënkupton se bankat janë në gjendje të mbulojnë shpenzimet që mund të vijnë nga humbjet si rezultat i kredive joperformuese.

NIVELI I KREDIVE JOPERFORMUESE NË KOSOVË, VENDET E RAJONIT, EVROPË DHE BOTË

Kosova në krahasim me vendet e rajonit ka normat e përqindjeve më të ulëta të kredive joperformuese, përfshirë këtu Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë.

Kosova në fund të vitit 2013 regjistron kredi joperformuese prej 8.5% në raport me totalin e kredive që industria bankare ka lëshuar për klientët e saj dhe që në vlerë monetare ka qenë 1,805 milionë euro. Nga vendet e rajonit, Shqipëria ka regjistruar vlerën më të lartë të kredive joperformuese me 23.5%, përderisa Serbia ka regjistruar 20.6% nga bruto totali i kredive.

Në tabelën nr.1 vërehet se pothuajse të gjitha vendet kanë një trend rritës të kredive joperformues, veçanërisht në vendet e ballkanit perëndimor. Kosova megjithëse ka arritë që këtë trend ta mbaj në vlerat njëshifrore, megjithatë vlerat tregojnë se kanë një trend rritës.

KREDITË JOPERFORMUESE NË RAPORT ME BRUTO TOTALIN E KREDIVE (%)							
Nr.	Shteti	2008	2009	2010	2011	2012	2013
1	Kosova	3.3%	4.3%	5.8%	5.7%	7.4%	8.5%
2	Shqipëria	6.6%	10.5%	14.0%	18.8%	22.5%	23.5%
3	Ish-RFJ Maqedonisë	6.7%	8.9%	9.0%	9.5%	10.1%	10.9%
4	Mali I zi	7.2%	13.5%	21.0%	15.5%	17.6%	
5	Serbia	11.3%	15.7%	16.9%	20.0%	18.6%	20.6%
6	Bashkimi Evropian	2.8%	4.7%	5.4%	5.8%	6.8%	7.3%
7	Bota	3.0%	4.3%	3.9%	3.8%	3.8%	4.0%

Tab. 1 | Burimi: Banka Botërore - Kreditë bankare joperformuese në raport me bruto totalin e kredive (29 korrik, 2014)




Fig. 4 | Burimi: Banka Botërore - Kreditë bankare joperformuese në raport me bruto totalin e kredive (29 korrik, 2014)

Siç mund të vërehet nga figura nr.4, trendi i kredive joperformuese në Kosovë është më i ulët në krahasim me vendet e rajonit, trend afërsisht të njëjtë me vendet e bashkimit evropian, përderisa ka një trend pak më të lartë se sa niveli mesatar i të gjitha vendeve botërore ku banka botërore bën mbledhjen e këtyre të dhënave.

Mesatarja botërore e kredive joperformuese është më e vogël se të gjitha mesataret e vendeve të tjera të marra për krahasim në këtë publikim, gjë që nënkupton se të gjitha shtetet e rajonit, përfshirë dhe Kosovën kanë normë më të lartë të kredive joperformuese se sa mesatarja botërore në raport me bruto totalin e kredive të lëshuara. Kjo tregon se këto vende duhet marrin në konsideratë këtë faktorë dhe se duhet të punojnë bashkërisht me institucionet përkatëse të vendit në zvogëlimin sa më të madh të efekteve që mund të sjellin deri tek mos kthimi i kredive, meqenëse kreditë joperformuese mund të shfaqen si rezultat i shumë faktorëve të ndërsjelltë në ekonominë e një vendi.

VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR GUSHT 2014

ÇKA ËSHTË SWIFT-I DHE IBAN-I?

Shoqëria Mbarë Botërore për Telekomunikim Financiar Ndërbankar apo siç njihet ndryshe me emrin SWIFT (Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication) është një rrjet mbarë botëror i cili mundëson dërgimin dhe pranimin e informatave në lidhje me transaksionet financiare përmes kanaleve të sigurta, të standardizuara dhe të besueshme. Aktualisht SWIFT ndërlidh mbi 10,500 institucione financiare në 215 vende të ndryshme botërore¹. Shumica e informatave ndërbankare të shkëmbyera në botë përdorin rrjetin e SWIFT-it.



SWIFT është themeluar në vitin 1973 në Bruksel dhe sot është bërë një organizatë standarde e komunikimit financiar. SWIFT përveç që lehtëson transferimin e fondeve, ajo mundëson edhe dërgimin e urdhërpagesave të cilat duhet të shlyhen nga llogaritë korresponduese që institucionet financiare kanë me njëra tjetrën. Kjo për faktin se çdo institucion financiar për të shkëmbyer transaksione bankare, duhet të kenë marrëdhënie ndërbankare me bankën tjetër në mënyrë që të gëzojnë këto mundësi, pra të shkëmbimit të transaksioneve bankare. Ky shkëmbim bëhet përmes rrjetit të SWIFT-it apo përmes BIC (Business Identifier Codes/Kodet Identifikuese të Biznesit) të cilat ndryshe njihen edhe si kodet e SWIFT-it. Çdo shtet ka kodin e tij përmes sëcilit identifikohet në transaksionet ndërkombëtare.

SWIFT kodet përbëhen nga 8 ose 11 karaktere dhe janë si në vijim:

- Kodi i bankës (katër karakteret e para dhe janë vetëm shkronja)
- Kodi i shtetit (dy karakteret e radhës dhe janë vetëm shkronja)
- Kodi i vendit (dy karakteret tjera të radhës, shkronja dhe numra)

Shembuj të këtyrë kodeve në botë:

Valuta	Banka	Lokacioni	SWIFT Kodi
USD	Deutsche Bank Trust Company Americas	New York	BKTRUS33
GBP	Deutsche Bank AG	London	DEUTGB2L
EUR	Deutsche Bank AG	Frankfurt	DEUTDEFF

Tab. 1 | Burimi: <http://www.deutschebank.co.in/swift-transfer.html> (20 gusht 2014)

¹ www.swift.com (20 gusht 2014)

Shembuj të kodeve në Kosovë:

Valuta	Banka	Lokacioni	SWIFT Kodi
EUR	NLB Prishtina	Prishtina	NLPRXKPR
EUR	Banka për Biznes	Prishtina	BPBXXKPR
EUR	ProCredit Bank	Prishtina	MBKOXKPR

Tab 2 | Shoqata e Bankave të Kosovës

Për dallim nga SWIFT, Numri i Llogarisë Bankare Ndërkombëtare apo siç njihet ndryshe me emrin IBAN (International Bank Account Number) paraqet një mënyrë unike të identifikimit të llogarisë bankare me qëllim të përmirësimit të efikasitetit dhe shpejtësisë për pagesat ndërkombëtare. IBAN-i (International Bank Account Number) është një format i standardizuar ndërkombëtarisht i numrit të llogarisë bankare, i cili është në përdorim nga shumë shtete, kryesisht në Evropë.

IBAN ka lind si një iniciativë evropiane për integrim ekonomik në sferën e pagesave, që do të thotë se qëllimi parësor i përdorimit të IBAN-it është zvogëlimi i rrezikut të gabimeve në shënimin e numrave të llogarive bankare. Përdorimi i formatit IBAN për llogaritë bankare e plotësojnë funksionalitetin e sistemit SWIFT lidhur me kryerjen e pagesave ndërkombëtare të qytetarëve.

IBAN përbën deri në maksimum 34 karaktere, përfshirë këtu:

- Kodin Shtetërorë (2 karaktere)
- Numrat kontrollues (2 karaktere)
- Numri bazik i llogarisë bankare (deri në 30 karaktere)

Shemuj të llogarive bankare të formatuara sipas standardeve të IBAN:

Vendi	Shembull i numrave të IBAN-it
Greqia	GR16 0110 1250 0000 0001 2300 695
Britani e Madhe	GB29 NWBK 6016 1331 9268 19
Arabia Saudite	SA03 8000 0000 6080 1016 7519
Zvicra	CH93 0076 2011 6238 5295 7

Tab. 3 | Burimi: http://en.wikipedia.org/wiki/International_Bank_Account_Number (20 gusht 2014)

ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË SWIFT DHE IBAN

Anëtarësimi i Kosovës në rrjetin e SWIFT-it dhe të IBAN-it ka shënuar një nga të arriturat më të mëdha të sistemit bankar të Kosovës, duke ju falenderuar një pune të mirë të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), bankave komerciale dhe Shoqatës së Bankave të Kosovës që kanë bashkëpunuar ngusht në këtë drejtim.

SWIFT

Anëtarësimi në këtë institucion ndërkombëtar ka qenë shumë sfidues për sistemin e ri bankar të Kosovës. Sot, Kosova është pjesë e rrjetit ndërkombëtar të pagesave dhe shkëmbimi i informatave dhe transaksioneve ndërkombëtare bëhet duke shfrytëzuar rrjetin e këtyre institucioneve ndërkombëtare, ashtu sikurse veprojnë edhe shumica e vendeve të tjera në botë.

Kosova është bërë pjesë e SWIFT-it në fund të vitit 2013 dhe ka filluar të aplikoj kodin e saj shtetërorë në muajin dhjetor 2013. Pas pranimit të kodit shtetëror të Kosovës në kuadër të SWIFT-it, Shoqata e Bankave të Kosovës përmes Komitetit të Pagesave dhe Komitetit të SWIFT-it të krijuar në kuadër të BQK-së, kanë dhënë kontribut të madh në arritjen e këtij qëllimi, pra regjistrimin e llogarive bankare të Kosovës në formatin e IBAN-it. Vlen të theksohet që ky është një shembull shumë i mirë i bashkëpunimit ndërmjet Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe Bankës Qendrore të Kosovës, përkatësisht me përfaqësuesit e saj, me ç'rast është e rëndësishme të vleresohet puna e përbashkët që ka rezultuar në marrjen e kodit të shtetit filimisht në SWIFT dhe tash regjistrimin e llogarive bankare të Kosovës në formatin e IBAN-it.

IBAN

Regjistrimi i llogarive bankare në formatin e IBAN-it, lehtëson në transferet ndërkombëtare hyrëse dhe ato dalëse, meqenëse përmes IBAN-it bëhet identifikimi ndërkombëtarë i llogarive bankare të Kosovës. Pra me rastin e dhënies së numrit të IBAN-it, banka inicuese e pageses/transferit është në gjendje që të bëjë identifikimin e shtetit (prej nga është llogaria), të identifikohet saktësisht banka pranuese e mjeteve dhe llogaria bankare.

Regjistrimi i llogarive në IBAN ofron një lehtësim në procesim të pagesave dhe siguri më të madhe për klientët e bankave në Kosovë duke zvogëluar rrezikun e përshkrimit të gabueshëm të numrave të llogarive bankare.

Formati IBAN do të jetë në përdorim opsional në pagesat ndërkombëtare dhe nuk do të ketë reflektim në pagesat brenda vendit. Data efektive e formatit IBAN të llogarive bankare të Kosovës do të jetë 1 shkurt 2015.

REGJISTRI I KREDIVE NË KOSOVË

Me qëllim të vlerësimit të klientëve bankar, por edhe për qëllime statistikore, në Kosovë funksionon Regjistri i Kredive (RKK). RKK është një regjistër publik i cili menaxhohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. RKK shërben për informim mbi kreditë për institucionet kredidhënëse në Kosovë. RKK është një aplikacion i bazuar në internet dhe mund të qasen drejtpërdrejt dhe në kohë reale të gjitha institucionet kredidhënëse dhe palët tjera të regjistruara.

Në RKK, institucionet kredidhënëse fusin dhe azhurnojnë të dhënat mbi kreditë e tyre të lejuara, dhe ato mund të marrin nga RKK-ja një raport përmbledhës mbi nivelin dhe statusin e kredive në lidhje me klientët e tyre individual. RKK-ja është e dizajnuar po ashtu që përmes BQK-së secili person të mund të marrë detajet e veta kreditore nëse është e nevojshme. Është e rëndësishme të theksohet se të gjitha institucionet kredidhënëse nuk mund të qasen në të dhënat personale që i posedon ky regjistër pa marrë paraprakisht pëlqimin e klientit të tyre.

RKK është futur në funksion në vitin 2006 dhe funksionon mbi bazën e rregullores për Regjistrin e Kredive, e cila është miratuar më 12 shkurt 2012 nga BQK. Aktualisht në RKK janë të anëtarësuara gjithsej 37 institucione, më saktësisht janë të anëtarësuara nëntë (9) banka komerciale, katërmbëdhjetë (14) institucione mikrofinanciare, katër (4) institucione financiare jobankare dhe dhjetë (10) kompani të sigurimeve.

RKK mundëson mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit kreditor në mes të institucioneve kredidhënëse për qëllime të përmirësimit të cilësisë së kredive. Nga ky regjistër prodhohet raporti kreditor i cili është një dokument i rëndësishëm i cili paraqet informacionin mbi kreditë e marra nga qytetarët dhe bizneset e Republikës së Kosovës. Ky informacion përdoret nga institucionet kredidhënëse në procesin e vlerësimit të aplikacionit për kredi nga klientët e institucioneve kredidhënëse.

Raporti kreditor përmban të dhëna personale në mënyrë të strukturuar, të dhëna mbi kreditë si dhe të dhëna mbi kreditë ku klientët janë garantues apo të lidhur në ndonjë mënyrë tjetër. Për çdo të dhënë në raportin kreditor identifikohet edhe institucioni kredidhënës i cili e ka raportuar atë.

Veçoritë e tij kryesore janë:

- Përmban informacione aktuale mbi statusin dhe nivelin e kredive të qytetarëve dhe bizneseve individuale;
- Raportimi i institucioneve kredidhënëse është i detyrueshëm;
- Këmbimi i informacioneve bëhet ndërmjet të gjitha institucioneve kredidhënëse;
- Është i zhvilluar si një aplikacion i sigurt i internetit me qasje të drejtpërdrejt 24 orë për tërë stafin e certifikuar të institucioneve kredidhënëse¹.

Çdo qytetarë i Republikës së Kosovës mund të qaset në këtë regjistër. Qytetarët mund të marrin informata nga ky regjistër në dy mënyra, përmes bankës ku qytetari është klient, si dhe përmes qasjes në kohë reale përmes internetit në uebfaqën www.raportikreditor.org.

Të dhënat mbi regjistrimet e qytetarëve në regjistër janë të prezantuara si në tabelën figurën nr.1.




Fig. 1 | Burimi: BQK - Raporti vjetor 2013

Nga këto të dhëna mund të shihet se numri i regjistrimeve të reja është pak a shumë i ngjashëm nëpër vite.

Figura nr.2 përshkruan numrin e kërkimeve në këtë regjistër prej viti 2010 deri 2013. Mund të vërejmë një rënie të kërkimeve përmes këtij regjistri, sidomos gjatë vitit 2012 dhe atë 2013.

² <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,55>




Fig. 2 | Burimi: BQK - Raporti vjetor 2013

Kjo rënie ka mund të ndodhë si rezultat i hyrjes në fuqi të rregullores së re të Bankës Qendrore të Kosovës në vitin 2012 (Rregullorja për Regjistrin e Kredive), e cila çdo institucion anëtarë të saj e obligon që paraprakisht të kërkoj pëlqimin e klientit para se të qaset në informatat personale të tij, pra në regjistrë. Një tjetër arsye mund të jetë edhe rënia e kërkesës për kredi që reflektohet edhe në statistikat e kreditimit të përgjithshëm.

Figura numër 3 tregon për numrin e kredive të reja të regjistruara gjatë viteve 2010-2013 nga institucionet anëtare në RKK.




Fig. 3 | Burimi: BQK - Raporti vjetor 2013

Nga të dhënat e paraqitura mund të shohim se numri më i madh i kredive të reja të regjistruara është shënuar në vitin 2011 prej 209,277 gjithsej, përderisa në vitet në vijim ka shënuar një rënie, me ç'rast në vitin 2013 shënoj 191,676 gjithsej kredi të reja të regjistruara.

Si përfundim mund të thuhet se Regjistri i kredive në Kosovë tashmë paraqet burimin kryesor të informacionit për të gjithë akterët e industrisë financiare përmes sëlilës regjistrohen dhe dokumentohen të gjitha të dhënat për kreditë e lëshuara nga këto institucione. Regjistri i kredive gjithashtu është burim informacioni jo vetëm për institucionet kredidhënëse, mirëpo është i hapur për të gjithë qytetarët dhe bizneset e Kosovës dhe paraqet një mjet shumë të rëndësishëm për zhvillimin e sektorit financiar.

VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR

SHTATOR 2014

HISTORIKU I PANAIRIT FINANCIAR

Shoqata e Bankave të Kosovës për herë të parë ka organizuar Panairin Financiar në vitin 2005 në bashkëpunim me partner të ndryshëm. Fillimisht është organizuar çdo dy vite, përderisa që nga viti 2011, Panairi Financiar organizohet çdo vit nga Shoqata e Bankave të Kosovës.

Përmes Panairit Financiar synohet që të krijohen dhe zgjerohen kontaktet ndërmjet institucioneve financiare, bizneseve, agjencive kontribuese në këtë fushë dhe investitorëve potencial përmes identifikimit të praktikave më të mira të bashkëpunimit që mund të shtyjë përpara zhvillimin e sektorit financiar si dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë. Çdo organizim i Panairit Financiar, ka për qëllim që të trajtoj çështje specifike të sektorit, duke sjellë në një vend të gjitha institucionet relevante përmes secilës synohet të adresohen sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohet sektori.

Panairi Financiar ka për qëllim gjithashtu që të lehtësoj në promovimin e shërbimeve të ndryshme financiare, kryesisht shërbimeve që janë të reja dhe jo shumë të njohura për vizitorët dhe të cilat mund të jenë shumë të mirëseardhura për bizneset në veçanti.

Panairi Financiar përmban disa aktivitete paralele njëkohësisht:

Ekspozimi – paraqet vetëm një prej pjesëve kryesore të Panairit Financiar gjatë dy ditëve të plota të punës, me ç'rast industria financiare ka mundësi të paraqet shërbimet dhe produktet e saj, por në të njëjtën kohë të komunikoj me akterët e ndryshëm, duke përfshirë: klientët individual dhe bizneset, rregullatorin dhe ligjvënësit, mediat dhe organizatat ndërkombëtare si dhe punëtorë potencial për të ardhmën.



Konferenca/Forume – organizohen gjatë Panairit Financiar paralel me pjesën e ekspozimit gjatë dy ditëve të panairit. Çdo vit trajtohen dhe diskutohen tema të caktuara të cilat janë pjesë e agjendës së sektorit financiar. Përmes këtyre organizimeve synohet që të vijnë sëbashku në një vend të gjithë akterët relevant të industrisë financiare për të diskutuar sfidat e këtij sektori, me ç'rast panelistët ndajnë me njëri tjetrin përvojën, kontributin dhe zotimet e tyre për temat të cilat përzgjedhen varësisht sipas interesit të industrisë.

Punëtori/Workshop – të ndryshme organizohen gjatë panairit financiar të cilat gjithashtu kanë për qëllim kryesisht edukimin financiar të segmenteve të ndryshme të shoqërisë. Deri tash janë organizuar punëtori nga më të ndryshme, ndër të cilat: punëtori me studentë, me sektorë të caktuar të industrisë (psh. kontabilistë, biznese që merren me shitje të derivateve të naftës etj), punëtori me gazetarë etj.

PANAIRI FINANCIAR 2014

Panairi Financiar 2014 është organizuar në datat 23 dhe 24 shtator 2014 në Hotel Swiss Diamond. Në kuadër të Panairit Financiar të këtij viti kanë ekspozuar kompani të ndryshme, duke përfshirë këtu institucione bankare, institucione mikrofinanciare, kompani të fushës së sigurimeve, agjenci vendore publike, institucione edukativo-arsimore, organizata ndërkombëtare dhe kompani konsulente.



PANAIRI FINANCIAR 2014

BASHKËPUNIMI I SEKTORIT FINANCIAR
ME BIZNESET NË KOSOVË
QASJA NË FINANCA

23 dhe 24 shtator 2014
Swiss Diamond Hotel
Prishtinë



Krahas pjesës së ekspozimeve, në kuadër të Panairit Financiar 2014 janë organizuar dy konferenca gjatë ditës së parë, punëtori me gazetarë dhe një forum gjatë ditës së dytë. Temat e dy konferencave të para kanë qenë: 1. Zbatimi i Kontratave dhe Qasja në Financa, dhe 2. Si të bashkëpunojmë me bankat për një normë më të mirë të interesit?. Përderisa forumi i organizuar gjatë ditës së dytë të panairit, kishte për temë diskutimi “Risku në mjedisin financiar dhe riskut kreditor”.

Gjatë Panairit Financiar 2014 është organizuar edhe një lojë shpërblyese e cila ka pas për qëllim që të nxisë dhe rrisë numrin e vizitorëve në panair dhe ti shpërblejë ata në shenjë falenderimi si klient të institucioneve financiare. Loja shpërblyese është vendosur në në sheshin “Nënë Tereza” gjatë dy ditëve të Panairit Financiar 2014. Në lojën shpërblyese janë kualifikuar të gjithë vizitorët e panairit dhe të cilët kanë arritur të mbledhin të paktën 15 broshura të kompanive ekspozuese në panair.. Tërheqja e fituesve të tri shpërblimeve të ndara nga SHBK është bërë përmes emisionit “Koha për Financa” në kuadër të televizionit “Kohavision”.



Shoqata e Bankave të Kosovës është mbështetur në këtë organizim nga Sponsorët Gjeneral: Banka Ekonomike, Banka Kombëtare Tregtare, Banka për Biznes, Is Bank, NLB Prishtina, ProCredit Bank, Raiffeisen Bank dhe Türk Economic Bankası - TEB. Panairi Financiar 2014 është përkrahur edhe nga sponsorët mbështetës si IFJB Vllësa, Crimson Finance Fund dhe IPKO, përderisa sponsor medial kanë qenë Telegrafi dhe Radio Dukagjini.

HAPJA E PANAIRIT FINANCIAR 2014

Hapjen e Panairit Financiar 2014 e bëri z. Petrit Balija, Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, z. Robert Wright, Kryetar i Bordit të Drejtorëve të i Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe z. Bedri Hamza, Guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës. Në fjalimet e rastit u vlerësua se Panairi Financiar tashmë është shëndrruar në një ngjarje tradicionale si dhe një vend ku takohen të gjithë akterët e industrisë financiare bankare dhe ato jo bankare me qëllim të avancimit dhe zhvillimit të mëtutjeshëm të ekonomisë së Kosovës në përgjithësi. U vlerësua gjithashtu se sektori bankar i Kosovës vazhdon të jetë atraktiv për investitorët si dhe të reflektoj nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjitha aspektet, përfshirë nivelin e lartë të kapitalizmit, pozitën e fuqishme të likuiditetit si dhe cilësinë e mirë të portofolit kreditor. Panairi i sotëm financiar, përveç rolit të tij në promovimin e sektorit financiar dhe ofrimin e mundësisë për partneritet dhe bashkëpunime të reja ndërmjet palëve pjesëmarrëse, është gjithashtu platformë shumë e rëndësishme për edukimin financiar të publikut dhe identifikimin e sfidave të reja për zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori.



Petrit BALIJA
Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës



Bedri HAMZA
Guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës



Robert WRIGHT
Kryetar i Bordit të Drejtorëve Shoqata e Bankave të Kosovës

PANELET DISKUTUESE GJATË PANAIRIT FINANCIAR 2014

Gjatë Panairit Financiar 2014 janë organizuar dy konferenca në ditën e parë dhe një forum gjatë ditës së dytë, ku janë përfaqësuar disa nga institucionet më të rëndësishme në sektorin financiar..

ZBATIMI I KONTRATAVE DHE QASJA NË FINANCA

Paneli i konferencës së parë të Panairit Financiar 2014 përbëhej nga gjashtë panelist: Fehmi Mehmeti – Zëvendës Guvernator në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), Ilir Aliu – Drejtor Ekzekutiv në ProCredit Bank, Frank Lakwijk – përfaqësues i Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovë, Asllan Krasniqi – Anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Anton Kobakov – Drejtor në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe David Greer – Udhëheqës i Programit për Përmbarim dhe Legjislacion Komercial në USAID.



Në diskutimet e konferencës së parë është vlerësuar se sektori bankar, përkundër sfidave me të cilat ballafaqohet, është duke kontribuar vazhdimisht në ekonomi dhe është stabil dhe i shëndoshë. Njëkohësisht BQK ka mbikëqyrur sektorin financiar për së afërmi dhe në të njëjtën kohë ka amendamentuar dhe aprovuar rregullore në bazë të praktikave më të shëndosha ndërkombëtare.

Fillimi i zbatimit të procedurës përmbarimore në fillim të vitit 2014, ka ndikuar shumë në procesin e zbatimit të kontratave. Përmes kësaj procedure është mundësuar të bëhet një planifikim më adekuat i investimeve dhe në përgatitjen e raporteve duke bërë që institucionet të jenë më transparente, e cila në mënyrë indirekte ndikon edhe në stabilitetin ekonomik të vendit, meqenëse mundëson menaxhimin më të mirë të borxheve. Menaxhimi më i mirë i borxheve nënkupton zvogëlim të shpenzimeve dhe me këtë ndikon edhe në përmirësimin e ofertës. Gjithashtu u vlerësua se projektet nga fusha e sigurimeve të kredive janë të mirëseardhura, meqenëse këto projekte do të lehtësonin ndjeshëm procesin e kreditimit si dhe do të ndikonin në uljen e riskut. Vlerësimi i kolateralit për momentin është duke u bërë nga vlerësues të brendshëm të vet bankave, mirëpo institucionet e vendit janë duke punuar që shumë shpejt të kemi vlerësuesit e parë të licensuar të cilët do të bëjnë vlerësimin e pronave në mënyrë më profesionale dhe të standardizuar.



Zbatimi i kontratës vjen krejt në fund pas vlerësimit të të gjitha kriterëve, pra atëherë kur diçka nuk shkon në rregull, me ç'rast i drejtohem i drejtësisë. Huamarrësi e paguan kredinë kur e din që sistemi i drejtësisë funksionon. Pra kemi të bëjmë me një proces më kompleks dhe që përfshin një proces të tërë. Kosova në bazë të raportit të Bankës Botërore mbi të bërit biznes listohet në vendin 138 sa i përket zbatimit të kontratave, që do të thotë se Kosova në raport me vendet e tjera është duke ngecur mbrapa dhe që duhet bërë hapa progresive më shumë se sa vendet e tjera të rajonit. Kjo nënkupton që shpenzimet mbi zbatimin e kontratave janë më të mëdha se sa në vendet e rajonit. Kjo është një prej arsyeve se pse normat e interesit janë më të larta. Gjithashtu kjo bën që edhe vlera e kolateralit të jetë më e lartë se sa në rajon në mënyrë që të mbulojnë rrezikun më të lartë që mbizotëron në krahasim me vendet e tjera.

Në bazë të studimeve të bëra nëpër vende të ndryshme të botës është vlerësuar se për një vend të caktuar është shumë e rëndësishme se sa shpejt funksionon sistemi i drejtësisë. Në bazë të këtyre studimeve, analiza ka treguar se ka një korelacion ndërmjet shpejtësisë në trajtimin e lëndëve gjyqësore dhe normave të interesit, pra sa më i shpejt sistemi gjyqësor, normat e interesit në kredi kanë qenë më të ulëta. Kjo afekton patjetër edhe ekonominë në Kosovë.



Sikurse i gjithë sektori privat edhe sektori bankar sfidë të rëndësishme në ekonominë e Kosovës e ka qasje në financa. Në raportin e Bankës Botërore të të bërit biznes, Kosova listohet afër vendit të 30 sa i përket mundësisë të qasjes në financa, përderisa në fushën e zbatimit të kontratave listohet ndërmjet vendeve 130-140 në botë. Sektori bankar ka shënuar progres në vazhdimësi në lidhje me qasjen në financa, përderisa zbatimi i kontratave ka ngecje. Në sistemin gjyqësor ka lëndë që janë të deponuara me mbi pesë vite të vjetra, çështje e cila ngritë shumë pikëpyetje, reflekton pasiguri dhe ndikon në performancë. Në bazë të vlerësimeve të brendshme të industrisë gjykohej se në sistemin e drejtësisë janë të paraqitura mbi 10,000 lëndë vetëm nga sektori bankar dhe që arrijnë vlerën e mbi 250 milionë euro për të cilat janë provizionuar rreth 250 milion Euro të tjera dhe që nënkupton se janë të bllokuara rreth 500 milion Euro. Nëse sektori bankar do të ishte i sigurtë që një borxh do të kthehet përmes sistemit të drejtësisë, atëherë është më e lehtë dhe më e shpejtë procedura dhe bankat do të ishin më pak konservative, përderisa qasja në financa do të ishte më efikase. E gjithë kjo ndikon në koston e financimit si dhe në normat e interesit që bankat i aplikojnë. Efektshmëria e gjykatave ndikon në uljen e ekonomisë jo-formale dhe kjo ndikon poashtu edhe në nxitjen e investitorëve të huaj.

Në diskutime të panelit gjithashtu u vlerësua se ka ende hapësirë që niveli i kredive jo-performuese të kthehet në nivelin e para krizës globale (2007-2008) kur ky nivel ishte në 5% edhe pse norma aktuale e kredive jo-performuese është më e mira në rajon. Sektori bankar në Kosovë i rekomandon institucioneve të Kosovës që të krijoj oda apo gjykata speciale të cilat do të merreshin veçmas me lëndët e sektorit financiar, për shkak të specifikave që kanë këto lëndë. Rekomandimi tjetër është që bankave të ju mundësohet që të bëjnë financime më të mëdha afatshkurtëra përmes premtime pagesës (promissory note), me ç'rast banka nuk kërkon kolateral, mirëpo në rast të kontestit, atëherë kjo shkon drejtpërdrejt përmes procedurës përbarimore ku banka e ekzekuton menjëherë borxhin, pra përmes një sistemi më efikas të drejtësisë.



Sistemi i drejtësisë në Kosovë u vlerësua se është duke u përmirësuar dhe i cili është ndihmuar në vazhdimësi nga donatorët sikurse që është Programi për Përbarim dhe Legjislacion Komercial (CLE USAID). Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nënshkruar marrëveshje me Bankën Qendrore të Kosovës përmes së cilës gjykatat informohen për numrat e llogarive bankare. Gjykata ekonomike me ndihmën e përbaruesve privat dhe ndihmën e këtij programi tani më mesatarisht arrijnë që të përbaroj me sukses 50-100 raste në muaj. Nëse ky trend vazhdon, atëherë sistemi i drejtësisë do të jetë afër vendeve të rajonit. Në diskutim të panelit u theksua se në përbarim të lëndëve nuk është fajtorë vetëm sistemi i drejtësisë, mirëpo janë edhe ligjet të cilat amandamentohen nga 2 deri 3 herë, përmes Ligji për Procedurën Përbarimore ka hyrë në fuqi në vitin 2008, mirëpo tek tash ka filluar të zbatohet dhe rezultatet e saj do të jenë evidente tek gjatë vitit të ardhshëm.



Në diskutim të panelit vëmendja u përqendrua gjithashtu tek mungesa e rritjes së kapitalit, ku bizneset do të mund të rrisin veprimet e tyre, të hyjnë në tregje të reja apo të financojnë blerje të rëndësishme pa bërë ndryshime në kontrollin e biznesit.



Në fund u vlerësua se me aprovimin e ligjit të ri për procedurën përmbartimore, kjo do të reflektohet edhe në vlerësimin e Bankës Botërore i cili do të bëhet për këtë vit. Kosova tani më ka një sistem të ri dhe ky do të jetë një fillim i ri i mirë dhe i cili mund të zhvillohet tutje vetëm përmes një bashkëpunimi të përbashkët të Bankës Qendrore të Kosovës, sektorit privat dhe institucioneve tjera publike.



SI TË BASHKËPUNOJMË ME BANKAT PËR NJË NORMË MË TË MIRË TË INTERESIT?

Konferencën e dytë të Panairit Financiar 2014 e përbënin gjashtë panelist: Ardiana Bunjaku – Drejtore Ekzekutive në Shoqatën e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës, Nahit Sharku – Zëvendës Drejtor në Administratën Tatimore të Kosovës, Robert Wright – Drejtor Ekzekutiv në Raiffeisen Bank, Shefik Gërbovci – Drejtor Ekzekutiv i Sektorit Teknik në Illyria Insurance, Ismet Hulaj – Zyrtar Financiar në Stone Castle dhe Bersant Disha – Drejtor në Recura Financials.



Hapja e konferencës së dytë gjatë ditës së parë të panairit u bë duke diskutuar mbi çështjen e normës së interesit dhe faktin që duhet të merren edhe shumë faktorë tjerë parasysh në procesin e kreditimit, njëkohësisht u diskutua edhe qasja në kredi dhe sa mund t'i plotësojmë kriteret për t'u kualifikuar për kredi. Në diskutime u vlerësua se bankat në Kosovë janë likuide, përderisa financohen kryesisht nga depozitat e klientëve të tyre. Normat e interesit për kredi janë duke u zvogëluar, por njëkohësisht edhe normat e interesit për depozita kanë pësuar rënie. Risku politik dhe ai i sigurisë fizike është përmirësuar, përderisa sistemi gjyqësor me procedurën e re dhe ai me përmbauesit privat është duke u përmirësuar por me një ritëm shumë të ngadalshëm dhe mbetet shumë për të bërë, në mënyrë që të ndikohet pozitivisht në përmirësimin e kushteve afariste si për bankat ashtu edhe për bizneset tjera.



Paneli vazhdoi diskutimin duke vlerësuar se një nga arsyet se pse ende norma e interesit mbetet relativisht e lartë ka të bëjë me faktorët e riskut, përkatësisht riskun ligjor, pra sa efikas është sistemi i drejtësisë. Një arsye tjetër është edhe risku i klientit i cili në mënyrë signifikante mund të ndikoj në uljen e kësaj mesatareje, meqenëse varësisht nga numri i kriterëve që ai klient i plotëson, përcaktohet edhe norma e interesit me të cilën e merr kredinë. Sa më shumë kemi klientë të mirë, aq më e madhe është mundësia për të marrë kredi me përqindje më të ulët të interesit. Mesatarja e kredisë është 10.8% në fund të tremujorit të dytë të vitit 2014, mirëpo kemi kredi që lëshohen me 7% apo edhe me 13%. Klienti ka ndikim shumë të madh në përcaktimin e normës së interesit, varësisht se sa ai biznes bën auditimin e pasqyrave financiare, nuk shmanget nga tatimi, pastaj koncentrimi i shumë bizneseve në një sektor, sigurimi i kolateralit, biznesi plani, pajtueshmëria e tij me kushtet kontraktuale, historia kreditore dhe

shumë aspekte të tjera që mund të ndikojnë në përcaktimin e riskut kreditor. Sektori bankar dhe ai financiar jo bankar gjithashtu bën financimin edhe të bizneseve që nuk janë të sigurta, pra atyre që nuk ofrojnë kolateral si peng për kreditë e marrë, mirëpo në raste të tilla ajo reflektohet pastaj edhe në normën e interesit për të cilën e merr atë kredi.



Në këtë panel u vlerësua gjithashtu se bizneset në Kosovë ballafaqohen me shumë vështirësi gjatë procesit të operimit të tyre, meqenëse vazhdimisht ballafaqohen me konkurrencë jo-parimore, kushte të pafavorshme dhe mungesë financiare. Për momentin kreditë bankare janë financuesit kryesorë tek ndërmarjet e vogla dhe të mesme, përderisa këto ndërmarrje ballafaqohen me shumë vështirësi edhe në qasje tek kreditë bankare për shkak të mungesës së kolateralit. Me këtë rast u sugjerua që të përmirësohet kjo situatë duke i mundur këtyre bizneseve të financohen edhe përmes letër garancioneve bankare, në mungesë të kolateralit.



Diskutimi u përqendrua edhe tek çështja e raportimit, duke vlerësuar se raportimi adekuat dhe auditimi i pasqyrave financiare është shumë i rëndësishëm në njohjen e historikut të bizneseve. Tek ne këto biznese mbajnë nga dy deri në tri pasqyra financiare, me ç'rast bizneset mbajnë pasqyra financiare të veçanta për Administratën Tatimore, të tjera për zyrën e bizneseve, tjetër për bankat. Në bazë të komenteve dhe vlerësimeve të pranuar është thënë gjithashtu se edhe raportet e auditorëve nuk kanë qenë në nivelin e kënaqshëm dhe se për këtë duhet kohë për shkak të historisë dhe sistemit të kaluar kur auditori më tepër ka pas rolin e inspektimit, përderisa adaptimi me kushtet e reja merr kohë. Është e rëndësishme që t'i jepet një vëmendje kësaj çështje dhe të kontribuojmë më tepër në cilësinë e auditorëve duke certifikuar ata në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare, ku inspektimi i tyre bëhet përmes këshillit për raportim financiar, i cili këshillë për momentin nuk bën kontrollimin e cilësisë së raporteve të auditorëve.



Administrata Tatimore (ATK) prej vitit 2009 në bazë të strategjisë së saj të hartuar ka filluar me një qasje të re ndaj bizneseve në Kosovë duke zbatuar më tepër një sistem më transparent përmes incentivave dhe jo masave ndëshkuese edhe pse këto masa mund të përdoren si mundësi e fundit për shkak se janë të obliguar edhe në bazë të ligjit të vepronë në atë formë. Administrata Tatimore ka hartuar plan të detajuar veprimi duke i ndarë bizneset në sektor të veçantë, duke iu përshtat nevojave të tyre me ç'rast ka hartuar shërbime për bizneset në formë edukimi. Në diskutim u vlerësuar se edhe për Administratën Tatimore të Kosovës problem kyq është mosfunksionimi i gjykatave, përderisa u theksua bashkëpunimi shumë i mirë që ATK ka me bankat. Për të ardhmën u rekomandua nevoja për harmonizimin e pasqyrave financiare që bizneset i paraqesin në ATK dhe qasja e bankave në këto pasqyra, përmes një procesi më transparent duke bërë shkëmbimin e informatave. Deklarimi elektronik i bizneseve ka mundësuar që të kryhet në kohë reale dhe të lehtësoj shumë procedurat për pagesa të obligimeve që bizneset i kanë ndaj shtetit. ATK gjithashtu ka krijuar disa grupe punuese për unifikimin e pasqyrave financiare për bizneset. Këto ndryshime të bëra kohëve të fundit në ATK do të ndikojnë në zvogëlimin e kostos dhe me këtë edhe në normën e interesit që bankat e aplikojnë.



Sektor i sigurimeve ofron shërbime që i ndihmon industrisë bankare duke bërë kështu që të zvogëlohet rreziku kreditor për bankat, mirëpo i mbetet tregut dhe me këtë edhe sektorit bankar nëse kjo ulje e rrezikut duhet të reflektoj në uljen e normës së interesit. U vlerësua se kontributi i sektorit të sigurimeve në sektorin financiar është me vetëm 3.5%, andaj është e nevojshme për një kontribut edhe më të madh të këtij sektori. Nga paneli u vlerësua se sektori i sigurimeve ofron disa lloje të shërbimeve që i ndihmojnë sektorit bankar sikurse që është sigurimi i pronave të agrobizneseve, përderisa qeveritë e rajonit i subvencionojnë këto prona. Pra në Kosovë nuk është shumë i zhvilluar ky lloj i sigurimit dhe nuk ka subvencione nga qeveria. Andaj edhe kompanitë e sigurimeve nuk kanë marrë përsipër shumë risk sidomos për shkak edhe të ndryshimeve klimatike të kohëve të fundit, përderisa edhe bizneset nuk kanë qenë mirë të informuara për këtë produkt dhe për pasojë nuk kanë qenë edhe të interesuara. Kompanitë e sigurimeve ofrojnë mundësi të sigurimit të rendimentit, pronave nga fatkeqësitë natyrore, sigurim të jetës së kredimarrësit, sigurime këto të cilat i ndihmojnë bizneseve në qasje më të lehtë financiare. Kompanitë e sigurimit aktualisht i kontribuojnë sektorit bankar me 70-80 milionë euro depozita të këtij sektori të cilat i kanë në dispozicion me afat më të gjatë. Për fund u rekomandua gjithashtu që Banka Qendrore e Kosovës të mos e kalkuloj në kuadër të normës efektive të interesit edhe koston të cilën e paguan klienti për sigurim, meqenëse ky shpenzim nuk duhet të hyj në kuadër të saj dhe për pasojë e rritë përqindjen e mesatares.

RISKU NË MJEDISIN FINANCIAR DHE KREDIT RISKU

Forum i Panairit Financiar 2014 i cili është mbajtur gjatë ditës së dytë të panairit është organizuar në bashkëpunim me Qendrën për Promovimin e Zhvillimit, e cila udhëheqët nga Prof. Dr. Muhamet Sadiku, forum ky i cili përbëhet prej pesë panelistëve: Haxhi Gashi – ekspert ligjor, Jan Peter Olters – përfaqësues i Bankës Botërore për Kosovë, Michael Gold – Drejtor menaxhues i Crimson Capital Fund dhe Flamur Keqa – njohës i çështjeve të sektorit financiar (njëkohësisht moderator i panelit).



Në diskutimin e panelit të ditës së dytë u vlerësua se aktiviteti kryesor i bankave komerciale në Kosovë është huadhënia. Struktura më e madhe e sektorit bankar përbëhet nga portfolio kreditorë, portfolio e cila ndikon shumë në performancën e këtij sektori, përderisa vlerat e të hyrave, kualitetin, likuiditetin e ka për obligim ta vlerësoj Banka Qendrore e Kosovës. Në diskutim u vlerësua se rreziku kreditor duhet të menaxhohet në atë mënyrë që të mos lejohet tolerancë e madhe e cila mund të paraqes problem serioz në të ardhmën për afarizmin bankar.



Panelistët e këtij forumi vlerësuan së ka disa lloje të rrezikut, sikurse që janë rreziku vendor, rajonal, global apo ai sektorial. Rreziku global apo kriza globale e vitit 2008 megjithëse është thënë më herët që nuk ka ndikuar drejtpërdrejt në ekonominë e Kosovës, megjithatë në këtë diskutim u vlerësua se kjo krizë ka afektuar Kosovën, mirëpo në një periudhë të mëvonshme, pra askush nuk mund të jetë imun ndaj krizave. Kreditë jo-performuese për bizneset u vlerësuan si më të larta se sa që është mesatarje e tyre në nivel vendi, përderisa vëmendja kryesore iu kushtua mundësisë që këto biznese të kenë qasje në financa. Në Kosovë ka shumë biznese të cilat nuk kualifikohen për kredi, andaj pyetja më e rëndësishme që duhet të adresohet nuk është sa është norma e interesit, mirëpo a janë të kualifikuara këto biznese për të pas qasje në financa. Në diskutim u sollën edhe praktikatat në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me ç'rast u vlerësua se atje shumë prej bizneseve nuk arrijnë të plotësojnë kriteret për të pas qasje në këto linja kreditore. Ato mund të përdorin produkte të ndryshme siç janë para të gatshme avans apo kartela kreditore, mirëpo jo linja kreditore. Një aspekt shumë i rëndësishëm u vlerësua të jetë edhe fusha e edukimit financiar, me ç'rast klientët duhet të njoftohen më shumë për marrëveshjet kreditore apo për marrëveshjet e pengut, pra të informohen mbi pasojat e mundshme dhe obligimet që i marrin me rastin e marrjes së një linje kreditore.



Kosova është e ngritë në raportin e bankës botërore për të bërit biznes si rezultat i përmirësimit të gjendjes kadastrale në Kosovë. Agjencia poashtu është duke punuar dhe është e gatshme të filloj edhe me sistemin në kohën reale për shkëmbim të informatave. Nga Agjencia Kadastrale u rekomandua që institucionet financiare të bëjnë shlyerjen e kredive në kadastrë për kreditë e realizuara, meqenëse ato nuk largohen nga regjistri i kadastrës derisa vjen kërkesa për shlyerje. Shlyerja mund të bëhet në zyrat komunale kadastrale apo tek vet Agjencia Kadastrale.





Çështja e riskut është çështje subjektive që nënkupton mungesë besimi apo mungesë informacioni. Aktualisht në Kosovë mesatarja e normës së interesit është afërsisht 10.8%, përderisa në Gjermani është rreth 7%, Mal të Zi rreth 9.5%. Ky ndryshim ndërmjet normave të interesit pasqyron premiumin e riskut, përkatësisht dallimin në risk ndërmjet këtyre vendeve. Në diskutim u vlerësua se më e rëndësishmja është se sektori bankar është i shëndoshë, likuid dhe profitabil, mirëpo gjithashtu është e rëndësishme që bankat të kenë kujdes që të mos e mbivlerësojnë rrezikun e tregut, meqenëse kjo mund të ndal rritjen apo zhvillimin e vendit për aq sa mbivlerësohet. Është e rëndësishme gjithashtu që sektori bankar të bashkëpunoj ngushtë me sektorin e sigurimeve, meqenëse sektori i sigurimeve ka nevojë të përmirësohet ende dhe në këtë mënyrë t'i ndihmojnë njëra tjetrës. U vlerësua se është e rëndësishme gjithashtu që sektori bankar të financoj sektore apo fusha të cilat kanë potenciale për rritje, meqenëse ka disa sektorë në Kosovë që e kanë këtë potencial.

Në aspektin ligjor paneli diskutoj kryesisht mbi vështirësitë që i has sektori bankar në zbatimin e ligjit. Një sfidë e cila u vlerësua si e rëndësishme kishte të bënte me kontratat, përkatësisht marreveshjet kreditor nuk sqarohen mirë dhe klienti nuk është shumë i vetëdijshëm për obligimet që merr përsipër. Gjithashtu bankat përveç marrëveshjes së pengut duhet ta regjistrojnë pengun në regjistër në mënyrë që ta ketë prioritetin, përderisa të gjitha marrëveshjet apo kontratat duhet të noterizohen. Sa i përket infrastrukturës ligjore u vlerësua se defekti qëndron tek interpretimi dhe zbatimi i tyre. Një çështje që është evidentuar si shqetësuese për bankat dhe që moë vonë që rregulluar ka qenë që rastet e kontesteve që kanë pas të bëjnë me marrëveshje hipotekare, janë procesuar përmes procedurës kontestimore, përderisa është dashtë të shkojnë përmes procedurës përmbartimore. Kjo ka bërë që të marrë kohë më shumë deri në ekzekutimin e hipotekës nga bankat. Shumë prona nuk kanë sqarim adekuat të të drejtave pronësore sidomos për tokat bujqësore dhe si rezultat ato prona nuk mund të përdoren si hipotekë. Gjithashtu shumë prona të reja nuk janë të regjistruara fare tek Agjencioni Kadastral sidomos në Prishtinë.

Në fund të këtij forumi si përfundim u vlerësua se problemet janë multisektoriale, andaj edhe rreziku është shumëdimensional, me ç'rast secili sektor dhe institucion duhet të marrë përsipër përgjegjësitë e tij si dhe të përmirësoj apo performoj më mirë. Sa më i fuqishëm është njëra palë, aq më i fuqishëm do të jetë edhe pala tjetër.



Me përfundimin e këtij forumi u bë edhe mbyllja zyrtare e konferencave dhe forumeve të Panairit Financiar 2014 me ç'rast z. Petrit Balija, Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës falenderoj Kryetarin e Bordit të Shoqatës së Bankave z. Robert Wright dhe anëtarët e Bordit të ShBK-së për mbështetjen e tyre në organizimin e këtij event. Z. Balija falenderoj edhe sponsorët general dhe sponsorët mbështetës të Panairit Financiar 2014 si dhe pjesmarrësit tjerë në panair.

SPONSORËT



VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR TETOR 2014



TRENDET E TREGUESVE KRYESOR TË INDUSTRIJË BANKARE

Industria bankare në Kosovë vazhdon të zgjerohet dhe të reflektoj nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjitha aspektet, përfshirë nivelin e lartë të kapitalizimit, pozitën e fuqishme të likuiditetit si dhe cilësinë e mirë të portfolios kreditore. Industria bankare në Kosovë vazhdon të tregoj performancë të mirë dhe rritje nga viti në vit. Kjo mund të vërehet edhe nga indikatorët kryesor të cilët do të shpalosen për periudhën dhjetor 2013 – shtator 2014 në vijim të këtij publikimi.

ASETET E INDUSTRIJË BANKARE

Asetet e industrisë bankare në vazhdimësi kanë shënuar vlera pozitive të rritjes, gjë që tregon për një zhvillim pozitiv dhe qëndrueshmëri të industrisë bankare. Asetet e industrisë bankare në fund të muajit shtator 2014 kanë arritë vlerën prej 3,149.50 milionë euro.

ASETET E INDUSTRIJË BANKARE										
*Milionë euro										
Përshkrimi	Dhjetor 2013	Janar 2014	Shkurt 2014	Mars 2014	Prill 2014	Maj 2014	Qershor 2014	Korrik 2014	Gusht 2014	Shtator 2014
Asetet	3,059.3 €	3,048.5 €	3,045.1 €	3,053.3 €	3,038.3 €	3,014.0 €	3,059.5 €	3,116.4 €	3,160.4 €	3,149.5 €

Tab. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i Gjendjes (31 tetor 2014)

Siç mund të vërehet në tabelën dhe figurën nr.1, vlera e aseteve prej muajit në muaj ka luhatur, mirëpo nëse merret në baza më afatgjata (dhjetor 2013 – shtator 2014), atëherë mund të shohim se asetet kanë trende pozitive me një rritje prej 2.9%. Vlera më e madhe për këtë vit e aseteve është shënuar në muajin gusht 2014 prej 3,160.4 milionë euro. Kjo vlerë paraqet njëkohësisht edhe vlerën më të lartë të arritur për këtë industri deri më tani.




Fig.1 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes (31 tetor 2014)

Kreditë dhe lizingu e përbëjnë pjesën më të madhe të gjithsej asetëve të industrisë bankare. Në fund të muajit shtator 2014, 59.9% e gjithsej asetëve përbëhet nga kreditë e industrisë bankare apo 1,855 milionë euro janë gjithsej kredi të disbursuara.

KREDITË BRUTO DHE LIZINGU NË INDUSTRIJË BANKARE

*Milionë euro										
Përshkrimi	Dhjetor 2013	Janar 2014	Shkurt 2014	Mars 2014	Prill 2014	Maj 2014	Qershor 2014	Korrik 2014	Gusht 2014	Shtator 2014
Kreditë bruto	1,805.8 €	1,794.5 €	1,794.3 €	1,825.9 €	1,839.7 €	1,856.8 €	1,889.9 €	1,874.3 €	1,848.2 €	1,855.0 €

Tab. 2 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes (31 tetor 2014)

Vlerat e kredive të disbursuara nga industria bankare nëpër muaj kanë shënuar lëvizje të ndryshme, mirëpo nëse merret në baza më afatgjata (dhjetor 2013 – shtator 2014), atëherë nga figura dhe tabela nr.2 mund të shohim se kreditë kanë shënuar trende pozitive prej 2.7% rritje apo janë disbursuar 49.2 milionë euro më shumë në fund të muajit shtator 2014, në krahasim me muajin dhjetor 2013. Gjithsej kreditë dhe lizingu bruto i disbursuar nga industria bankare në fund të muajit shtator 2014 kanë qenë 1,855 milionë euro. Vlera më e madhe për kredi të disbursuar gjatë këtij viti ka qenë në muajin qershor në vlerë prej 1,889.9 milionë euro.




Fig.2 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes (31 tetor 2014)

DEPOZITAT E INDUSTRIJË BANKARE

Një nga burimet kryesore të financimit të bankave në Kosovë janë depozitat të cilat klientët i deponojnë në llogaritë e tyre bankare. Për industrinë bankare është e rëndësishme që këto depozita të kenë rritje të qëndrueshme, në mënyrë që të bëhet financimi i ekonomisë së Kosovës. Bazuar në të dhënat që i disponon Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, depozitat kanë shënuar rritje të vazhdueshme.

DEPOZITAT E INDUSTRIË BANKARE

*Milionë euro

Përshkrimi	Dhjetor 2013	Janar 2014	Shkurt 2014	Mars 2014	Prill 2014	Maj 2014	Qershor 2014	Korrik 2014	Gusht 2014	Shtator 2014
Depozita	2,499.0 €	2,443.4 €	2,433.4 €	2,430.8 €	2,425.9 €	2,415.1 €	2,421.0 €	2,474.9 €	2,513.6 €	2,518.0 €

Tab. 3 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes (31 tetor 2014)

Në tabelën nr.3, mund të shohim se depozitat në industrinë bankare nëpër muaj kanë shënuar lëkundje, megjithëse në plan më afatgjatë ndërmjet muajit dhjetor 2013 dhe atij shtator 2014, depozitat kanë shënuar trend pozitiv të rritjes. Më saktë depozitat gjatë kësaj periudhe janë rritë për 69 milionë euro apo janë rritë për 2.8%.

Në fund të muajit shtator 2014, vlera totale e depozitave ka arritë në 2,518 milionë euro. Kjo vlerë njëkohësisht paraqet edhe vlerën më të madhe të depozitave të shënuara ndonjëherë nga industria bankare në Kosovë.




Fig.3 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes (31 tetor 2014)

TREGUESIT E PERFORMANCËS SË INDUSTRIË BANKARE

Një nga treguesit e performancës së industrisë bankare është pasqyra e të ardhurave, përkatësisht të hyrat dhe shpenzimet e regjistruara për periudhën raportuese. Është e rëndësishme dhe qenësore për një biznes që këto të hyra të jenë të qëndrueshme, përderisa menaxhimi i shpenzimeve të jetë në pajtim me këto të hyra. Në vijim po japim një pasqyrë të këtyre të hyrave dhe shpenzimeve për periudhat dhjetor 2013 – shtator 2014.

TË HYRAT DHE SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE										
*Milionë euro										
Përshkrimi	Dhjetor 2013	Janar 2014	Shkurt 2014	Mars 2014	Prill 2014	Maj 2014	Qershor 2014	Korrik 2014	Gusht 2014	Shtator 2014
Të hyrat	249.0 €	20.1 €	38.9 €	59.4 €	79.7 €	100.6 €	121.6 €	142.7 €	163.7 €	183.5 €
Shpenzimet	223.0 €	17.1 €	33.6 €	49.7 €	67.2 €	81.2 €	94.7 €	111.2 €	123.1 €	136.6 €
Fitimi / humbja neto	26.0 €	2.9 €	5.4 €	9.8 €	12.5 €	19.4 €	26.9 €	31.5 €	40.7 €	46.9 €

Tab. 4 | Burimi: BQK - Pasqyra e të ardhurave (31 tetor 2014)

Në tabelën nr.4 të paraqitur mund të shohim se nëpër muaj kemi trend të vazhdueshëm pozitiv të rritjes së të hyrave në raport me shpenzimet që i bën ky sektor. Në fund të muajit shtator 2014 fitimi i realizuar i industrisë bankare është 46.9 milionë euro. Edhe pse në kohën e këtij publikimi ende nuk ka përfunduar viti 2014, fitimi i realizuar në tremujorin e tretë të industrisë bankare është dukshëm më i madh se sa ai i shënuar në fund të muajit dhjetor 2013. Pra kemi 20.9 milionë euro fitim më shumë në raport me fundin e vitit të kaluar.

Ajo çka është e rëndësishme të theksohet nga tabela nr.4 është se industria bankare ka arritë në mënyrë të ndjeshme të ulë shpenzimet, prej ku buron edhe kjo rritje e ndjeshme e fitimit për këtë periudhë raportuese, përdërisa të hyrat e kësaj industrie qëndrojnë afërsisht të njëjta me vitin e kaluar. Vlen të cekët që ky progres në performancë të bankave të Kosovës vjen në një kohë kur norma mesatare e interesit për kredi është më e ulta që nga themelimi i industrisë bankare në Kosovë.




Fig.4 | Burimi: BQK - Pasqyra e të ardhurave (31 tetor 2014)

Një tregues tjetër i rëndësishëm i matjes së performancës së industrisë bankare është Kthimi mesatar në asete (Return on Average Assets – ROAA) dhe Kthimi mesatar në kapital (Return on Average Equity – ROAE). ROAA kalkulohet në baza tremujore apo vjetore dhe e cila nuk tregon nivelin më të lartë apo më të vogël të këtij kthimi, mirëpo reflekton mesataren nga kthimi në asete për atë periudhë raportuese. Kthimi mesatar në asete paraqet raportin ndërmjet të hyrave neto dhe gjithsej mesataren e aseteve. Në anën tjetër ROAE paraqet raportin ndërmjet të hyrave neto dhe mesatares së kapitalit të aksionarëve, përderisa mesatarja e kapitalit të aksionarëve llogaritet duke marrë për bazë kapitalin në fillim të periudhës raportuese dhe kapitalin në fund të periudhës raportuese, pjesëtuar me dy.

Industria bankare në Kosovë gjatë kësaj periudhe raportuese (dhjetor 2013 – gusht 2014) vazhdimisht ka shënuar vlera pozitive të rritjes së këtyre dy indikatorëve (ROAA dhe ROAE).

KTHIMI MESATAR NË ASETE (ROAA) DHE KTHIMI MESATAR NË KAPITAL (ROAE) TË INDUSTRIËS BANKARE									
*Milionë euro									
Përshkrimi	Dhjetor 2013	Janar 2014	Shkurt 2014	Mars 2014	Prill 2014	Maj 2014	Qershor 2014	Korrik 2014	Gusht 2014
ROAA	0.9%	1.2%	1.1%	1.3%	1.2%	1.5%	1.8%	1.8%	2.0%
ROAE	9.4%	12.5%	11.4%	13.8%	13.3%	16.5%	19.0%	18.9%	21.1%

Tab. 5 | Burimi: BQK - Raporti i informatave Mujore (Publikimi nr.1-8)




Fig.5 | Burimi: BQK - Raporti i informatave Mujore (Publikimi nr.1-8)

Nga figura nr.5 e paraqitur mund të shohim trendin pozitiv të vazhdueshëm për këtë periudhë raportuese për të dy këta tregues. Nëse marrim për bazë fitimin e realizuar për këtë periudhë si dhe këta dy tregues, atëherë mund të thuhet se industria bankare tregon një qëndrueshmëri financiare, gjë që është shumë e rëndësishme për sigurinë e sistemit financiar si dhe kthim të kënaqshëm për investitorët.

KREDITË JO PERFORMUESE TË INDUSTRIJË BANKARE

Në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të qartë mbi një numër më të madh të treguesve financiar për industrinë bankare, në vijim po paraqesim edhe të dhënat e kredive jo performuese.

KREDITË JO PERFORMUESE TË INDUSTRIJË BANKARE (NPL)									
Përshkrimi	Dhjetor 2013	Janar 2014	Shkurt 2014	Mars 2014	Prill 2014	Maj 2014	Qershor 2014	Korrik 2014	Gusht 2014
NPL	8.7 %	8.7 %	8.8 %	8.6 %	8.6 %	8.4 %	8.2 %	8.2 %	8.3 %
Mbulueshmëria me provizione	110.6 %	112.5 %	112.3 %	114.6 %	116.1 %	117.0 %	116.4 %	117.9 %	116.8 %

Tab. 6 | Burimi: BQK - Raporti i informatave Mujore (Publikimi nr.1-8)

Tregues tjetër pozitiv i industrisë bankare është se kreditë jo performuese (NPL) për dallim nga fundi i vitit 2013 kur NPL ishte 8.7%, në muajin gusht 2014, kreditë jo performuese shënuan ulje në 8.3%, përderisa vlera më e ultë e saj u shënuar gjatë muajit qershor 2014 me 8.2%.




Fig.6 | Burimi: BQK - Raporti i informatave Mujore (Publikimi nr.1-8)

Është e rëndësishme të theksohet se mbulueshmëria e kredive jo performuese është mbi 100%, që nënkupton se industria bankare është mirë e provizionuar, andaj edhe përqindjet e lartëshënuara për kreditë jo performuese nuk paraqesin rrezik domethënës për stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e industrisë bankare në përgjithësi. Në fund të muajit gusht 2014, mbulueshmëria me provizione është në 116.8%.

NORMA E FEFKTIVE E INTERESIT E INDUSTRIJË BANKARE (NEI)

Norma efektive e interesit për kredi përfshinë të gjitha shpenzimet që klienti apo shfrytëzuesi i kredisë duhet të paguaj ndaj institucionit financiar për atë kredi, duke përfshirë këtu interesin nominal dhe shpenzimet e tjera të mundshme administrative që dalin nga marrja e asaj kredie. Norma efektive e interesit zbatohet për të dy rastet, në interesin e kredive që i lëshon industria bankare si dhe në rastin që industria bankare paguan interesin për depozitat e klientëve të cilat ajo i mban. Publikimi i kësaj informate është shumë e rëndësishme,

meqenëse paraqet koston totale që klienti duhet të ia paguaj bankës për atë kredi. Në Kosovë të gjitha bankat bëjnë publikimin e NEI-së, ashtu siç përcaktohet edhe në bazë të rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës.

Në vijim po japim të dhënat e normës efektive të interesit për periudhën 2010 – 2014:

NORMA EFEKTIVE E INTERESIT E INDUSTRIË BANKARE (NEI)					
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Kredi	14.3 %	13.9 %	12.9 %	11.1 %	10.8 %
Depozita	3.4 %	3.6 %	3.7 %	2.1 %	1.0 %

Tab. 7 | Burimi: BQK - Norma efektive e interesit (31 tetor 2014)

Norma Efektive e Interesit ka shënuar ulje të vazhdueshme në vitet e fundit dhe kjo mund të vërehet edhe nga tabela nr.7 e paraqitur. Norma efektive e interesit në fund të muajit shtator 2014 është 10.8% për kredi, përderisa për depozita 1%. Në krahasim me fundin e vitit 2010, NEI për kredi ka shënuar rënie për 3.5%. Vlera me e ultë e NEI-së për kredi e shënuar gjatë këtij viti, ka qenë ajo në muajin qershor 2014 kur ishte 10.5%.

Në figurën nr.7 mund të shohim trendin e normës efektive nga viti 2010 deri në shtator 2014. Në vitin 2010, norma efektive e interesit për kredi ishte 14.3%, përderisa në muajin shtator 2014 është 10.8%. Në anën tjetër norma efektive e interesit për depozita ka shënuar ngritje nga viti 2010 deri në vitin 2012 dhe pastaj ka pësuar rënie më të theksuar në vitet 2013 dhe 2014.




Fig.7 | Burimi: BQK - Norma efektive e interesit (31 tetor 2014)

Vlen të theksohet se rënia në normën efektive të interesit për depozita në vitet e fundit është një trend i përgjithshëm rajonal dhe europian si p.sh. në Gjermani është raportuar se disa banka aplikojnë normë negative të interesit për depozita siç është rasti i bankës Deutsche Skatbank që aplikon një normë të interesit -0.25 % për depozita, që do të thotë se klienti duhet të paguaj bankën për mbajtjen e depozitave. Megjithatë, është pozitive që normat e interesit për kredi në Kosovë, sipas trendeve të lartëcekura janë në rënie, gjë që nënkupton se kreditë në vitin 2014 janë më të favorshme për klientët e bankave krahasuar me periudhat paraprake.

VËSHTRIMI PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR NËNTOR 2014



NUMRI I BANKAVE DHE I TË PUNËSUARVE NË INDUSTRINË BANKARE NË KOSOVË

Industria bankare në Kosovë që nga viti 2001 dhe deri në këtë periudhë, vazhdimisht ka shënuar rritje në pothuajse të gjitha vlerat e saj, gjë që tregon se industria bankare ka themeluar baza të shëndosha të funksionimit duke ofruar siguri dhe besim tek klientët. Industria bankare vazhdimisht ka kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit përmes procesit të huadhënies duke qenë profitabil dhe me një portfolio të shëndoshë, gjë që ka bërë që edhe numri i bankave që funksionojnë në treg të rritet.

Numri i bankave të cilat kanë hyrë në treg në industrinë bankare të Kosovës është rritur në vazhdimësi. Në vijim të kësaj mund të gjeni tabelën numër 1 e cila tregon numrin e bankave të cilat kanë licensën e operimit të marrë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës si dhe numrin e të punësuarve në këtë industri.

INDUSTRIA BANKARE NË KOSOVË					
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Numri i bankave	8	8	8	9	10
Numri i të punësuarve	3,610	3,728	3,727	3,549	3,510

Tab. 1 | Burimi: BQK - Rrjeti i KTD-ve dhe numri i të punësuarve (22 dhjetor 2014)

Deri në tetor të vitit 2014 nga Banka Qendrore e Kosovës janë të licensuara gjithsej dhjetë banka, përderisa numri i të punësuarve në këtë industri ka shënuar 3,510 punëtorë. Sa i përket numrit të të punësuarve nga tabela e prezantuar mund të shohim se ky numër në vitin që e lëmë pas (2013), por edhe gjate këtij viti ka shënuar një rënie të lehtë. Një nga arsytet e mundshme për këtë ulje të lehtë të numrit të të punësuarve në këtë industri ka të bëjë me faktin se sektori bankar ka punuar në vazhdimësi të rritë efikasitet duke implementuar teknologji të reja dhe duke shfrytëzuar mundësitë e zhvendosjes së disa operacioneve jashtë organizatës apo siç njihet në termat e biznesit "outsourcing", ku kompani të specializuara kryejnë disa nga operacionet bankare sidomos të mirëmbajtjes së teknologjisë dhe aseteve tjera e që ndikonë në uljen e kostove operacionale por shpeshherë përcjellat edhe me reduktime në staf.

Kjo strategji e industrisë bankare është edhe në përputhje me strategjinë kombëtare të hartuar nga Banka Qendrore e Kosovës për reduktimin e përdorimit të paras së gatshme dhe rritjen e efikasitetit në banka për të mundësuar shërbime me kosto më të ulët dhe për të reduktuar ekonominë jo informale përmes implementimit të shërbimeve elektronike bankare.

Një arsye tjetër pse numri i punëtorëve nuk është rritur në proporcion me rritjen e numrit të bankave në tregun e Kosovës, është fakti që dy bankat e fundit ende gjenden në fazat e hershme të hyrjes në treg, prandaj nuk kanë një numër të madh të të punësuarve, por pritet që me zgjerimin e tyre në tregun e Kosovës të ketë edhe rritje të stafit.

DEPOZITAT NË RAPORT ME KREDITË E INDUSTRIJË BANKARE

Depozitat dhe kreditë e industrisë bankare në Kosovë kanë shënuar rritje të vazhdueshme, duke mos shënuar asnjë vit të vetëm me rritje negative. Kjo mund të shihet nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr.2, me ç'rast nga viti 2010 dhe deri në fund të muajit tetor 2014 të dy këto të dhëna kanë shënuar rritje të vazhdueshme megjithëse vërehet se ka ngadalësim të rritjes në vazhdimësi.

KREDITË DHE DEPOZITAT E INDUSTRIJË BANKARE					
Milionë euro*					
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Kredi	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,854.0
Depozita	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,514.0
Raporti kredi-depozita	75.3%	80.7%	77.4%	73.7%	73.7%
Rritja e kredive	13.2%	16.4%	3.8%	2.4%	2.7%
Rritja e depozitave	11.0%	8.6%	8.3%	7.5%	2.7%

Tab. 2 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese (22 dhjetor 2014)

Në fund të muajit tetor 2014 vlera totale e gjithsej depozitave ka arritur në 2,514 milionë euro, përderisa kreditë në 1,854 milionë euro. Raporti ndërmjet kredive dhe depozitave është në 73.7%, që nënkupton se bankat kanë arritur të ruajnë likuiditetin e tyre për të qenë në gjendje që të mbulojnë detyrimet e tyre në çdo kohë, megjithëse ky likuiditet mund të konsiderohet se është më i lartë se sa është i dëshirueshëm nga vet institucionet bankare.




Fig.1 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese (22 dhjetor 2014)




Fig.2 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese (22 dhjetor 2014)

Nga figura nr.1 mund të shihet trendi pozitiv i rritjes simultane të depozitave dhe kredive. Ky trend pozitiv i rritjes mund të shihet edhe në figurën nr.2 i cili tregon në përqindje prej vitit në vit këtë rritje.

Edhe pse rritja e depozitave dhe kredive është pozitive, megjithatë trendi i rritjes mund të vërehet që në vitet e fundit ka pësuar ngadalësim. Në tetor 2014 rritja për kredi dhe depozita ishte 2.7%, gjë që rezultoi në rritje më të madhe për kredi në krahasim me vitin 2013 (2.4%), mirëpo rritje më të ulët për depozita se sa në vitin 2013 (7.5%). Përmes këtij trendi mund të kuptohet se industria bankare vazhdon të jetë e qëndrueshme financiarisht, përderisa dy komponentet kryesore të saj vazhdojnë të shënojnë vlera pozitive të rritjes.

DEPOZITAT E EKONOMIVE FAMILJARE NË RAPORT ME GJITHSEJ DEPOZITAT

Burim kryesor i të hyrave për industrinë bankare në Kosovë vazhdojnë të jenë depozitat e ekonomive familjare. Kjo mund të shihet nga tabela nr.3, ku në tetor të vitit 2014 depozitat familjare përbëjnë 68.7% të gjithsej depozitave të industrisë bankare.

DEPOZITAT E EKONOMIVE FAMILJARE NË RAPORT ME GJITHSEJ DEPOZITA					
Milionë euro*					
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Depozita bruto	1,936.8	2,104.0	2,104.0	2,449.0	2,514.0
Depozitat e ekonomive familjare (DEF)	1,206.1	1,373.4	1,535.4	1,658.7	1,726.9
Përqindja e DEF-ve	62.3%	65.3%	73.0%	67.7%	68.7%
Rritja e DEF-ve	27.1%	13.9%	11.8%	8.0%	4.1%

Tab. 3 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese (22 dhjetor 2014)

Ashtu sikurse rritja e vazhdueshme e gjithsej depozitave edhe depozitat e ekonomive familjare kanë shënuar rritje ndër vite. Megjithatë, edhe pse rritja e depozitave për ekonomitë familjare është pozitive, trendi i rritjes është në ulje. Kjo mund të shihet nga trendi i paraqitur në figurën nr.3.




Fig.3 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese (22 dhjetor 2014)

KREDITË PËR EKONOMITË FAMILJARE DHE KREDITË SIPAS SEKTORËVE EKONOMIK NË RAPORT ME GJITHSEJ KREDITË

Kreditë e gjeneruara për ekonomitë familjare përbëjnë një pjesë të rëndësishme të portfolios së industrisë bankare në aktivitetin e saj të huadhënies. Në tetor të 2014 industria bankare për ekonomitë familjare ka lëshuar gjithsej 603.1 milionë euro. Kjo vlerë paraqet 32.5% të gjithsej kredive të gjeneruara nga sektori bankar. Siç shihet në tabelën nr. 4, vlerat e kredive të gjeneruara për ekonomitë familjare kanë shënuara rritje të vazhdueshme paralelisht me rritjen e kredive bruto të gjeneruara, meqenëse përqindja e pjesëmarrjes së kredive për ekonomitë familjare në raport me bruto kreditë e gjeneruara është afërsisht e njëjtë nëpër vite duke shënuar një ngritje të lehtë viteve të fundit.

KREDITË NË RAPORT ME KREDITË FAMILJARE					
Milionë euro*					
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Kreditë bruto	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,854.0
Kreditë e ekonomive familjare (KEF)	434.2	510.9	542.6	563.9	603.1
Përqindja e KEF-ve	29.8%	30.1%	30.8%	31.2%	32.5%
Rritja e KEF-ve	26.4%	17.7%	6.2%	3.9%	7.0%

Tab. 4 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese (22 dhjetor 2014)

Kreditë e gjeneruara për ekonomitë familjare në tetor 2014 janë rritur për 7% në raport me fundin e vitit 2013, që paraqet një trend më të mirë se sa në dy vitet e fundit kur kreditë për ekonomitë familjare ishin rritur për 6.2% (2012) apo për 3.9% (2013). Ky trend pozitiv i rritjes më të madhe në vitin 2014 në raport me dy vitet e kaluara mund të vërehet edhe nga figura nr. 4 e paraqitur.




Fig.4 | Burimi: BQK - Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese (22 dhjetor 2014)

Krahas kredive të gjeneruara për ekonomitë familjare, pjesën më të rëndësishme të portfolios kreditorë të industrisë bankare e përbëjnë kreditë e gjeneruara për ndërmarrjet private apo thënë më saktësisht për sektorët ekonomik të Kosovës. Në tabelën nr. 5 mund të shohim gjithsej vlerat e kredive të gjeneruara sipas sektorëve ekonomik. Në tetor 2014 vlera totale e kredive të gjeneruara për sektorët ekonomikë ka arritur në 1,246.3 milionë euro, përderisa pjesën më të madhe të këtyre kredive e përbëjnë kreditë e gjeneruara për shërbime me 902.8 milionë euro.

KREDITË SIPAS SEKTORËVE EKONOMIK					
					Milionë euro*
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
<i>Bujqësia</i>	38.2	40.5	43.6	45.8	48.2
<i>Industria, energjetika dhe ndërtimoria</i>	269.3	284.7	290.4	291.4	295.3
<i>Shërbimet</i>	715.3	824.4	860.2	880.2	902.8
<i>Gjithsej kreditë sipas sektorëve ekonomik</i>	1,022.8	1,149.5	1,194.2	1,217.4	1,246.3

Tab. 5 | Burimi: BQK – Kreditë e KTD-ve sipas sektorëve ekonomik (22 dhjetor 2014)

Kreditë e gjeneruara për sektorët ekonomik të shërbimeve përfshijnë tregtinë me shumicë dhe pakicë, hotelet dhe restaurantet si dhe shërbime të tjera të ndërlidhura. Ndërkohë që pjesën tjetër të kredive e përbëjnë kreditë e gjeneruara për industri, energjetikë dhe ndërtimtari me 295.3 milionë euro si dhe kredi për bujqësi me 48.2 milionë euro.

PËRQINDJA E PJESËMARRJES NË RAPORT ME KREDITË SIPAS SEKTORËVE EKONOMIK					
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
<i>Bujqësia</i>	3.7%	3.5%	3.7%	3.8%	3.9%
<i>Industria, energjetika dhe ndërtimoria</i>	26.3%	24.8%	24.3%	23.9%	23.7%
<i>Shërbimet</i>	69.9%	71.7%	72.0%	72.3%	72.4%

Tab. 6 | Burimi: BQK – Kreditë e KTD-ve sipas sektorëve ekonomik (22 dhjetor 2014)




Fig.5 | Burimi: BQK - Kreditë e KTD-ve sipas sektorëve ekonomik (22 dhjetor 2014)

Në bazë të tabelës nr.6 dhe figurës nr.5 të paraqitur mund të shohim se në tetor 2014, 72.4% e gjithsej kredive të gjeneruara për sektorët ekonomik e përbëjnë kreditë e gjeneruara për shërbime, përderisa 23.7% e përbëjnë kreditë për industri, energjetikë dhe ndërtimtari dhe 3.9% e përbëjnë kreditë e gjeneruara për bujqësi.

Kreditë për shërbime prej vitit 2010 kanë shënuar rritje të lehtë, përderisa kreditë për industri, energjetikë dhe ndërtimtari kanë shënuar ulje të lehtë. Ngritje të vogël në përqindje kanë shënuar gjithashtu edhe kreditë bujqësore.

REFERENCAT

REFERENCA: VËSHTRIM PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR TË KOSOVËS PUBLIKIMI NR. 1 - JANAR 2014

- Raporti vjetor 2012, Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës <http://bqk-kos.org/?id=102>
- Vlerësimi tremujor i ekonomisë #4, Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës <http://bqk-kos.org/?id=102>

REFERENCA: VËSHTRIM PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR TË KOSOVËS PUBLIKIMI NR. 2 - SHKURT 2014

- Raporti vjetor (2012) Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës <http://bqk-kos.org/?id=102>
- Bilanci i Gjendjes për korporatat e tjera depozituese (2013) Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës ; <http://bqk-kos.org/?id=55>

REFERENCA: VËSHTRIM PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR TË KOSOVËS PUBLIKIMI NR. 3 - MARS 2014

- Depozitat në euro sipas maturitetit (shkurt, 2014), Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës <http://bqk-kos.org/?id=55>
- Kreditë në euro sipas maturitetit (shkurt, 2014), Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës <http://bqk-kos.org/?id=55>
- Kreditë e reja (shkurt, 2014), Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës <http://bqk-kos.org/?id=55>
- Kreditë sipas aktivitetit ekonomik (shkurt, 2014), Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës, <http://bqk-kos.org/?id=55>
- Kreditë sipas sektorëve ekonomik (shkurt, 2014), Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës, <http://bqk-kos.org/?id=55>

REFERENCA: VËSHTRIM PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR TË KOSOVËS PUBLIKIMI NR. 4 - PRILL 2014

- Sistemi i Pagesave (dhjetor, 2013), Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës, <http://bqk-kos.org/?id=55>
- Rrjeti i korporatave tjera depozituese dhe numri i te punësuarve (shkurt, 2014), Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës, <http://bqk-kos.org/?id=55>
- Remitencat sipas kanaleve (dhjetor, 2014), Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës, <http://bqk-kos.org/?id=55>
- Remitencat sipas vendeve (dhjetor, 2014), Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës, <http://bqk-kos.org/?id=55>

REFERENCA: VËSHTRIM PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR TË KOSOVËS PUBLIKIMI NR. 5 - MAJ 2014

- Pasqyra e të ardhurave (prill, 2014), Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës, <http://bqk-kos.org/?id=55>

REFERENCA: VËSHTRIM PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR TË KOSOVËS PUBLIKIMI NR. 6 - QERSHOR 2014

- Norma efektive të interesit (dhjetor,2013), Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës, <http://bqk-kos.org/?id=55>

REFERENCA: VËSHTRIM PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR TË KOSOVËS PUBLIKIMI NR. 7 - KORRIK 2014

- Raporti Vjetor 2013, Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës, <http://bqk-kos.org/?id=102>
- Kreditë bankare joperformuese në raport me bruto totalin e kredive, Banka Botërore, <http://data.worldbank.org/indicator/FB.AST.NPER.ZS/countries>

REFERENCA: VËSHTRIM PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR TË KOSOVËS PUBLIKIMI NR. 8 - GUSHT 2014

- Deutsche Bank, SWIFT Transfer Instructions, 20 gusht 2014 - <http://www.deutschebank.co.in/swift-transfer.html>
- Raporti vjetor 2013, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2014/BQK-RV-Shqip-2013.pdf>
- Regjistri i Kredisë, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,55> dhe <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,191>
- Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication, 28 gusht 2014 - http://www.swift.com/about_swift/index
- Wikipedia, International Bank Account Number, 20 gusht 2014 - http://en.wikipedia.org/wiki/International_Bank_Account_Number

REFERENCA: VËSHTRIM PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR TË KOSOVËS PUBLIKIMI NR. 9 - SHTATOR 2014

- Shoqata e Bankave të Kosovës, Procesverbal 23-24 Shtator 2014 nga Panairi Financiar 2014,
- Shoqata e Bankave të Kosovës, 30 shtator 2014 - <http://bankassoc-kos.com/panairi-financiar>
- Shoqata e Bankave të Kosovës - Raporti i Panairit Financiar 2007, 2009, 2011, 2012 dhe 2013

REFERENCA: VËSHTRIM PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR TË KOSOVËS PUBLIKIMI NR. 10 - TETOR 2014

- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i Gjendjes së Korporatave tjera depozituese, 31 tetor 2014, <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>;
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Norma Efektive e Interesit për Korporatat tjera Depozituese, 31 tetor 2014, <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>;
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Pasqyra e të Ardhurave e Korporatave tjera depozituese, 31 tetor 2014, <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>;
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti i Informatave Mujore, Numri 1 - 8, <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,249>;
- <http://www.telegraph.co.uk/finance/newsbysector/banksandfinance/11210057/Interest-rates-are-so-low-that-Germans-are-paying-to-keep-money-in-banks.html>

REFERENCA: VËSHTRIM PERIODIK MBI SEKTORIN FINANCIAR TË KOSOVËS PUBLIKIMI NR. 11 - NËNTOR 2014

- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i Gjendjes së Korporatave tjera Depozituese, 22 dhjetor 2014, <http://bqk-kos.org/?id=55>;
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Kreditë e Korporatave Tjera Depozituese sipas Aktivitetit Ekonomik, 22 dhjetor 2014, <http://bqk-kos.org/?id=55>;
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Rrjeti i Korporatave tjera Depozituese dhe Numri i të Punësuarve, 22 dhjetor 2014, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

PJESA II

- LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE

LAJME NGA SEKTORI BANKAR QË SHËNUAN MUAJIN JANAR 2014

RRETH 48% E DEPOZITAVE JANË TË AFATIZUARA

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka njoftuar se depozitat e klientëve në bankat komerciale janë rritur në vlerën 2.36 miliardë euro. Rreth 48 për qind e depozitave janë të afatizuara, ndërsa raporti i kredive ndaj depozitave mbetet në nivelin 76 për qind. Po sipas BQK-së, norma e interesit në kredi nga bankat komerciale ka shënuar rritje të vogël krahasuar me periudhën paraprake. Në mesatare, norma e interesit për muajin nëntor ka qenë 12.2 për qind. Rritja e mesatares së përgjithshme për 0.5 pikë përqindje krahasuar me tetorin e 2013-s erdhi kryesisht si rezultat i rritjes së lehtë të normave të interesit për korporata jofinanciare”, ka njoftuar BQK-ja. (Telegrafi, 9 janar 2014)

STRATEGJI PËR LUFTIMIN E EKONOMISË JOFORMALE

Ekonomia jo formale mbetet edhe më tej një ndër prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës ka thënë ministri i Financave, Besim Beqaj në takimin kushtuar hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit. Ministri Beqaj theksoi se ekonomia jo-formale është e dëmshme për të gjithë: ajo ka efekte negative për vet bizneset, të punësuarit dhe Qeverinë dhe për këtë arsye është e rëndësishme që institucionet të bëjnë më të mirën për të luftuar këtë dukuri dhe rrjedhimisht, për të ofruar një ambient më të volitshëm për të bërë biznes. Ministri Beqaj tha se është me rëndësi që Strategjia për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë jo-formale, pastrimit të parave dhe financimin e krimeve ekonomike të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe reflektim i konsultimeve me të gjitha palët e interesit, si një parakusht për implementim më të lehtë. (Tribuna, Zëri dhe Kosova Sot, 9 janar 2014)

KOSOVA ENDE PA KODIN IBAN

Pas përdorimit të SWIFT kodit bankar të Republikës së Kosovës nga institucionet financiare në vend, autoritetet kompetente në Prishtinë janë në përpjekje të pajisen edhe me Numrin Ndërkombëtar të Llogarisë Bankare, i njohur me shkurtesën IBAN, bëjnë të ditur zyrtarë të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Numri Ndërkombëtar i Llogarisë Bankare, apo IBAN, quhet formati i numrit të llogarisë bankare, i cili format standardizon identifikimin ndërkombëtar të llogarive bankare dhe është në përdorim nga shumë shtete në botë. Qëllimi parësor i përdorimit të formatit IBAN, sipas zyrtarëve të BQK-së, është zvogëlimi i rrezikut të gabimeve në transkriptimin e numrave të llogarive bankare, shkruan “Evropa e Lirë”. Ekspertë për çështje ekonomike konsiderojnë se aplikimi i numrit ndërkombëtar të llogarisë bankare, do të përshpejtojë edhe më tepër transaksionet bankare. (Telegrafi, 20 janar 2014)

KOSOVA KA STABILITET FINANCIAR

Të hënën në mbledhjen e Komisionit Kombëtar për Stabilitet Financiar dhe Menaxhim të Krizës, Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Bedri Hamza, në cilësinë e kryesuesit të këtij komisioni ka vlerësuar se sektori financiar vazhdon të ketë nivel të lartë të qëndrueshmërisë dhe trend pozitiv të zhvillimit, duke shërbyer si mbështetës i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik në vend. Kurse ministri i Financave Besim Beqaj dhe Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës Safete Hadërgjonaj u zotuan për vazhdimin e bashkëpunimit konform këtij Memorandumi, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar në vend. (Kosova Sot, Zëri, Tribuna, Telegrafi, 21 janar 2014)

KOSOVARËT, 2 MILIARDË EURO KURSIME NË BANKA

Qytetarët e Kosovës, të cilët thuhet se kanë pagat më të ulëta në rajon dhe është vendi me nivel të lartë të papunësisë, kanë depozita në nivel mjaft të lartë në bankat komerciale, që funksionojnë në Kosovë. Vlera e kursimeve apo depozitave të klientëve në nëntë bankat komerciale ka arritur në 2 miliardë e 441 milionë euro, ka bërë të ditur guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Bedri Hamza. “Ka pasur rritje të depozitave dhe kjo rritje e depozitave në raport me vitin paraprak është 7.6 për qind. Profesori i ekonomisë, Musa Limani, tha se

nëse qytetarët kanë arritur të kursejnë mbi 2 miliardë euro dhe ato para gjenden në bankat komerciale, atëherë sipas Limanit ky duhet të jetë një sinjal i mirë, pasi që kjo do të mundësonte uljen e normave të interesit në kredi. (Telegrafi & Kosova Sot, 27 janar 2014)

FMN PARASHIKIME OPTIMISTE PËR EKONOMINË BOTËRORE

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), është bashkuar me qëndrimin e Bankës Botërore (BB) dhe ka projektuar një pamje mjaft optimiste për ekonominë botërore në të ardhmen. Kështu, rritja globale, sipas prognozave të FMN, nga tri për qind vitin e kaluar do të rritet në 3.7 për qind këtë vit, por vendet e industrializuara dhe ato në ekspansion ekonomik do të rriten me ritme të ndryshme. Në një kohë kur vendet e industrializuara mund të presin një rritje me 1.3 deri 2.2 për qind, vendet në ekspansion ekonomik dhe në zhvillim do të rriten nga 4.7 për qind në vitin e kaluar, në rreth 5.1 për qind këtë vit. (Zëri & Telegrafi, 23 janar 2014)

BB: EKONOMIA GLOBALE ME RITJE NË 2014

Ekonomia botërore është në një “pikë kthese”, kështu është shprehur Banka Botërore (BB), dhe parashikon një rritje të fortë për vitin 2014. Në raportin e saj vjetor mbi ekonominë botërore, banka ka raportuar se vendet më të pasura “më në fund po bëjnë kthesën” pas krizës financiare. Kjo pritet të mbështesë rritjen më të fuqishme në ekonominë në zhvillim. Banka Botërore parashikon se GDP globale do të rritet me 3.2 për qind këtë vit, nga 2.4 për qind në vitin 2013. Ndërsa, në vendet në zhvillim do të rritet me 5.3 për qind këtë vit, nga 4.8 për qind në vitin 2013. (Telegrafi, 16 janar 2014)

LAJME NGA SEKTORI BANKAR QË SHËNUAN MUAJIN SHKURT 2014

SISTEMI FINANCIAR I QËNDRUESHËM

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), ka njoftuar se sistemi financiar i Kosovës ka vazhduar të reflektojë nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët përbërës të tij. Sipas BQK-së, sektori bankar, si përbërësi kryesor i sistemit financiar të Kosovës, ka ruajtur nivelin e qëndrueshmërisë, përdërisa aktiviteti ndërmjetësues financiar ka vazhduar të rritet por me ritëm të ngadalësuar. Në Raportin e Stabilitetit Financiar të BQK-së, thuhet se përmirësimi i treguesve kryesor makroekonomik në Kosovë, krahasuar me vitin e kaluar, paraqet shenja inkurajuese për ambientin afarist në vend, por që nuk ka ndikuar në rritjen e gatishmërisë së sektorit bankar për një zgjerim më të shpejtë të kredidhënies drejtë ekonomisë vendore.. (Telegrafi, 5 shkurt 2014)

IFC-JA INVESTON NË RAIFFEISEN

IFC, anëtare e Grupit të Bankës Botërore, do të investojë deri në 150 milion Euro në Raiffeisen Bank International (RBI), financim i cili do të kanalizohet në filialet e bankës në Evropën Qendrore dhe Lindore, për të nxitur rimëkëmbjen ekonomike dhe zhvillimin në rajon. Filialet e RBI-së në Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Poloni dhe Rusi do të përfitojnë nga investimi i IFC-së në rritjen e kapitalit të RBI-së. Shuma përfundimtare e investimit të IFC-së do të konfirmohet kur transaksioni të mbyllet dhe pritet të kontribuojë në përmirësimin e qasjes në financa dhe fuqizimin e ndërmarrjeve private në rajon. (Zëri, 11 shkurt 2014)

BANKAT RRISIN FITIMIN PËR 48,1%

Sipas BQK-së, performanca e sektorit bankar shënoi përmirësim. Fitimi neto i sektorit në qershor 2013 është rritur për 48,1 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke arritur vlerën 15.2 milionë euro. Megjithëse, sipas BQK-së, të hyrat e sektorit kanë shënuar rënie vjetore prej 1,2 për qind, e shpenzimet kanë pësuar rënie më të theksuar prej 4,7 për qind, duke ndikuar kështu në rritjen e fitimit të sektorit bankar. Të hyrat nga interesi, që përfshijnë të hyrat nga interesi në kredi, letra me vlerë, dhe plasmanët me bankat e tjera, vazhdojnë të jenë kategoria dominuese e të hyrave me pjesëmarrje 80,8 për qind. (Zëri, 19 shkurt 2014)

VITI 2013, VIT I LETRAVE ME VLERË

Banka Qendrore e Kosovës (BQK), ka njoftuar deri në dhjetor 2013, kalendarit i publikuar për letra me vlerë ka qenë i paraparë të ketë 12 ankande me afat maturimi 91 ditë, 7 ankande për periudhë maturimi 182 ditë dhe 2 për afat maturimi 364 ditë. Mirëpo, si rezultat i ofertimit të ulët në instrumentet afatshkurtra, Departamenti i Thesarit ka ndryshuar afatin e maturimit për ankandin e dhjetorit nga 91 ditë në 364 ditë. Kjo si rezultat i ofertimit më të lartë të bankave për instrumentet me afat më të gjatë. Për dallim nga periudhat paraprake, në ofertim nga akterët primar ka pasur ndryshim duke u vërejtur një lëvizje nga letrat me vlerë 3 mujore në drejtim të atyre më afatgjata. Rrjedhimisht, në ofertimet tremujore ka pasur rënie substanciale në tetor dhe nëntor ku akterët primar mbuluan 97 përkatësisht 62 për qind të kërkesës së Departamentit të Thesarit për letra me vlerë. Edhe për tri ankandet një vjeçare ka pasur ofertim të lartë ndërsa norma e interesit ka shënuar rënie nga 1.98 për qind në tetor në 1.71 për qind në dhjetor. Këto zhvillime në kuadër të letrave me vlerë në përgjithësi reflektojnë pozicionin e favorshëm të likuiditetit të bankave si dhe orientimin e tyre në drejtim të instrumenteve afatgjata që kanë kthim më të lartë. (Telegrafi, 28 shkurt 2014)

ASETET E BANKAVE 3 MILIARDË EURO

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), ka njoftuar se sektori bankar në Kosovë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2013 u karakterizua me zhvillime pozitive. Asetet e bankave komerciale arritën vlerën prej 3.06 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8 për qind. Rritja kryesisht i atribuohet rritjes së theksuar të investimeve në letrat me vlerë dhe rezervave të mbajtura në BQK. Për dallim nga tremujorët paraprak për herë të parë në TM4 2013, investimet në letrat me vlerë, tejkaluan në vlerë rezervat e mbajtura në BQK. Investimet arritën vlerën 354.5 milion euro, duke shënuar rritje vjetore prej 38 për qind (27 për qind në 2012). (Zëri, 24 shkurt 2014)

SHQIPËRIA, ME LIGJ PËR KREDITË E KËQIJA

Qeveria e Shqipërisë pritet të miratojë një ligj, i cili qartëson përfundimisht marrëdhëniet e bankave me tatimet për kreditë e këqija. Drafti, i cili ndryshon Ligjin për tatimin mbi të ardhurat, përcakton kriteret se kur kredia e keqe do të konsiderohet si shpenzim i zbritshëm, me qëllim që bankat të mos kenë konflikte me tatimorët. Sipas tij, tatimet janë të detyruara ta njohin kredinë e keqe si shpenzim të zbritshëm për bankat, në rast se plotësohen dy kushte. Së pari, për kreditë që janë të siguruara me kolateral të kenë kaluar 365 ditë nga koha kur bankat kanë depozituar kërkesën për ekzekutim tek përmbaruesi. Ndërsa, kreditë pa kolateral do të njihen si shpenzim i zbritshëm 365 ditë pas lëshimit nga gjykata të urdhër ekzekutimit për asete të ndryshme që mund të ketë debitori. (Kosova Sot & Tribuna, 24 shkurt 2014).

LAJME NGA SEKTORI BANKAR QË SHËNUAN MUAJIN MARS 2014

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS TAKOHET ME MISIONIN E FMN-SË

Në vazhden e takimeve të misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në Kosovë, më datën 27 mars 2014, u mbajt një takim në mes të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) dhe anëtarëve të saj, bankat komerciale në Kosovë, dhe misionit të FMN-së që po viziton Kosovën këto ditë. Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës Z. Petrit Balijs, tha se “Në këtë takim u diskutuan çështje me rëndësi për industrinë bankare ku është konkluduar se industria bankare është stabile dhe ka likuiditet të mjaftueshëm por njëkohësisht kemi ngritur shqetësimet tona në lidhje me ngecjet e gjyqësorit në lidhje me trajtimin lëndëve bankare dhe ekzekutimin e kontratave gjë që lidhet me riskun e lartë në Kosovë ku kemi mbi 10,000 lëndë të papërfunduara”. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) në këtë takim u përfaqësua nga përfaqësuesi rezident i FMN-së për Kosovë, zt. Jose Sulemane, znj. Pamela Madrid, ekonomiste e lartë e Departamentit Evropian, dhe zt. Jacques Miniane, shëf i misionit të FMN-së për Kosovën, Departamenti Evropian. Zt. Petrit Balijs, shtoi duke thënë se ky takim është mjaft i rëndësishëm për industrinë bankare dhe se takime dhe diskutime të tilla janë gjithnjë të frytshme dhe japin rezultate të mira në të ardhmen. Në këtë takim ishin prezent edhe të gjithë kryeshefët ekzekutiv të bankave komerciale që operojnë në Kosovë, anëtarë të SHBK-së. (Shoqata e Bankave të Kosovës, 27 mars 2014)

KOSOVA RREZIKON PROGRAMIN E RI ME FMN-NË

Përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) kanë shprehur shqetësimet e tyre për vendimet e fundit të Qeverisë së Kosovës. Ata gjatë takimit të djeshëm, që kishin me kryeparlamentarin Jakup Krasniqi, kanë reaguuar lidhur me këto vendime, që janë marrë në prag të zgjedhjeve parlamentare. “Përfaqësuesit e FMN-së kanë shprehur shqetësim për tri çështje për vendimin e Qeverisë për rritjen e pagave, i cili, sipas tyre, nuk është në përputhje me rritjen ekonomike, po ashtu edhe për miratimin e Ligjit për veteranët e luftës, ku kanë vërejtje se si ligji është miratuar pa u ditur numri i përfituesve, ndërsa për shpalljen e fituesit për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Shkup, ata thanë se ky projekt rrezikon stabilitetin financiar në vend”, ka treguar burimi i gazetës ‘Kosova Sot’. (Kosova Sot, 26 mars 2014)

NËNSHKRUHET KONTRATA KOLEKTIVE

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi dhe përfaqësues të OEK, AKB-së, BSPK-së dhe KES-it, kanë nënshkruar kontratën e përgjithshme kolektive, e cila përcakton të drejtat, obligimet dhe përgjegjësinë e punëdhënësit dhe punëmarrësit. Kryeministri Thaçi, pas nënshkrimit të kësaj kontrate pohoi se kjo marrëveshje ka rëndësi të veçantë pasi që rrit stabilitetin e punëtorëve në vendin e tyre të punës. Ai po ashtu tha se Qeveria e Kosovës do të jetë garantuese e zbatimit të kësaj marrëveshje, transmeton Kosovapress. “Nga kjo marrëveshje e cila ka dobi të madhe do të përfitojnë punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe se do ta përmirësojë klimën e tregut në vend”, ka deklaruar kryeministri. (Koha Ditore, Telegrafi, Zëri, Tribuna, 19 mars 2014)

BANKA EVROPIANE, E INTERESUAR T’I NDIHMOJË BIZNESET

Konferenca “Financim më të mirë për bizneset”, organizuar nga Banka Evropiane për Investime, ka mbledhur një numër të madh të investitorëve vendorë dhe të huaj, si dhe përfaqësues të bizneseve. Aty u diskutua për mbështetjen e projekteve, për tërheqjen e investitorëve dhe detaje tjera për përmirësimin e mjedisit të biznesit. Besim Beqaj, ministër i Financave, thotë se Kosova si një shtet i ri, nuk qëndron keq, sidomos në investimet në infrastrukturë. Zëvendëspresidenti i Bankës Evropiane për Investime, Dario Scannapico, ka thënë se në këtë konferencë do të tregohet se si të përdoren dhe se si të promovohen së bashku financimin më të mirë për bizneset në Kosovë. Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë ndërkaq se Qeveria e Kosovës ka përmirësuar mjedisin afariste dhe ka ngritur normat ligjore të rritjes ekonomike deri në 4.5 për qind. (Telegrafi, 19 mars 2014)

BANKAT KOMERCIALE NË KOSOVË DO TË TRANSMETOJNË KREDITË E BANKËS EVROPIANE PËR INVESTIME

Banka Evropiane për Investime pritet të mbështesë Kosovën me kredi, që, sipas ministrit të Financave, Besim Beqaj, janë kredi me kushte të volitshme. Kreditë e kësaj banke nuk do të jepen direkt për bizneset private, por do të kalojnë nëpërmjet atyre bankave komerciale që operojnë në Kosovë, e që janë të interesuara të bashkëpunojnë me Bankën Evropiane për Investime. Deri tani një marrëveshje për bashkëpunim e ka nënshkruar vetëm një bankë në Kosovë, por, sipas Beqajt, këtë do të mund ta bënin të gjitha bankat komerciale që janë të interesuara. Beqaj ka thënë se bankat do të jenë të obliguara ta respektojnë marrëveshjen që do të bëjnë me Bankën Evropiane për Investime, dhe se kreditë do t'i transmetojnë në bazë të asaj marrëveshjes. Ky bashkëpunim është vazhdimësi e marrëveshjes kornizë të nënshkruar në mes të Bankës Evropiane për Investime dhe Kosovës në qershor të vitit të kaluar. Ndërkohë që pritet të shtyjë përpara edhe ndërtimin e hekurudhave dhe rrugën Prishtinë-Pejë. Zëvendës-presidenti i Bankës Evropiane për Investime, Dario Scannapieco, ka thënë se Banka Evropiane për Investime është e përkushtuar për të mbështetur ekonominë e Kosovës. (Koha Ditore, Tribuna – 18 mars 2014)

UNIONI BANKAR EVROPIAN NË RREZIK

Planet e Europës për krijimin e unionit bankar janë vënë në rrezik për shkak të mosmarrëveshjeve në lidhje me sistemin e mbylljes së bankave që mund të falimentojnë. Gjermania po kundërshton presionin e Parlamentit Europian dhe kërkon një modernizim të vendimmarrjes të mbikëqyrësit të vetëm dhe një forcim të fondit që do të financojë koston e mbylljes së bankave. Zyrtarë të lartë të përfshirë në bisedime shprehën skepticizmin e tyre për të kapërcyer hendekun midis palëve dhe për të arritur një marrëveshje deri në fund të këtij muaji. Edhe Parlamenti Europian po tregon pak sinjale se mund të heqë dorë nga kërkesat kryesore. (Kosova Sot, Telegrafi, 13 mars 2014)

LAJME NGA SEKTORI BANKAR QË SHËNUAN MUAJIN PRILL 2014

NORMAT E INTERESIT PËR KREDI ME TREND TË RËNIES

Sektori bankar në Kosovë që nga koha e pasluftës ka treguar në vazhdimësi stabilitet dhe qëndrueshmëri financiare gjë që ka bërë të reflektoj siguri dhe besim tek qytetarët ndaj institucioneve financiare në Kosovë. E gjithë kjo është arritur përmes një pune të palodhshme, sfidave dhe problemeve me të cilat ky sektor është ballafaquar, në një ambient afarizmi të vështirë siç është Kosova. Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, thotë se “të dhënat për sektorin bankar dëshmojnë se ka pasur ngritje të kreditimit, ngritje të cilësisë së ofrimit të shërbimeve në mënyrë graduale por të vazhdueshme dhe njëkohësisht sistemi bankar ka arritur që përkundër sfidave të ndryshme në tregun e Kosovës të mbaj stabil parametrat kryesore të saj”. Këtë e argumentojnë edhe të dhënat e publikuara në baza të rregullta nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), gjë që tregon se ky sektor ka qenë bartës i shumë zhvillimeve ekonomike në Kosovë. “Të dhënat e publikuara nga BQK tregojnë se norma efektive e interesit në kredi nga viti 2010 ka shënuar ulje në nivele të konsiderueshme. Në fund të vitit 2010 norma efektive e interesit ishte 14.31 për qind, përderisa në fund të vitit 2013 kjo normë u zvogëluar në 11.07 për qind. Kjo tregon se vetëm brenda tri viteve mesatarja e interesit për kreditë e lëshuara nga ky sektor është zvogëluar për 3.24 për qind. Ky nivel i konsiderueshëm i uljes së normave të interesit nuk mund të injorohet sidomos kur kemi parasysh ambientin afarist në të cilin vepron ky sektor dhe nivelin e sundimit të ligjit”, shprehet Balija. (Indeksonline & Telegrafi, 3 prill 2014)

KURSIMET E KOSOVARËVE KANË ARRITUR RRETH 2 MILIARDË E GJYSMË

Industria bankare në Kosovë vazhdon të jetë e qëndrueshme dhe me afarizëm profitabil. Sipas raportit të Bankës Qendrore të Kosovës mbi statistikën e sektorit financiar, kapitali i bankave komerciale në muajin shkurt arriti në 283.4 milionë euro, apo 0.8 për qind më shumë krahasuar me shkurtin e vitit 2013, kurse neto fitimi i tyre në dy muajt e parë të 2014-tës shënoi vlerën 5.4 milionë euro. Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija thotë për Radio Kosovën se kjo është pozitive edhe për ekonominë vendore. “Edhe këtë vit fitimi i bankave është i mirë, që kontribuon për industrinë bankare të jetë stabile dhe të vazhdojë me një afarizëm profitabil, gjë që është mirë edhe për ekonominë e Kosovës”, thotë Balija. Bruto kreditë e bankave komerciale në shkurt shënuan vlerën 1.8 miliard euro, përderisa depozitat e klientëve në këto banka shënuan vlerën 2.4 miliardë euro. Normat e interesit në depozita kanë shënuar rënie në shkurt për 0.6 për qind krahasuar me muajin paraprak. Në mesatare, norma e interesit në depozita për muajin shkurt ka qenë 2 për qind dhe paraqet nivelin më të ulët që nga viti 2004. Kjo sipas Z. Balija ka ndodhur për disa arsye. “Kryesisht si rezultat i lëvizjeve të normave të interesit në Eurozonë por nëse shikojmë likuiditetin aktual të bankave shihet se nuk është në favor të stimulimit të depozitave. Prandaj kjo është një masë ndoshta dekurajuese për depozitat në raport me likuiditetin që kanë bankat”, thekson ai. (RTK Live, 2 prill 2014)

SË SHPEJTI FORMOHET FONDI GARANTUES PËR KREDI

Së shpejti pritet të krijohet Fondi Garantues për Kredi në Kosovë, i financuar nga donatorët e huaj. Kështu paralajmërojnë zyrtarët e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që kanë iniciuar formimin e tij. Sipas tyre, fondi parashihet të ketë 11 milionë euro dhe do të lehtësojë qasjen në financa të ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Krijimin e tij e mirëpresin edhe përfaqësuesit e komunitetit të biznesit. Ministri, Bernard Nikaj, thotë se janë koordinuar me shumicën e donatorëve dhe janë afër përfundimit të marrëveshjes që të krijojnë një fond mirëbesimi dhe një institucion të pavarur, në të cilin të gjithë donatorët e interesuar për çështjen e garantimit të kredive, do t'i vendosin fondet e tyre. (Indeksonline, 1 prill 2014)

LEHTËSIRA PËR INVESTIME TË HUAJA

Ministri i Financave, Besim Beqaj, paralajmëroi se Qeveria e Republikës së Kosovës shpejt do të aprovojë dokumentin e lehtësirave për investime në Kosovë. “Dhe ne e kemi menduar dhe jemi dakorduar sot edhe me biznesin që të kemi së paku 4 kategori të lehtësirave. Kategoria e parë është ajo e cila do të shkojë për investime të reja mbi 19 milionë euro dhe krijim mbi 150 vende pune e cila do të ketë pushim nga taksat për 7 vite. Për investimet që do të shkojnë deri në 10 milionë euro dhe krijojnë së paku 100 vende pune do të aplikohet pushimi

nga taksat së paku për 5 vjet. Për investime të reja prej 2 deri në 5 milionë euro dhe së paku 50 vende të reja të krijuara për punësim, pushimi nga taksat do të jetë për 4 vjet, ndërsa për investime deri në 2 milionë euro, që ka të bëjë me investimet e vogla, që ka të bëjë me bizneset e të rinjve, që ka të bëjë me biznese të grave dhe biznese tjera të cilat janë të natyrës dhe investimit më të vogël, por që hapin së paku 30 vende pune, pushimi do nga taksat do të jetë për 3 vjet”, tha ministri Beqaj. (Telegrafi, Zëri, Kosova Sot, Tribuna, 11 prill 2014)

BANKA QENDRORE EVROPIANE, PROGRAM BASHKËPUNIMI ME ATO NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka nisur sot një program bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë (BSH), Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) dhe Bankën Kombëtare të Republikës së Maqedonisë (BPRM). Për këtë program, Bashkimi Evropian (BE) ka dhënë 500 mijë euro nga fondet e Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit. Programi synon përgatitjen e këtyre bankave qendrore për anëtarësim në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (ESCB), pasi ekonomitë përkatëse të kenë përmbushur kërkesat për anëtarësim në BE. Gjithashtu bëhet e ditur se në kuadrin e programit, do të përgatiten raporte për vlerësimin e nevojave për BSH-në dhe BQK-në, duke identifikuar progresin e mëtejshëm që duhet bërë për përmbushjen e standardeve të BE-së për bankat qendrore. (Telegrafi, 22 prill 2014)

LAJME NGA SEKTORI BANKAR QË SHËNUAN MUAJIN MAJ 2014

SHQIPËRIA DHE KOSOVA BASHKËORGANIZOJNË FORUMIN PËR SIGURINË BANKARE NË PRIZREN

Sot përfundoi punimet Forumi i Tretë Kombëtar Për Sigurinë Bankare, në Prizren. Forumi bashkoi ekspertët nga fusha e sigurisë bankare të cilët në këtë tryezë diskutuan rreth temave aktuale dhe zhvillimeve më të fundit në lëmin e sigurisë, me ç'rast adresoi të dy elementet e sigurisë bankare, pra asaj fizike dhe të informacionit. Për herë të parë, forumi është mbajtur me bashkë-organizim të shoqatave bankare të dy vendeve, Kosovës dhe Shqipërisë. Gjatë forumit, përfaqësues të dy vendeve nga bankat komerciale, bankat qendrore, policia dhe agjencia shtetërore për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe kompani të huaja për ofrimin e zgjidhjeve në lëmin e sigurisë së informacionit, shpalosen brengat dhe zgjidhjet e tyre lidhur me sigurinë fizike dhe atë të informatave. (Shoqata e Bankave të Kosovës, 29 maj 2014).

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS MERR PJESË NË FORUMIN SHQIPTAR KOMBËTAR TË KARTELAVE

Në ambientet e hotel Sheraton në Tiranë, të Premtën është mbajtur Forumi i Katërtë Kombëtar i Kartelave me temë Biznesi i Kartelave – Zhvillimet dhe Inovacionet , me organizimin e Shoqatës Shqiptare të Bankave. Në forum pjesëmarrëse ishte edhe Shoqata e Bankave të Kosovës ku nënkryetari i Komitetit Kundër Mashtrimeve me Kartela, Z. Fisnik Behxheti mbajti prezantimin rreth biznesit të kartelave të bankave në Kosovë. Z. Behxheti prezantoi detaje dhe statistika mbi nivelin e përdorueshmërisë së kartelave bankare si instrument pagese, me ç'rast u vënë në dukje arritjet e Kosovës në përfshirjen e madhe të kësaj forme të pagesave, në raport me rajonin. (Shoqata e Bankave të Kosovës, 19 maj 2014)

“ZIRAAT BANK”, APLIKON NË BQK

Tregun bankar kosovar me kapitalin e tyre po e dominojnë bankat austriake dhe gjermane, kurse kohëve të fundit vërehet një lloj ekspansioni bankar nga bankat komerciale turke, që aktualisht janë tri sish. Sipas BQK-së, mësohet se tashmë edhe banka e katërt komerciale me kapital turk kanë parashtruar kërkesën e tyre për një leje pune licencim dhe janë në pritje të vendimit. Besnik Kada, zëdhënës në BQK, tha për “Kosova SOT” se në Departamentin e Licencimit dhe të Standardizimit të BQK-së, të Republikës së Kosovës, është pranuar një aplikacion nga një bankë e huaj dhe bëhet fjalë për një nga bankat më të mëdha në Turqi, “Ziraat Bank”. “Kërkesa e bankës “Ziraat” është që të themelojë një degë të bankës në Kosovë, që merret me aktivitetet bankare, ndër të cilat edhe me kreditë për bujqësi, si një aktivitet më i specializuar i kësaj banke në Turqi”, tha Kada. (Kosova Sot, 23 maj 2014).

QYTETARËT NUK I BLEJNË HIPOTEKAT E KREDIVE

Lidhur më këtë ekspertë për çështje ekonomike, japin vlerësime të ndryshme. Mungesa e kulturës për të blerë objekte për mes ankandit publik, bëjnë që qytetarët të hezitojnë në këtë drejtim, thotë Berat Rukiqi, nga Oda Ekonomike e Kosovës. “Është një element i riskut sidomos për hipotekat të cilat janë pjesë e pronësisë së përbashkët të familjes së gjerë. Për shkak se në aspektin e kulturës që është trashëguar më vite ka një lloj, konsultimi apo ‘marrje leje’ nga ata që i ke fqinjë dhe në këtë drejtim ka hezitim”, thekson Rukiqi. Mentaliteti i qytetarëve se patundshmëria që shitet nga banka nuk duhet të blihet është i gabuar, konsideron Milazim Abazi, ekspert për çështje financiare. Mosinteresi për blerje të hipotekës, thotë ai, ndikon negativisht edhe për klientin që nuk ka mundësi të paguajë këstet e kredisë. (Telegrafi, 5 maj 2014).

MBI 14 MIJË BIZNESE U SHUAN, 130 MIJË BIZNESE TË REJA U HAPËN

Në Kosovë regjistrohen vazhdimisht biznese të reja, por gjithashtu edhe shuhen. Mehdi Pllashniku, koordinator për çështje juridike dhe praktike në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në kuadër të MTI-së, thotë se vetëm sivjet prej datës 1 janar – 13 maj 2014, janë regjistruar 4122 biznese të reja. Prej datës 1 janar 2000 deri më 13 maj 2014 janë regjistruar 130 mijë e 708 biznese. Po gjatë kësaj kohe , janë shuar 14 mijë e 299 biznese. Ekonomisti Visar Hapçiu nga Oda Ekonomike Amerikane në Prishtinë tha se numri i ndërmarrjeve të reja të themeluara, edhe pse mund të jetë tregues i një ambienti ku është lehtë të hapet biznes, jo domosdoshmërisht është tregues i zhvillimit ekonomik të atij vendi. (Kosova Sot, 15 maj 2014).

NGA MUAJI KORRIK, KOSOVA PJESË E 'KARTONIT TË GJELBËR'

Rrahim Pacolli kryesues i delegacionit të Kosovës për të dialoguar me Brukselin lidhur me kartonin e gjelbër ka thënë për Tribuna se Kosova që nga muaji korrik do të jetë pjesë e 'kartonit të gjelbër'. "Kemi qenë në bisedime edhe më herët dhe kemi sinjale për arritjen e kësaj marrëveshje", ka thënë Pacolli. Ai ka sqaruar se Këshilli i Byrosë Evropiane të Sigurimeve, është pajtuar që kompanitë Kosovare të Sigurimeve ta kenë një buxhet të përbashkët i cili faktikisht na dërgon një hap përpara drejt kartonit të gjelbër. "Paralel marrëveshjes me palën serbe njëkohësisht do të arrihet një marrëveshje për një fond në Evropë edhe për fillimin e shitjes së policave të kartonit të gjelbër", ka thënë Pacolli. Bazuar në raportin e Bankës Qendrore deri më tash kompanitë e sigurimeve kanë arkëtuar të hyra të konsiderueshme nga policat kufitare, ndërkohë që përqindja e kompensimit të dëmeve është tejet simbolike. Të hyrat nga policat kufitare të kompanive të sigurimeve kanë qenë dhjetëra miliona euro në vit. (Tribuna, 15 maj 2014).

KOSOVA VAZHDON TË KETË NORMAT MË TË LARTA TË INTERESIT NË KREDI (INTERVISTË ME ZT. PETRIT BALIJA)

Radio Kosova: Sektori financiar në Kosovë, veçmas ai bankar vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Sa është zhvilluar ky sektor nga viti në vit?

Petrit Balija: Sektori bankar në Kosovë është relativisht i ri nëse e krahasojmë me rajonin dhe vendet tjera. Ne kemi filluar me licencimin e bankës së parë në vitin 2001, dhe që nga atëherë tani i kemi 9 banka dhe e 10-ta vetëm sa ka aplikuar për licencim, prandaj mendoj që ka pasur një zhvillim mjaft të mirë në sektorin bankar brenda një periudhe të shkurtër. Njëkohësisht performansa është duke u përmirësuar çdoherë. Në vitin 2013 kemi pasur një performansë të shkëlqyer dhe ndoshta një prej më të mirave në vitet e fundit, prandaj mendoj se sistemi bankar ka performuar mjaft mire viteve të fundit

Radio Kosova: Ndërkohë ka ngecur dhënia e kredive por edhe e depozitave. Këtë e pasqyron në raportin e fundit edhe banka botërore. Sa i përket kredive për çfarë ka ndodhur ngecja, për shkak të rënies së kërkesës apo ashpërsimit të kritereve nga ana e bankave?

Petrit Balija: Dhënia e kredive varet nga oferta dhe kërkesa. Oferta nga ana e sektorit bankar nuk mungon, sepse kemi mjete të mjaftueshme t'i plasojmë në treg por ka pasur rënie të kërkesës sidomos në disa sektorë kyç të ekonomisë sonë, të cilët po përjetojnë vështirësi gjatë këtyre viteve dhe nuk kanë një zhvillim të hovshëm, ka rënë interesi dhe mund të them që kërkesat që i kemi nuk janë shumë fizibile për dhënien e kredive. Në anën tjetër, ashpërsimi i kritereve mund të ketë ndodhur për këta sektorë që po përjetojnë vështirësi, sepse edhe për bankat paraqet një rrezik më të lartë. Por në përgjithësi bankat janë të interesuara që të plasojnë mjetet e tyre sepse kanë tepricë, kanë likuiditet të tepërt, por kërkesa nuk është në nivel të duhur.

Radio Kosova: Sa është aktualisht vlera e kredive dhe e depozitave?

Petrit Balija: Në depozita kemi rreth 2.4 miliardë euro, kurse në portofolin e kredive kemi 1.8 miliardë.

Radio Kosova: Vërehet shpërputhje e madhe mes normave të interesit në kredi dhe në depozita. Normat e interesit në kredi ende janë shumë të larta, kurse ato ën depozita janë ulur ndjeshëm kohëve të fundit. Pse ndodh një gjë e tillë?

Petrit Balija: Ne duhet t'i shikojmë trendët në aspekte më afatgjate, sepse lëvizjet afatshkurtra janë të shumta dhe e bëjnë konfuz qytetarin dhe konsumatorin. Nëse i shikojmë trendët afatgjate prej vitit 2010 deri në vitin 2013 në normën mesatare të interesit të kredive kemi rënie prej 3.5 për qind. Ndërsa në depozita po ashtu kemi rënie prej një pike të përqindjes, pra nga 3 për qind ku ishte norma e depozitave para tri viteve, tani e kemi në 2 për qind mesataren. Depozitat tash janë në një nivel ku janë dekurajuese për konsumatorët që të bëjnë kursime, por në anën tjetër i stimulojnë që të bëjnë investime dhe normat e interesit për kredi janë duke reflektuar këtë rënie të interesit në depozita. Normal që rënia nuk mund të reflektohet menjëherë, duhet 6 deri në 7 muaj që të përfundohen edhe kontratat që i kemi pasur me klientët e ndryshëm por gjithsesi rënia në normat e depozitave nënkupton uljen e kostove të fondeve për bankat dhe automatikisht nënkupton edhe uljen e normës së interesit për kredi. Por ne si shoqatë e bankave dhe si industri bankare kemi për qëllim që në vazhdimësi të bëjmë uljen e normave të interesit në shpërputhje me riskun e tregut. Normal që ne nuk mund të ulim normat e interesit duke rrezikuar industrinë, pra duke mos përfillur riskun në treg por në raport me rënien e riskut do t'i ulim edhe normat e interesit.

Radio Kosova: Por normat e interesit në kredi janë më të lartat në rajon apo?

Petrit Balija: Po, normat e interesit në kredi janë më të lartat në rajon. Normat e interesit sa i përket kredive individuale nuk janë aq të larta. Serbia i ka më të larta se Kosova, kështu që ne jemi brenda mesatares sa i përket kredive personale, por kur është fjala për kreditë e biznesit ende jemi në nivel më të lartë se rajoni.

Radio Kosova: Për çfarë ndodh gjë e tillë?

Petrit Balija: Për shkak të riskut që paraqitet në tregun tonë. P.sh. ne jemi në listuar në vendin e 138-të nga 180 vende të botës për zbatimin e kontratave. Do të thotë kur lidhet një kontratë në mes të bankës dhe kredimarrësit është shumë problem që të zbatohet kjo kontratë në përpikëri. Në momentin që paraqitet ndonjë dështim ose vështirësi për kthimin e kredisë banka gjendet në një pozitë shumë të pafavorshme, ku ligji nuk është në dispozicion të bankës për të zbatuar kontratën në fjalë dhe kjo paraqet një problem shumë të madh. Kjo reflektohet në faktin që kemi mbi 10 mijë lëndë të bllokuara në gjykata që paraqesin një vlerë rreth gjysmë miliardi euro.

Radio Kosova: Brenda çfarë periudhe kohore janë akumuluar të gjitha këto lëndë?

Petrit Balija: Këto janë akumuluar gjatë dhjetë vjetëve të fundit, ka lëndë të cilat janë më të vjetra se 5 vjet, por ka edhe lëndë të reja. Mirëpo gjithsej janë 10 mijë e 500 lëndë, me 250 milionë euro vlerë, që do të thotë se ne duhet të provizionojmë edhe 250 milionë tjera e kjo paraqet gjysmë miliardë euro të cilat nuk i ka ekonomia e Kosovës në shfrytëzim.

Radio Kosova: Bankat a po hasin në vështirësi të shitjes së hipotekave?

Petrit Balija: Këtu kemi të bëjmë me disa probleme më të thella ndoshta edhe kulturore në Kosovë të cilat shpeshherë i kanë përcjellë disa zakone që nuk janë të mira për ekonominë moderne, dhe kur bëhet fjalë për shitjen e një prone të një individi i cili ka jetuar me vite aty, ndoshta edhe me shekuj në aspektin familjar, atëherë është problem që të shitet ose të blihet nga ndonjë palë tjetër. Mendoj që ne duhet të reformohemi si shoqëri në këtë drejtim sepse ekonomia moderne, ekonomia e tregut të lirë kërkon një reformim të tillë ku të bëhet tregtimi i lirë dhe të mos ketë pengesa të tilla. Për fakti fat të keq ende është që shpeshherë palët që dëshirojnë ta blejnë pronën nuk ndjehen të sigurt që ta bëjnë një gjë të tillë. Pastaj banka gjendet në një pozitë ku duhet ta shesë pronën ndoshta edhe në vlerën e saj të tregut dhe të dalë me humbje në atë kredi.

Radio Kosova: Vazhdon niveli i lartë i kredive joperformuese, që njihen si kredi të këqija, ndonëse prapë mbeten më të ulëtat në rajon. Por sipas jush, a ka rrezik të shkojnë drejt rritjes?

Petrit Balija: Në vitet e fundit kemi vërejtë një trend rritës mjaft shqetësues, i cili me shpejtësi është ngritur në tri vitet e fundit, ka arritur në 8.6 për qind, kurse gjatë gjashtë muajve të fundit ka qëndruar stabil. Stabiliteti aktual është falë interesimit të bankave që mbajnë një stabilitet në normat joperformuese sepse kur e kemi vërejtur që kemi një problem në rritje, atëherë bankat e kanë bërë si prioritet që niveli i tyre të mos rritet shumë shpejt. Dhe falë këtyre masave dhe kujdesit të industrisë bankare, kemi arritur të stabilizojmë nivelin e kredive joperformuese. Por në anën tjetër kemi presion që të bëjmë kredidhënie më të madhe, të zhvillojmë dhe të stimulojmë ekonominë dhe është shumë vështirë që të balancohet ky akt kur në njërin anë i stimulojmë bizneset dhe japim kredi më shumë dhe në anën tjetër e kontrollojmë nivelin e kredive joperformuese dhe e kontrollojmë dhënien e kredive të rrezikshme.

Radio Kosova: Kthehem edhe njëherë te kreditë, struktura e kredive. Prej vlerës së përgjithshme, sa është pjesëmarrja e ekonomive familjare dhe sa e bizneseve?

Petrit Balija: Kjo është interesant nëse analizohet sepse nëse i shikojmë depozitat fillimisht shohim që kemi më shumë depozita nga ekonomitë familjare dhe më pak nga bizneset e nga ana tjetër kemi më shumë kredi për bizneset dhe më pak për ekonomitë familjare dhe kjo nënkupton që ekonomitë familjare janë duke i financuar janë duke i financuar bizneset e Kosovës, pra më shumë ka kredi për biznese sesa për ekonomitë familjare diku në raport 75 me 25 për qind.

Radio Kosova: Ka filluar tashmë edhe dhënia e kredisë së gjelbër nga Teb banka, me mbështetje të BERZH-it. Sa po e shfrytëzojnë këtë kredi klientët?

Petrit Balija: Kjo kredi është një shembull shumë i mirë i produkteve inovative, të cilat industria bankare po tenton t'i plasojë në tregun tonë. Dhe kjo kredi iu mundëson agro-bizneseve që të kenë kredi më të favorshme dhe ka pasur menjëherë interesim të madh nga agro-bizneset. Në këtë rast banka në fjalë ka marrë një kredi afatgjatë dhe po ashtu do t'i japë edhe biznesit një afat më të gjatë të kthimit të kredisë dhe kjo mendojmë që do të ulë edhe normën e interesit por edhe barrën për biznesin, në mënyrë që ata të kenë një qarkullim më të lehtë të parasë në biznesin e tyre.

Radio Kosova: Përveç realizimit të kontratave, me çfarë sfidash tjera përballen sektori bankar?

Petrit Balija: Po ajo është sfida primare, por ka edhe sfida tjera, psh kemi problem me kadastrin, ndonëse kohëve të fundit kadastrin ka ndërmarrë një projekt të madh në regjistrimin e parcelave dhe kemi bashkëpunim shumë të mirë me kadastrin dhe mendoj që është duke u bërë progres, por ende ekzistojnë disa probleme në këtë drejtim. Përndryshe ekzistojnë edhe probleme të pasqyrave financiare të bizneseve. Tash për tash pasqyrat financiare të bizneseve nuk janë të verifikueshme, sidomos për bizneset e mesme dhe të vogla, sepse nuk janë të obliguara të raportojnë askund për pasqyrat e audituara. Njëkohësisht ne nuk kemi qasje në agjencinë e tatimeve që t'i shohim ato pasqyra financiare, kështu që pasqyrat të cilat ne i pranojmë nga bizneset janë krejtësisht të pabazuara dhe është shumë vështirë për bankën që të matë riskun në mënyrë adekuate. Pra një sistem i raportimit të pasqyrave të audituara, ku bankat do të mund t'i verifikonin ato pasqyra do të bënte që të eliminohet edhe një barrierë.

Radio Kosova: Shërbimet online të bankave, në çfarë niveli po shfrytëzohen nga klientët?

Petrit Balija: Bankat kanë investuar shumë në këtë drejtim viteve të fundit. Kjo është në përputhje edhe me strategjinë kombëtare për reduktimin e përdorimit të parave të gatshme të themeluar nga BQK-ja dhe nëse i shikojmë statistikën kemi një dyfishim të shërbimeve elektronike gjatë vitit të fundit, gjë që është shumë inkurajuese dhe jemi duke parë një rritje shumë të mirë të përdorimit të shërbimeve elektronike. Besoj që edhe konsumatorët po shohin benefitin nga përdorimi i tyre, kursimin e kohës, janë mjaft të sigurt dhe janë më të lira sesa shërbimet fizike.

Radio Kosova: Çfarë planesh keni sivjet si shoqatë, por edhe sektori bankar në përgjithësi?

Petrit Balija: Për këtë vit prioritetet e kemi problemin e gjyqësorit, dhe jemi duke punuar ngushtë me BQK-në dhe institucionet relevante, në mënyrë që të reduktojmë numrin e lëndëve të bllokuara dhe që të përmirësojmë sistemin e përbarimit, i cili tashmë ka filluar të aktivizohet por paraqiten disa probleme edhe në legjislacion por edhe në implementim, të cilat i kemi adresuar edhe tek Këshilli Gjyqësor dhe shpresojmë që ta kemi prioritet këtë vit dhe ta zgjidhim çështjen e gjyqësorit dhe lëndëve financiare në gjykata.

Radio Kosova: Sa i përket fondit prej 1.5 miliardë eurosh, që është përmendur të investohet në Kosovë përmes bankave. A është diskutuar ende kjo gjë me ju dhe a jeni në gjendje të luani rolin e ndërmjetësit nëse kërkohet nga ju?

Petrit Balija: Sa i përket fondit të investimeve ende është e paqartë sesi është menduar ky fond. Megjithatë industria bankare e mirëpret çfarëdo fondi që ka të bëjë me stimulimin e bizneseve, sepse edhe ne si industri kemi problem me gjendjen aktuale të bizneseve, sepse sic thashë nuk ka kërkesë të mjaftueshme nga bizneset dhe po shkakton edhe likuiditet të tepërt në bankat tona. Pra çdo iniciativë që do të stimulonte sektorin privat dhe ekonominë e Kosovës për ne është e mirëseardhur. Sa i përket aspekteve teknike të implementimit të këtij fondi, mendoj se duhet të jetë brenda parimeve të tregut të lirë, licencimeve adekuate që kërkohen dhe nëse kërkohet edhe nga bankat që të ndihmojnë në këtë drejtim, besoj që edhe bankat do të jenë të gatshme që të kontribuojnë për çfarëdo fondi që i ndihmon ekonominë së Kosovës. (Radio Kosova, 27 maj 2014)

Ref: [http://www.rtklive.com/new/index.php?cid=11,1&newsId=101664&mf8d^drM\)or*0kcw-8q#5_](http://www.rtklive.com/new/index.php?cid=11,1&newsId=101664&mf8d^drM)or*0kcw-8q#5_)

mGe-aez4#-5i2/3T^iw~0(LVm=n(ds0Cz3v~80xa993Bk2l&m1zIC9J5rtd735s#&8s6=8wmi0r8*tBm

LAJME NGA SEKTORI BANKAR QË SHËNUAN MUAJIN QERSHOR 2014

PRITEN NORMA NJËSHIFRORE TË INTERESIT PËR KREDI

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK), Petrit Balijs, ka deklaruar se ardhja e bankës “Ziraat Bank” në tregun e Kosovës është lajm shumë i mirë sepse, sipas tij, ardhja e një banke serioze në Kosovë do ta pasurojë edhe më shumë nivelin e konkurrencës brenda sektorit.

“Mendoj se konkurrenca gjithmonë ndikon pozitivisht në ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe përmirësimin e ofertës. Jemi duke punuar vazhdimisht t’i eliminojmë barrierat për afarizmin bankar në tregun e Kosovës, në mënyrë që ky treg të jetë sa më atraktiv për bankat e reja dhe të gjenerojmë interesim në këtë drejtim”, ka thënë Balijs. Ai ka deklaruar se normat e interesit në Kosovë janë duke shënuar rënie. “Shpeshherë citohen analistë të ndryshëm që thonë se normat e interesit në Kosovë janë mbi 15 për qind, por nuk mund të thuhet tani, pasi norma mesatare e interesit për kredi ka rënë dukshëm në 10.6 për qind në fund të muajit prill 2014”, ka theksuar ai.

Balijs në këtë intervistë për gazetën “Epoka e re” ka bërë me dije se deri në vitin e ardhshëm pritet të ulen normat e interesit për kredi. “Mendoj se deri në vitin e ardhshëm do të arrijmë në norma të interesit njëshifror”, ka potencuar ai. Sa iu përket normave të larta të interesit për kredi, ai ka deklaruar se ato nuk mund të jenë të ulëta si në vendet e zhvilluara për shkak të riskut që paraqitet në tregun tonë. “Në momentin që paraqitet ndonjë dështim ose vështirësi për kthimin e kredisë, banka gjendet në një pozitë shumë të pafavorshme, sepse ligji nuk është në dispozicion të bankës për ta zbatuar kontratën në fjalë, e kjo paraqet problem shumë të madh. I kemi mbi 10 mijë lëndë të bllokuara në gjykata që paraqesin një vlerë rreth gjysmë miliard euro”, ka shtuar ai.

“Epoka e re”: Si e vlerësoni tregun bankar në Kosovë?

Balijs: Sektori bankar në Kosovë është relativisht i ri nëse e krahasojmë me rajonin dhe vendet e tjera. Ne kemi filluar me licencimin e bankës së parë në vitin 2001 dhe që nga atëherë tani i kemi nëntë banka, të 10-s vetëm sa i është aprovuar licenca. Prandaj, mendoj se ka pasur zhvillim mjaft të mirë në sektorin bankar brenda një periudhe të shkurtër. Njëkohësisht performanca është duke u përmirësuar çdoherë. Në vitin 2013 kemi pasur performancë mjaft të mirë, duke gjeneruar një fitim prej 26 milionë eurosh për vitin 2013 e që, krahasuar me vitin 2012, ishte 18.5 milionë euro më shumë, prandaj mendoj se sistemi bankar ka performuar mjaft mirë vitet e fundit me gjithë vështirësitë që paraqiten në tregun e Kosovës.

“Epoka e re”: Meqenëse ka pasur kritika për normat e larta të interesit, atëherë cilët janë shkaktarët që bankat nuk i kanë ulur normat e interesit?

Balijs: Normat e interesit në Kosovë janë duke shënuar rënie. Shpeshherë citohen analistë të ndryshëm që thonë se normat e interesit në Kosovë janë mbi 15 për qind, gjë që nuk mund të thuhet tanimë, pasi norma mesatare e interesit për kredi ka rënë dukshëm në 10.6 për qind në fund të muajit prill 2014. Prandaj, mendoj se deri në vitin e ardhshëm do të arrijmë në norma të interesit njëshifrore. Arsyeja pse normat e interesit për kredi nuk mund të jenë të ulëta si në vendet e zhvilluara është për shkak të riskut që paraqitet në tregun tonë. Vazhdimisht kam potencuar se jemi listuar në vendin e 136-të nga 189 vende të botës për zbatimin e kontratave, që do të thotë kur lidhet një kontratë në mes të bankës dhe kredimarrësit është shumë problem të zbatohet kjo kontratë në përpikëri. Në momentin që paraqitet ndonjë dështim ose vështirësi për kthimin e kredisë, banka gjendet në një pozitë shumë të pafavorshme, ku ligji nuk është në dispozicion të bankës për ta zbatuar kontratën në fjalë dhe kjo paraqet një problem shumë të madh. Kjo reflektohet në faktin që kemi mbi 10 mijë lëndë të bllokuara në gjykata që paraqesin një vlerë rreth gjysmë miliard euro.

“Epoka e re”: Vitet e fundit kanë ardhur banka turke në Kosovë. A po shndërrohet Kosova në treg bankar të bankave turke?

Balija: Kur bëhet fjalë për afarizëm nuk mendoj se është shumë e rëndësishme se nga cili shtet vjen investitori, por shumë më rëndësi është se cili është koncepti i tyre i biznesit dhe si mund të ndikojë në krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë. Në këtë rast, bëhet fjalë për banka me renome botërore, që krijojnë vende të reja pune dhe financojnë ekonomitë familjare dhe bizneset kosovare.

“Epoka e re”: Mendoni se licencimi i bankës së fundit turke do të ndikojë në uljen e normave të kamatës për kredi?

Balija: Mendoj se është lajm shumë i mirë që kemi edhe një bankë serioze në Kosovë, e kjo gjithsesi do ta pasurojë edhe më shumë nivelin e konkurrencës brenda sektorit. Mendoj se konkurrenca gjithmonë ndikon pozitivisht në ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe përmirësimin e ofertës. Jemi duke punuar vazhdimisht t’i eliminojmë barrierat për afarizmin bankar në tregun e Kosovës, në mënyrë që ky treg të jetë sa më atraktiv për bankat e reja dhe të gjenerojmë interesim në këtë drejtim.

“Epoka e re”: Tashmë është ulur norma e interesit për depozita. Si erdhi deri te kjo?

Balija: Duke pasur parasysh që raporti në mes të depozitave dhe kredive gjatë vitit 2013 ka qenë rreth 75 për qind, kjo ka krijuar një likuiditet më të lartë dhe si rezultat kostoja e fondeve është rritur. Prandaj, për ta ruajtur stabilitetin bankar, bankat është dashur t’i ulin normat e interesit në depozita për ta stabilizuar industrinë nga aspekti i likuiditetit dhe koston së fondeve.

“Epoka e re”: Disa parti politike kanë paraparë të krijojnë politika të reja ekonomike, njëra fondin zhvillimor, tjetra agrobankën. Sa e dëmton kjo sistemin bankar?

Balija: Janë propozuar modalitete të ndryshme nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore, por ne ende nuk kemi propozime konkrete me sqarime të mjaftueshme për të dhënë vlerësime. Megjithatë, mendoj se çdo iniciativë që do ta ndihmonte zhvillimin ekonomik të vendit do të përkrahim, me kusht që këto iniciativa të jenë brenda kornizave ligjore dhe parimit të tregut të lirë.

“Epoka e re”: A keni pasur diskutime me investitorë të huaj, të cilët janë të interesuar të investojnë në Kosovë për normat e larta të kredive? Nëse po, si e perceptojnë ata këtë?

Balija: Ne nuk kemi zhvilluar ndonjë hulumtim në këtë drejtim, por mendoj se shumë nga investitorët e huaj janë më të brengosur për sundimin e ligjit, zbatimin e kontratave dhe nivelin e zhvillimit ekonomik të Kosovës sesa për mundësitë e financimit. Në Kosovë normat e interesit nuk janë fikse dhe negociohen edhe në bazë të riskut që paraqet klienti dhe nëse një investitor i huaj është kompani serioze me risk të ulët, atëherë do të ketë mundësi të marrë kredi me norma mjaft të volitshme të interesit. (Epoka e Re / 13 qershor 2014)

KONKURRENCA UL NORMAT E INTERESIT

Në katër muajt e parë të këtij viti ka rënie të depozitave për 0.9 për qind, kurse ka ngritje të kredive për 1.9 për qind. Normat e interesit në Kosovë janë mbi 15 për qind, por nuk mund të thuhet tani, pasi norma mesatare e interesit për kredi ka rënë dukshëm në 10.6 për qind në fund të muajit prill 2014. Ardhja e një banke të re në këtë treg ka shtuar konkurrencën, e cila ndikon pozitivisht në ngritjen e cilësisë së shërbimeve, në përmirësimin e ofertës, si dhe në uljen e normave të interesit, ka thënë Petrit Balija, drejtor ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës

Në tregun bankar të Kosovës 10 banka komerciale zhvillojnë veprimtarinë e tyre bankare, kurse ardhja e një banke të re në këtë treg ka shtuar konkurrencën, e cila ndikon pozitivisht në ngritjen e cilësisë së shërbimeve, në përmirësimin e ofertës, si dhe në uljen e normave të interesit, ka thënë Petrit Balija, drejtor ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Ai ka deklaruar se ardhja e Bankës “Ziraat Bank” nga Turqia dhe futja e saj në

tregun e Kosovës është lajm shumë i mire, sepse, sipas tij, ardhja e një banke serioze në Kosovë do ta pasurojë edhe më shumë nivelin e konkurrencës brenda sektorit. “Mendoj se konkurrenca gjithmonë ndikon pozitivisht në ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe përmirësimin e ofertës. Jemi duke punuar vazhdimisht t’i eliminojmë barrierat për afarizmin bankar në tregun e Kosovës, në mënyrë që ky treg të jetë sa më atraktiv për bankat e reja dhe të gjenerojmë interesim në këtë drejtim”, ka thënë për gazetën “Lajm”, Petrit Balija. Ai ka deklaruar se normat e interesit në Kosovë gradualisht janë duke shënuar rënie. “Shpeshherë citohen analistë të ndryshëm që thonë se normat e interesit në Kosovë janë mbi 15 për qind, por nuk mund të thuhet tani, pasi norma mesatare e interesit për kredi ka rënë dukshëm, ka rënë në 10.6 për qind në fund të muajit prill 2014”, ka theksuar Balija.

Ai për gazetën “Lajm” ka bërë të ditur se deri në vitin e ardhshëm pritet të ulen edhe më tutje normat e interesit të kredive për qytetarët, duke u rënë ato në njëshifror. “Mendoj se deri në vitin e ardhshëm do të arrijmë në norma të interesit njëshifror”, ka potencuar ai. Sa u përket normave të larta të interesit për kredi, ai ka deklaruar se ato nuk mund të jenë të ulëta si në vendet e zhvilluara për shkak të riskut që paraqitet në tregun tonë. “Në momentin që paraqitet ndonjë dështim ose vështirësi për kthimin e kredisë, banka gjendet në një pozitë shumë të pa favorshme, sepse ligji nuk është në dispozicion të bankës për ta zbatuar kontratën në fjalë, e kjo paraqet problem shumë të madh. I kemi mbi 10 mijë lëndë të bllokuara në gjykata që paraqesin një vlerë rreth gjysmë miliardë euro”, ka shtuar ai.

Sipas tij, ardhja e bankave të reja në tregun bankar të Kosovës e rrit konkurrencën, ndërsa, sipas tij, konkurrenca është pozitive, përkatësisht ndikon pozitivisht në ngritjen e cilësisë së shërbimeve, në përmirësimin e ofertës, si dhe në uljen e normave të interesit. “Ardhja e bankës “Ziraat Bank” në tregun e Kosovës është lajm shumë i mirë, pasi do ta pasurojë edhe më shumë nivelin e konkurrencës brenda sektorit dhe do të sjell oferta të reja për qytetarët dhe bizneset e Kosovës”, ka thënë Balija. “Mendoj se konkurrenca gjithmonë ndikon pozitivisht në ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe përmirësimin e ofertës. Jemi duke punuar vazhdimisht t’i eliminojmë barrierat për afarizmin bankar në tregun e Kosovës, në mënyrë që ky treg të jetë sa më atraktiv për bankat e reja dhe të gjenerojmë interesim në këtë drejtim”, ka thënë Balija.

Ai ka bërë të ditur se deri në muajin prill të vitit 2014 ka ulje të depozitave mbi 20 milionë euro më pak. “Deri në fund të muajit prill të vitit 2014, sektori bankar në Kosovë disponon me 2,430.1 milionë euro depozita apo 20.9 milionë euro më pak se sa në fundin e vitit 2013, kur depozitat kanë shënuar 2,451 milionë euro. Kjo nënkupton që kemi për 0.9 për qind ulje të depozitave për katër muajt e parë të vitit 2014”, ka shpjeguar Balija. Sipas tij, ekonomitë familjare kanë më së shumti depozitime nëpër banka apo 73.7 për qind. “Nga totali i depozitave, 2,430.1 milionë euro, 1,793 milionë euro janë depozita të ekonomive familjare. Pra, 73.7 për qind të gjithsejtë depozitave i përbëjnë depozitat e ekonomive familjare, përderisa pjesën tjetër të depozitave në vlerë prej 637 milionë euro e përbëjnë depozitat e bizneseve, kompanive dhe institucioneve të tjera publike”, ka theksuar ai.

Për katër muajt e parë të këtij viti depozitat kanë shënuar rënie, derisa kreditë kanë shënuar ngritje. “Për dallim nga depozitat që shënuan një ulje në katër muajt e parë të këtij viti, kreditë e lëshuara nga sektori bankar në prill të vitit 2014 arritën vlerën 1,839.7 milionë euro apo 33.9 milionë euro kredi më shumë se sa fundi i vitit 2013, kur vlera totale e kredive të lëshuara ishte 1,805.8 milionë euro”, ka nënvizuar Balija. “Kjo nënkupton që për 1.9 për qind është rritur vlera e kredive të lëshuara për katër muajt e parë të vitit 2014. Nga **totali i kredive të lëshuara** nga sektori bankar deri në fund të muajit prill 2014 arrin shifrën prej 571.2 milionë euro apo 31 për qind janë kredi të lëshuara për ekonomitë familjare, përderisa 1,268 milionë euro janë kredi të lëshuara për biznese apo për sektorë të tjerë”, ka thënë Balija. (18 qershor 2014 / Lajm, Kosova Sot, Telegrafi).

QEVERISJA KORPORATIVE, PRIORITET I BIZNESIT

Rrjeti CSR Kosova, mbështetur nga International Finance Cooperation (IFC), anëtare e grupit të Bankës Botërore, ka organizuar të mërkurën tryezën lidhur me zhvillimin e fundit në praktikat më të mira të të qeverisjes korporative, standarteve më të larta të BE-së në deklarimin dhe raportimin e integruar. Me këtë rast, kryetari i Bordit të Kosovës CSR Network, Robert Wright ka deklaruar se qeverisja korporative duhet të jetë një prioritet i lartë për sektorin e biznesit të Kosovës pasi sipas tij, për fat të keq, kjo nuk është praktikuar as sa është dashur. “Standardet e qeverisjes së korporatave në Kosovë janë më të ulëta se ajo qfarë konsiderohet normale apo e pranueshme në vitin 2014 në Evropë”, ka deklaruar ai. (12 qershor 2014 / Epoka e Re)

MILIONERËT, QË NUK IU DIHET BURIMI I PARAVE

Më gjithë ekzistimin e mekanizmave ligjor për raportimin e çdo transaksioni bankar mbi 10 mijë euro, qoftë nga individë apo subjekte të ndryshme në bankat komerciale, në Kosovë ka qytetarë milionerë pa ditur burimin e prejardhjes së mjeteve të tyre financiare, thonë ekspertë për çështje ekonomike.

Profesori Musa Limani, për Radion Evropa e Lirë, thotë se duhet të kontrollohen transaksionet bankare dhe institucionet financiare duhet të kërkojnë burimin e mjeteve. “Këta pse nuk e paraqesin është pa koment, për arsye se te ne nuk ka përgjegjësi dhe ‘peshqit e mëdhenj’ nuk i nënshtrohen këtyre procedurave. Përndryshe më ligj asnjë transaksion nuk mund të realizohet pa e ditur burimin. Për këtë arsye ne kemi milionerë të cilët nuk e paraqesin burimin e të ardhurave”, thotë Limani.

Në anën tjetër, Petrit Balijs, drejtor ekzekutiv në Shoqatën e Bankave të Kosovës, për Radion Evropa e Lirë thotë se është obligim ligjor që bankat komerciale në vend të kërkojnë burimin e transaksioneve. Ndërkaq, sipas ligjeve ndalohet publikimi i të dhënave të këtyre klientëve.

“Në fakt është Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave që ndalon publikimin e të dhënave të tij, por janë institucionet relevante shtetërore, ku raportohen këto informata”, thotë Balijs. Ndryshe, çdo transfer mbi 10 mijë euro që klientë të ndryshëm deponojnë në banka dhe institucione mikro-financiare, janë të obliguar të plotësojnë një formular për burimin e prejardhjes së fondve dhe përcaktimin e pronësisë së përfuturit. Këto procedura janë të parapara më Ligjin për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizimit. (24 qershor 2014 / *Telegrafi, Express, Tribuna, Radio Evropa e Lire*).

TRANSPARENCA BUXHETORE, PIKË E DOBËT E MIRËQEVERISJES

Buxheti publik kërkohet të jetë transparent në mënyrë që publiku i gjerë të njoftohet me shpenzimet buxhetore dhe ku janë investuar mjetet buxhetore. Sipas ekspertëve të çështjeve ekonomike, transparencë buxhetore në Kosovë konsiderohet se nuk është në nivel të kënaqshëm dhe se është pikë e dobët e mirëqeverisjes, ndërsa në të ardhmen të ketë më tepër transparencë buxhetore. Drejtori i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balijs, për gazetën “Lajm” ka thënë se njëri ndër instrumentet më të rëndësishëm të një shteti është buxheti publik, mirëpo ai duhet të jetë edhe transparent në mënyrë që publiku i gjerë të njoftohet me shpenzimet buxhetore. Sipas tij, natyrisht që nevojitet edhe transparencë buxhetore. Ai ka shpjeguar se konsiderohet që transparencë buxhetore në Kosovë nuk është në nivel të kënaqshëm. “Mendoj se një nga instrumentet më të rëndësishme ekonomike për shtetndërtim dhe zhvillim ekonomik është pikërisht buxheti shtetëror. Informatat mbi buxhetin shtetëror në përgjithësi janë në dispozicion të palëve të interesuara, por sipas analizave të disa instituteve të pavaruara për hulumtime ekonomike, konsiderohet që transparencë buxhetore në Kosovë nuk është në nivel të kënaqshëm, sa i përket hartimit, shpenzimit dhe raportimit të buxhetit”, ka thënë Balijs. Ai më tej ka shpjeguar se agjencitë buxhetore nuk duhet të nguten dhe të bëjnë raporte të nxituara buxhetore. “Prandaj, mendoj se ministritë dhe agjencitë shtetërore duhet të mos bëjnë hartime të nxituara buxhetore. Ato duhet të jenë më gjithëpërfshirëse në procesin e hartimit buxhetor dhe njëkohësisht të bëjnë një monitorim më të mirë të shpenzimeve dhe të jenë më të rregull dhe më transparent në raportime, në intervale të caktuara kohore, në mënyrë që publiku të ketë qasje më të mëdha në këto informata dhe të ketë një llogaridhënie më të madhe ndaj qytetarëve të Kosovës”, ka thënë në fund Balijs. (25 qershor 2014 / *Lajm*)

LAJME NGA SEKTORI BANKAR QË SHËNUAN MUAJIN KORRIK 2014

IFC MBËSHKET PROGRAMIN PËR NJOHURI FINANCIARE NË KOSOVË

IFC, anëtare e Grupit të Bankës Botërore, ka nënshkruar një marrëveshje me Shoqatën e Bankave të Kosovës, duke shënuar përkushtimin e përbashkët për të përmirësuar edukimin dhe njohuritë financiare në Kosovë.

Edukimi mbi njohuritë financiare do të ndihmojë në rritjen e shkathtësive dhe njohurive të klientëve dhe klientëve të mundshëm të bankave në Kosovë për bazat e financave. Pasi që sektori financiar në Kosovë është duke u zhvilluar dita ditës me shume, dhe përderisa konsumatorët me mundësi më të ulëta financiare fillojnë të shfrytëzojnë më shumë shërbime financiare, sektori financiar ka përqendruar vëmendjen në mbrojtjen e konsumatorit dhe edukimin financiar për të siguruar që konsumatorët të trajtohen në mënyrë të drejtë. Dihet, që mungesa e të kuptuarit të marrëdhënieve kontraktuese dhe bazave elementare të financave nga ana e qytetarëve e pengon zhvillimin e ndërmarrësisë, ekonomive shtëpiake dhe bizneseve të vogla. Po ashtu ne mbare boten, pranohet me të madhe se të kuptuarit financiar mes klientëve të institucioneve financiare, e sidomos konsumatorëve, ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve të mesme, të vogla dhe mikro, është i ulët.

E themeluar në vitin 2002, Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) është perfaqesuese e industrisë bankare në Kosovë. SHBK përfaqëson të tetë bankat komerciale. Ajo bashkëpunon me Qeverinë, Bankën Qendrore dhe Republikën e Kosovës, mediat dhe publikun me qëllim të mbështetjes së një industrie të shëndoshë bankare e cila kultivon zhvillimin afatgjatë ekonomik të Kosovës. IFC do ta ndihmojë SHBK-në të jetësojë programin për njohuri financiare me qëllim të përmirësimit të nivelit aktual të njohurive financiare të popullatës, me përqendrim të veçantë në klientët ekzistues dhe të mundshëm bankarë në Kosovë. Ky program ofron një pako të madhe të instrumenteve, identifikon kanalet me të mira të shërbimeve dhe siguron rrjedhshmerine e porosive kyçe të programit në nivel mbarëkombëtar. Petrit Balija, drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës theksoi që: “Bankat komerciale janë të interesuara të marrin pjesë në projekte që e përmirësojnë kushtet socio-ekonomike të qytetarëve të Kosovës. Ky projekt në mes të SHBKse dhe IFCse është një shembull i këtij përkushtimi që do të ndihmojë në edukimin dhe rritjen e njohurive mbi sektorin bankar në vendin tonë”. Në fazën fillestare të programit, do të kryhet një studim i gjerë i njohurive financiare me qëllim të vlerësimit të nivelit aktual të njohurive financiare të popullatës. Në bazë të rezultateve të studimit do të organizohen trajnime dhe këshillime me qëllim të rritjes së njohurive financiare të klientëve ekzistues dhe të mundshëm bankarë. Veç kësaj, dizajni dhe përgatitja e materialeve të marketingut për një varg të gjerë të popullatës përmes kanaleve të ndryshme të shpërndarjes, si transmetime në televizion (TV) dhe radio; materiale të shtypura dhe shfrytëzimi i teknologjive të reja (SMS dhe/ose porosi nga qendra e thirrjeve). (2 korrik 2014, Agjencia e Lajmeve Ekonomia, Kosovalive 360)

“BLINDOHEN” BANKAT

Pas një numri të madh të plaçkitjeve që kanë ndodhur sivjet në tërë Kosovën, por edhe vitin e kaluar, zyrtarët e bankave komerciale I kanë hapur sytë, për të marrë masat e reja të sigurisë nëpër të gjitha objektet që ata I kanë. Zyrtarja për informim e “ProCredit Bank”, Fitore Sinani, tha për gazetën se kohët e fundit vihet re një rritje e numrit të plaçkitjeve të institucioneve dhe kompanive të ndryshme në Kosovë. “Ne si bankë jemi të shqetësuar me një gjë të tillë dhe konsiderojmë që këto plaçkitje janë të lidhura me faktorë eksternë, që kërkojnë masa të rrepta dhe një qasje sistematike e të koordinuar të të gjitha institucioneve në vend”, tha ajo.

Ndërsa zyrtarja për media dhe marrëdhënie me publikun e “Raiffeisen Bank”, Iliriana Tahiraj, tha për gazetën se kjo bankë në Kosovë i zbaton masat e sigurisë në pajtim me politikën dhe procedurat e brendshme si dhe në pajtim me ligjet e aplikueshme në Kosovë. Tahiri tha se “Raiffeisen Bank” ka një bashkëpunim mjaft të mirë me Policinë dhe me institucionet e tjera të sigurisë në Kosovë, në mënyrë që bashkërisht të arrihet deri te rezultatet e dëshiruara në fushën e sigurisë.

Si shifra të përgjithshme policia thotë se në vitin 2013 janë raportuar gjithsejt 493 raste të grabitjeve, ndërsa gjatë vitit 2014 l kemi pasur të raportuara gjithsejt 123 raste. (8 korrik Kosova Sot)

KAMATAT E KREDIVE MBESIN DYSHIFRORE

Kosova vazhdon të jetë vendi me kamatat më të larta të kredive në Evropë, e po kështu edhe nëse krahasohemi me rajonin tonë. Sipas ekspertëve të ekonomisë, ulja e këtyre kamatave të larta është një nevojë e domosdoshme për të nxitur zhvillimin ekonomik në vendin tonë.

Petrit Balijs, drejtor ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, tha se ka pasur trend të rënies së normës së interesit për kredi për 4 pikë të përqindjes nëse e krahasojmë prillin 2014 me vitin 2010. Ai beson se deri në vitin e ardhshëm norma mesatare e interesit për kredi do të jetë njëshifrore.

Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, tha se vendi ynë prin me normat më të larta të kredive. "Fatkeqësisht, te ne operojnë vetëm bankat komerciale, ku në ekonominë e tregut kërkesat dhe ofertat e caktojnë çmimin. (14 korrik, Kosova Sot)

BANKAT, DERI 30 EURO PËR NJË VËRTETIM

Bankat komerciale në Kosovë kohëve të fundit l kan shtrenjtuar tej mase shërbimet e tyre administrative. Vetëm për një vërtetim që u lëshohet klientëve të tyre, që nuk kanë më asnjë lloj obligimi financiar ndaj asaj banke, në varësi të bankës paguhet 15, 25 e deri në 30 euro.

Besnik Kada, zëdhënës në BQK, tha se cmimet dhe tarifat për produktet dhe shërbimet e ofruara caktohen nga ana e bankave, varësisht nga vlerësimi l koston e tyre dhe bankat janë të obliguara që t'l shpalosin këto tarifa, saktë dhe qartë për të gjithë klientët e tyre, në mënyrë që t'u mundësojnë atyre krahasimin e kostove për produktet dhe shërbimet e ofruara nga bankat e ndryshme.

Lidhur me këto zhvatje, që bankat komerciale po i bëjnë klientelës së tyre, ekspertët dhe specialistët e bankave kanë mendimet e ndara. Petrit Balijs, Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, tha se bankat komerciale në Kosovë bëjnë përlllogaritjen e koston për ofrimin e një shërbimi, varësisht edhe nga natyra e shërbimeve. "Nëse një shërbim nuk është pjesë e produkteve-shërbimeve të rregullta të bankës dhe nevojitet më shumë punë manual, atëherë edhe kostoja është më e lartë për atë shërbim. Megjithatë, konsumatorët duhet të krahasojnë bankat në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe jo të përqendrohen vetëm në një aspekt dhe kështu të vlerësojnë se cila bankë ofron cmimet më të lira dhe shërbimet më të mira, në mënyrë që të zgjedhin alternativën më të mire, pasi kjo është qështje e konkurrencës së lire në mes të bankave. Por në të njëjtën kohë duhet sqaruar se ka edhe banka të tilla komerciale, që klientëve të tyre për këto lloje të shërbimeve nuk u marrin asnjë euro" tha Balijs. (23 korrik, Kosova Sot)

HIPOTEKAT NUK SHITEN

Të gjithë qytetarët të cilët kanë kredi në bankat komerciale, si garancion duhet të lënë patundshmëri si hipotekë, vlera e së cilës duhet të lënë dy herë më e lartë se ajo e kredisë së huazuar.

Për këtë, klientët peng në banka të ndryshme komerciale kanë lënë dyqanet, shtëpitë, veturat, tokat, e deri te pajisjet elektronike dhe teknologjike.

E në rast se klientët kanë probleme në shlyerjen e kredive, hipotekën bankat kanë të drejtë të nxjerrin në shitje përmes ankandit publik, që në shumicën e rasteve vlera e hipotekës zhvlerësohet në masë të madhe.

Ekspertë për çështje financiare në Kosovë konsiderojnë se nga funksionimi i sistemit bankar dhe fillimi i dhënies se kredisë, bankat kanë kërkuar vlerë të lartë të hipotekës dhe kanë zhvlerësuar atë. Flamur Keqa, konsideron se gjatë vlerësimit të kredisë, analistët e bankave më tepër duhet të fokusohen te mundësia e prejardhjes se mjeteve dhe jo te hipoteka.

Pavarësisht, faktit se jo rrallë herë në mediat e shkruara vërejmë shpallje nga bankat komerciale për shitje të hipotekave, interesimi palëvet të tretapërtëblerë pronatë cilat janë objekt i shitjeve gjyqësore është shumë i vogël. (24 korrik, Radio Evropa e Lirë, Tribuna, Telegrafi)

BANKA TEB LËSHON AGROKARTELËN E 1000-TË

Me rastin e dhënies së Agrokartelës së 1000-të, banka TEB në bashkëpunim me USAID-in, të mërkurën organizoi një konferencë për media në objektet e kompanisë "Haxhijaha" në Rahovec.

Kryeshefi ekzekutiv i bankës TEB, Ayhan Albeyoglu theksoi se Agrokartela që në ditën e parë të lansimit në treg dha shenja të papara të suksesit. Ndërsa Drejtori i Zyrës për Zhvillim Ekonomik në USAID, Scott Cameron, u shpreh se është kënaqësi të shohësh se me çfarë shpejtësie iu adaptuan këtij koncepti bizneset dhe fermerët dhe se si bankat po ju përgjigjen kërkesave të tyre në vazhdimësi. (25 korrik, Telegrafi, Zëri)

EUROMONEY: RAIFFEISEN, BANKA ME E MIRE

Revista britanike financiare Euromoney ka dhënë çmimin si "Banka më e mirë në Evropën Qendrore dhe Lindore" Raiffeisen Bank International AG (RBI) tashmë për herën e tetë. Çmimi është dhënë në Londër në një ceremoni rasti të enjten e kaluar. Në të njëjtën kohë, janë ndarë çmime edhe për bankat më të mira që veprojnë në tregje të caktuara, në mesin e të cilave ishin edhe katër banka të rrjetit të Raiffeisen Bank International.

Banka Raiffeisen në Kosovë ka marrë çmimin si "Banka më e mirë në Kosovë" ndërsa çmimin e njëjtë në shtetet ku veprojnë e kanë marrë edhe degët e Raiffeisen Bank International në Bosnjë dhe Hercegovinë, Rumani dhe Serbi. "Ne vazhdimisht kemi investuar në zhvillimin e mëtutjeshëm të produkteve dhe shërbimeve tona bankare në Kosovë. Në vitin 2013, kemi rritur edhe portfolion e kredive edhe depozitat. Përdorimi i shërbimeve elektronike ishte një ndër prioritetet tona dhe gjatë vitit 2013, shfrytëzimi i këtyre shërbimeve nga klientët është rritur për 50%. Ky çmim vlerëson rezultatet tona të shkëlqyeshme dhe konfirmon përkushtimin tonë për t'i përmbushur kërkesat dhe nevojat e klientëve tanë", tha Robert Ēright, drejtor ekzekutiv i Bankës Raiffeisen në Kosovë. (15 korrik, Telegrafi, Zëri, Kosova Sot)

INAUGUROHET PARKU NË LAGJEN "DARDANIA" Z

ProCredit Bank si një bankë që investon çdo ditë në kujdesin për ambientin ka inauguruar sot parkun në lagjen Dardania të Prishtinës. Më shumë se 9500 m² sipërfaqe publike është gjelbëruar dhe pajisur me ulëse dhe shporta – duke e shndërruar këtë hapësirë në park të rehatshëm për qëndrim dhe shfrytëzim për banorët të cilët banojnë përreth. Ky investim i ProCredit Bank është mundësuar në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës.

Shpend Ahmeti Kryetari i Komunës së Prishtinës tha se 'ky projekt ka filluar si ide vitin e kaluar, që njeri prej parqeve të Dardanisë të rregullohet, të mbillet me drunjë të rinj të vendosen bankat në mënyrë që të shfrytëzohet nga qytetarët. Për më tepër ideja është që një korporatë si ProCredit Bank që funksionon jo vetëm në komunën tonë po edhe në shtetin tonë të shfrytëzojë një pjesë të qarkullimit të vet për të investuar në diçka që ka përfitim social për të gjithë qytetarët.

Investimi në këtë park reflekton nevojën e më shumë hapësirave të gjelbra publike në Kosovë, si dhe kontributin e vazhdueshëm në mjedis të një institucioni të përgjegjshëm financiar.

"Me këtë investim ne si bankë synojmë të kontribuojmë në rritjen e hapësirave të gjelbëruara që janë shumë të domosdoshme në zonat urbane. Ky investim mbyll një projekt për rritjen e hapësirave të gjelbra në shumë qytete në nivel të vendit, që paraqet një investim total prej afro 60,000 euro, rreth 415 drunjë të mbjellur dhe mbi 10,500m² sipërfaqe e gjelbëruar" deklaroi Ilir Aliu drejtor gjeneral në ProCredit Bank. (18 korrik, Telegrafi, Zëri)

LAJME NGA SEKTORI BANKAR QË SHËNUAN MUAJIN GUSHT 2014

NGA 1 SHKURTI BANKAT E KOSOVËS ME IBAN

Nga 1 shkurti i vitit të ardhshëm, llogaritë bankare në Kosovës do të kenë edhe formatin IBAN apo numrin ndërkombëtar të xhirollogarive bankare.

Ky format do të ndikojë në zvogëlimin e rrezikut të gabimeve në transkriptimin e numrave të llogarive bankare, si dhe do të lehtësojë pagesat ndërkombëtare hyrëse në Kosovë.

Më 1 shkurt të vitit të ardhshëm, llogaritë bankare në bankat e Kosovës do të kenë edhe formatin IBAN apo numrin ndërkombëtar të xhirollogarive bankare.

Në një njoftim për media të Bankës Qendrore të Kosovës, thuhet se qëllimi parësor i përdorimit të formatit IBAN është zvogëlimi i rrezikut të gabimeve në transkriptimin e numrave të llogarive bankare, si dhe do të lehtësojë pagesat ndërkombëtare hyrëse në Kosovë, duke i mundësuar bankës së jashtme identifikim më të qartë të llogarisë bankare të përfutuesit në Kosovë dhe kontroll plotësues të saktësisë së kësaj llogarie.

Ndonëse nuk kanë të dhëna me shifra se sa gabime janë bërë gjatë transaksioneve deri tani, zyrtarë të Shoqatës së Bankave thonë se ka pasur gabime nga klientët dhe bankat dhe secili e ka marrë përgjegjësinë e vet, por sipas tyre, ky format do të eliminojë gabimet e mundshme dhe do ta rrisë sigurinë e transfereve.

“IBAN së pari e identifikon shtetin ku po shkon transferi, pastaj e identifikon institucionin bankar ku po shkon transferi, dhe së fundmi individin ku po i transferohet. Transferet bankare, kanë qenë të sigurt edhe deri më tani, por mundësia për gabime ka qenë shumë më e madhe dhe është dashur të aplikohet një kujdes shumë më i veçantë, dhe nëse ka ndodh ndonjë gabim, shpesh herë ka qenë i papërmirësueshëm në transferet ndërkombëtare. Nuk mund të themi që s’kemi pasur sistem të sigurt, por kjo vetëm sa e shton sigurinë, dhe eliminon gabimet njerëzore që mund të ndodhin gjatë transferimit të pagesave”, ka theksuar Petrit Balija nga Shoqata e Bankave për RTK.

Esipas Ibrahim Rexhepit, ky format do të jetë hap drejt integritetit të sistemit bankar të vendit në atë ndërkombëtar. “Pas pranimit të SWIFT Kodit ka qenë e kuptueshme që hapi tjetër do të jetë edhe IBAN-i, ose krijimi i kontove kushtimisht po them ndërkombëtare për secilin posedues të llogarive apo kontove në bankat komerciale të Kosovës. Kështu që kjo vetëm e lehtëson punën dhe njëkohësisht është edhe një hap më tutje drejt integritetit të sistemit bankar të Kosovës në sistemin evropian, apo në sistemin e përgjithshëm ndërkombëtar”, ka theksuar Ibrahim Rexhepi, njohës i çështjeve ekonomike.

Udhëheqës të Shoqatës së Bankave vlerësojnë se ky format do të iu ndihmojë strukturave të sigurisë së shtetit, pasi do të kenë mundësi mbikëqyrjeje edhe më konkrete të çdo transferimi që hyn dhe del nga vendi. Sipas tyre, klienti nuk do të paguajë për këtë format nëse banka e aplikon këtë kod. (RTKlive, 8 gusht 2014)

180 MIL. EURO KREDI FAMILJARE, PËR GJASHTË MUAJ

Kriza ekonomike në vend është duke shënuar rritje të madhe. Ekonomitë familjare po ballafaqohen me mungesë të madhe të parasë së gatshme, ato janë të detyruara që të marrin kredi për të mbuluar shpenzimet esenciale.

Të dhënat zyrtare tregojnë për rritje të vazhdueshme të kërkesave për kredi, ndërkohë që kreditë familjare janë në rritje dukshëm më të madhe sesa vitin e kaluar. Mbi 144 milionë euro është rritur shuma e kredive të lëshuara sivjet në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Sipas të dhënave të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) për gjashtë muajt e pare të këtij viti, janë lëshuar rreth 512.20 milionë kredi të reja, kurse në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë lëshuar 367.4 milionë euro. Kurse rritje të madhe kanë shënuar edhe kredit familjare. Vetëm, gjatë periudhës janar-qershor 2014 janë afërsisht 28.3 milionë euro më shumë kredi të reja të lëshuara sesa periudha e njëjtë për vitin 2013 një rritje kjo për 18.7 për qind.

Petrit Balija, drejtor i SHBK-së, ka bërë të ditur se nëse krahasojmë kreditë e reja të lëshuara për dy periudhat, atëherë mund të shohim se për ekonomitë familjare gjatë periudhës janar-qershor 2014 janë afërsisht për 28.3 milionë euro më shumë kredi të reja të lëshuara sesa periudha e njëjtë për vitin 2013. Nga ana tjetër, njohësit e rrethanave ekonomike në vend, kanë vlerësuar se pasi që pagat në vend janë shumë të vogla, atëherë ekonomitë familjare detyrohen të marrin kredit për konsum. (Zëri, 26 gusht 2014)

“TRETEN” MILIONAT E BERZH-IT

Ndonëse ka më shumë se dy vjet që kur vendi ynë është bërë anëtar i Bankes Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), bazuar në pohimet e përfaqësuesve të bizneseve dhe ekspertëve të fushës së bankave dhe financave, Republika e Kosovës nuk ia ka parë shumë hajrin kësaj banke ndërkombëtare sa u përket investimeve që janë pritur.

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, tha se Kosova është bërë anëtare e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në fund të vitit 2012. “Anëtarësimi në këtë bankë zhvillimore multilaterale është mjaft i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës, pasi që mundëson që BERZH-I të injektojë fonde në ekonomine e Kosovës përmes investimit të drejtëpërdrejtë në bizneset e Kosovës, por edhe në kreditim përmes bankave komerciale të Kosovës” tha ai. Sipas tij, një shembull i suksesshëm i kreditimit nga BERZH-i është marrëveshja e arritur me bankën TEB në vitin 2013. “Kjo marrëveshje është bërë për një kredi përmes së cilës BERZH-I ka siguruar një shumë prej 5 milionë eurosh për TEB, për huadhënie të bizneset dhe individët për investime në projekte të energjisë eficiente”, tha ai.

Kryetari i Shoqatës tha se TEB-i ka arritur që të plasojë këtë kredi në tregun e Kosovës pothuajse në tërësi brenda 1 viti. “Nga kjo kredi kanë përfituar si ekonomitë familjare ashtu bizneset, duke financuar projekte për energji efikase dhe energji të ripërtrithme”, tha ai. Balijaj përmendi edhe rastin e blerjes së 10 për qind të aksioneve të Bankës për Biznes në vitin 2011. “Ky investim ka qenë i dobishëm për BpB-në, sistemin bankar të Kosovës në tërësi, por edhe për ekonominë e vendit, pasi që tregon një besueshmëri të lartë të BERZH-it në bankat e Kosovës e që është një sinjal shumë pozitiv për investitorët e huaj”, tha ai. (Kosova Sot, 26 gusht 2014)

REMITENCAT NË KOSOVË MË TË LARTA SE NË SHQIPËRI

Gjatë vitit 2013, shtetasit kosovar emigrantë, kanë dërguar drejt vendit të tyre 621 milionë euro, ndërsa shtetasit shqiptar vetëm 497 milionë euro.

Ndërkaq shteti nga i cili emigrantët, kanë dërguar më shumë para drejt Kosovës gjatë këtyre viteve është Gjermania. Në vitet 2008-2013 nga ky shtet janë dërguar mesatarisht 210 milionë euro nga emigrantët kosovarë.

Kjo shifër vjen dhe si rezultat i numrit të lartë të emigrantëve kosovarë në Gjermani. Vend të dytë zë diaspora kosovare në Zvicër, me 147.4 milion euro. (Telegrafi, Tribuna, Kosova Sot, 1 gusht 2014)

NUK NDALET KËMBIMI NË RRUGË

Fare pranë këmbimoreve ka mjaft këmbyes valutash që i ofrojnë shërbimet e tyre në rrugë. Petrit Balija, drejtor i Shoqatës së Bankave të Kosovës, thotë se pikat e këmbimit valutash nuk janë pjesë e industrisë bankare dhe Shoqata e Bankave të Kosovës nuk mund të flasë në emrin e tyre.

“Megjithatë, mund të ju them se bankat komerciale në Kosovë mundësojnë këmbimin e valutave kryesore ndërkombëtare përfshirë këtu euro, dollar amerikan, frangun zviceran, dhe funtën britanike. Këmbimi i këtyre valutave bëhet mbi bazat e kërkesës dhe ofertës dhe është shërbim i mbikëqyrur mirë në industrinë bankare.

Megjithatë, është e rëndësishme që të ketë bazë rregullative dhe mbikëqyrje të mirë të këtyre këmbimoreve që ekzistojnë jashtë industrisë bankare në mënyrë që të mos krijohen probleme në sektorin financiar të Kosovës”, tha Balija. Ndërsa zyrtari për media nga Banka Qëndrore e Kosovës, Besnik Kada, thotë se janë gjithsejt 35 zyra për këmbimin e valutave janë të aprovuara nga BQK-ja për të kryer aktivitetet e këmbimit të valutave. (Kosova Sot, 5 gusht 2014)

PRITET FUNKSIONALIZIMI I FONDIT GARANTUES PËR KREDI

Shumë shpejt pritet funksionalizimi Fondit Garantues për Kredi, fond ky i financuar nga Qeveria e Kosovës dhe donatorë ndërkombëtarë, bëjnë të ditur zyrtarë qeveritarë. Ky fond ka për qëllim lehtësimin e qasjes në kredi për bizneset që nuk kanë kolateral të mjaftueshëm për kredimarrje.

Valdrin Lluka, drejtor i përgjithshëm në Agjencinë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), që funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, thotë për Radion Evropa e Lirë se një ndër sfidat kryesore të bizneseve në Kosovë mbetet qasja në financa dhe ky fond do ta lehtësojë barrën e tyre.

Bankat e kanë prapë në pronësi procesin e selektimit të kredi-marrësve. Por, në shumicën e rasteve, bizneset e vogla dhe të mesme nuk po kanë peng të mjaftueshëm që t’i japin bankës, për ta marrë një kredi të asaj shume. Dhe, si rezultat, ne hyjmë për t’i ndihmuar ato kompani që nuk kanë peng të mjaftueshëm. Fondi do të mbulojë nga 50 deri në 75 për qind të pengut”, shpjegon Lluka. (Radio Evropa e Lire, Telegrafi, 15 gusht 2014)

RUSËT HYJNË NË BQK

Gazeta Zëri ka siguruar dokumente të cilat tregojnë se kompania ruse “CMA Small System” me lidhjen e saj të fortë, zyrtaren e lartë të BQK-së, është duke u favorizuar në tenderin për marrjen në dorë të sistemit RTGS, që ka të bëjë me të dhëna sekrete, ku jo çdo kush mund të ketë qasje.

Çdo transfer, depozitë, dhe e dhënë financiare e Bankës Qëndrore të Kosovës (BQK) ka mundësi që të bie në duart e kompanisë ruse “CMA Small System”. (Zëri, 20 gusht 2014)

SQARIM NGA BQK PËR ARTIKULLIN ME TITULL “RUSËT HYJNË NË BQK”

Në numrin e djeshëm të gazetës së përditshme “Zëri”, në ballinen e saj, është publikuar një artikull lidhur me procesin e përzgjedhjes së kompanisë, e cila do të angazhohet për zhvillimin dhe mbështetjen e sistemit automatik të transfereve.

Ndonëse artikulli në përgjithësi bën fjalë për këtë proces tenderues, konsiderojmë se titulli i artikullit dhe paragrafët brenda tekstit që u referohen relacioneve personale, të cilat do të mund të kishin ndikim në procesin e përzgjedhjes, duket të jenë paragjykes dhe mund të shkaktojnë hutë në opinion.

Qëllimi i këtij sqarimi nuk është që të polemizojmë me artikullin në fjalë, por t’i ofrojmë faktet përkatëse dhe të garantojmë transparencën në procesin e vlerësimit të këtij tenderi. Sic ka theksuar zëvendësguvernatori Fatmir Gashi, në prononcimin e tij në artikullin në fjalë, ritheksojmë edhe njëherë se tenderi publik ka qenë i hapur për të gjitha kompanitë e interesuara, qoftë vendore, qoftë ndërkombëtare.

Fakti që kompania “CMA” ka fituar më parë tender në BQK, nuk do të thotë aspak se kjo kompani është duke u favorizuar në tenderin aktual. Përkundrazi, procesi i vlerësimit është duke ecur përpara dhe aktualisht për asnjërin nga kompanitë nuk mund të thuhet se është favorite për ta fituar tenderin. (Zëri, 22 gusht 2014)

LAJME NGA SEKTORI BANKAR QË SHËNUAN MUAJIN SHTATOR 2014

PROPOZOHET THEMELIMI I NJË BURSE RAJONALE

Kosova vazhdon të jetë vendi i vetëm në Evropë dhe në rajon që nuk ka treg të bursës. Eksperti i kësaj fushe, Petrit Balijs, kryetar i Shoqatës së Bankave të Kosovës, tha se Kosova i ka hapur rrugë zhvillimit të tregjeve financiare në fillim të vitit 2012, kur për here të pare janë emetuar letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe që nga atëherë është bërë shumë progres në këtë drejtim.

“Në këtë drejtim, shpeshherë është diskutuar mundësia për një burse të përbashkët për tërë rajonin, por që ende nuk është bërë diçka konkrete”, tha Balijs. Sipas Balisë, krijimi i një burse të suksesshme do të mundësonte tri funksione kryesore për qytetarët dhe bizneset e Kosovës: rritja e kapitalit për kompanitë dhe organizatat e tjera që kanë nevojë për mjete financiare, mundësi të mire investimit për ata që disponojnë me likuiditetin të lira ku mund të zgjedhin prej një game të gjerë të alternativave investive dhe mundësinë e likuiditetit të investimeve, pasi që titujt mund të shiten dhe të blihen lirisht në çdo kohë.

“Prandaj, konsideroj se themelimi i një burse rajonale, ku oferta dhe kërkesa është e bujshme do të ofronte një mundësi shumë të mire për zhvillim ekonomik të vendit”, tha ai. *(Kosova Sot, 2 shtator 2014)*

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS (SHBK) NËNSHKRUAN MEMORANDUM MIRËKUPTIMI ME FEDERATËN EVROPIANE TË BANKAVE (EBF)

Më 1 shtator 2014 është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit në mes të Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe Federatës Evropiane të Bankave. Në njërën anë, Shoqata e Bankave të Kosovës si përfaqësuese e sektorit bankar në Kosovë, duke përfaqësuar tetë banka, dhe në anën tjetër Federata Evropiane e Bankave që është zëri i përbashkët i bankave të themeluara në Evropë, kanë arritë këtë marrëveshje mirëkuptimi me qëllimin që të zhvillohet, fuqizohet, dhe intensifikohet bashkëpunimi në mes të palëve për të arritë objektivat dhe qëllimet e përbashkëta.

Objektivat e këtij memorandumi do të arrihen duke shkëmbyer informacionet për zhvillimet rregullatore, shkëmbimin e ideve dhe pikëpamjeve në një bashkëpunim të ngushtë në nivel botëror dhe me organizata botërore.

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balijs tha që ky memorandum bashkëpunimi i hap rrugë antarësimeve të mëtutjeshme në instanca ndërkombëtare për një integrim më të shpejtë në sistemin financiar të Kosovës dhe të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian. Fusha e bashkëpunimit përfshin shkëmbimin e informacioneve, publikimeve dhe resurseve, promovimin e praktikave më të mira bankare, arranzhimin, promovimin dhe mbështetjen e ngjarjeve dhe takimeve në mes të palëve. *(Shoqata e Bankave të Kosovës, 16 shtator 2014)*

PËRMBYLLET PANAIRI FINANCIAR 2014

Sot përfundoj Panairi Financiar 2014 i organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK). Në këtë Panair u prezentuan kompani/institucione të ndryshme si institucionet bankare, institucionet financiare jo-bankare, institucionet mikrofinanciare, kompanitë e sigurimeve, kompanitë e auditimit dhe kontabilitetit, institucionet edukativo-arsimore, agjenci dhe programe të ndryshme. Krahas ekspozimit të kompanive të ndryshme, në këtë Panair Financiar u organizuan edhe dy konferenca dhe një forum.

Konferenca e parë me titull “Zbatimi i kontratave dhe qasja në financa” u mbajt në ditën e parë të Panairit, kurse në po të njëjtën ditë u mbajt edhe konferenca e dytë me titull “Si të bashkëpunojmë me bankat për një normë më të mirë të interesit?”. Ndërsa forumi me temën “Risku në mjedisin financiar” u mbajt në ditën e dytë të Panairit Financiar 2014.

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës Z. Petrit Balijs theksoi se ky panair konsiderohet ndër më të mirët deri më tani pasi që interesimi i vizitorëve ka qenë më i madh dhe gjatë panairit janë trajtuar temat më prioritare për ekonominë e vendit dhe sektorin financiar në veçanti.

Konkluzionet e këtyre konferencave të mbajtura në kuadër të Panairit Financiar 2014 do të publikohen në Vështrimin Periodik mbi Sektorin Financiar të Kosovës të publikuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës në muajin Tetor, publikim i cili mund të shkarkohet në ëeb faqen e SHBK-së. *(Bota Sot, infodirekt, kosovalive 360, 25 shtator 2014)*

RIKUPEROHET AKTIVITETI KREDITOR

Tregu bankar i Kosovës, vazhdon të jetë atraktiv për investitorët dhe se vazhdon të reflektojë nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjitha aspektet, përfshirë nivelin e lartë të kapitalizimit, pozitën e fuqishme të likuiditetit si dhe cilësinë e mirë të portofolit kreditor. Kështu pohoi guvernatori i Bankës Qëndrore të Kosovës (BQK), Bedri Hamza në hapjen e Panairit Financiar 2014, organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës. *(Kosova Sot, 25 shtator 2014)*

DEPOZITAT U SHTUAN 25.9 MILIONË EURO

Bazuar në të dhënat zyrtare të BQK-së, Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe përfaqësuesve të njëres prej bankave komerciale, me gjithë rënien e kamatave të kursimit, nuk ka pasur rënie të depozitave të qytetarëve. Besnik Kada, zyrtar për marrëdhënie me medie dhe komunikim në BQK, tha se depozitat në sektorin bankar në qershor 2014 arritën vlerën 2.42 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 10.0 për qind, e cila paraqet normën më të lartë të rritjes në dy vitet e fundit. Ndërsa, Petrit Balijs, kryetar i Shoqatës së Bankave të Kosovës, thotë se në bazë të raporteve të gjashtëmujorit të parë të vitit 2014 nga sektori bankar, depozitat kanë shënuar ngritje prej 25.9 milionë euro, duke arritur vlerën në 2 miliardë e 474.9 milionë euro prej 2 miliardë e 449 milionë euro sa ishin në fund të vitit 2013. “Sipas disa studimeve të kryera nga disa banka komerciale në Kosovë, norma e interesit nuk është një prej kritereve kryesore të përzgjedhjes së bankës nga klientët në Kosovë”, tha Balijs. Ai shtoi, se hulumtimet tregojnë se klientët u japin prioritet aspekteve të tjera, siç janë: besueshmëria, sjellja ndaj konsumatorit, gama e produkteve, rrjeti i filialave dhe bankomateve, shërbimet online etj”. *(Kosova Sot, 4 shtator 2014)*

LAJME NGA SEKTORI BANKAR QË SHËNUAN MUAJIN TETOR 2014

LICENCOHEN VLERËSUESIT E PRONAVE TË PALUAJTSHME

Në një ceremoni të organizuar në Odën Ekonomike të Kosovës (OEK), janë dorëzuar licencat e para për vlerësuesit e pronave të paluajtshme. Licencat profesionale individuale janë lëshuar nga Bordi për Licencimin e Vlerësuesve për Pronat e Paluajtshme, pasi janë mbajtur rreth 120 orë trajnim.



Trajnimet janë kryer në Odën Ekonomike të Kosovës, nga trajnerë nga Shqipëria. Kryetari i Shoqatës së Bankave në Kosovë, Petrit Balija, ka thënë se kjo gjeneratë e hershme e të licencuarve do ta ketë barrën më të madhe për vendosjen e praktikave të shëndosha për vlerësimin e patundshmërive. Sipas tij, tregu i patundshmërive është bazamenti kryesor për zhvillimin e sektorit bankar. (*Ekonomia Online*, 22 tetor 2014).

PËRMIRËSOHET KLIMA E TË BËRIT BIZNES

Në raportin e Bankës Botërore “Të bërit biznes” për vitin 2015, Kosova ka shënuar përparim në rangimin e përgjithshëm në këtë raport, kanë vlerësuar zyrtarët e Agjencisë për regjistrimin e bizneseve, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë të Qeverisë së Kosovës.

Ata janë përqëndruar në dy nga 10 indikatorët e vlerësuar në raportin “Të bërit biznes”, të cilët janë drejtpërdrejt të ndërlidhur me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe me Agjencionin për regjistrimin e bizneseve.

Raporti i Bankës Botërore “Të bërit biznes” për vitin 2015 e ka ranguar Kosovën në pozitën 75. (*Zëri*, 30 tetor 2014).

SHËNOHET DITA BOTËRORE E KURSIMEVE



Sot është shënuar përvjetori i Ditës Botërore të Kursimeve edhe në Kosovë në një kohë kur depozitat bankare në bankat komerciale të Kosovës kanë arritur shumën më të lartë ndonjëherë në vlerë rreth 2.5 miliard Euro.

Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave z. Petrit Balija, u prononcua në një intervistë për Radiotelevizionin e Kosovës duke thënë se kjo ditë shënohet me qëllim të sensibilizimit të qytetarëve për rëndësinë e hapjes së llogarisë bankare dhe krijimi i shprehive të kursimeve.

Mesazhi i z. Balija ishte që qytetarët e Kosovës të mos mbajnë para të gatshme në shtëpitë e tyre pasi që kjo mënyrë e ruajtjes së mjeteve financiare nuk është fare e sigurtë. Ai potencoi se sistemi bankarë në Kosovës është i kapitalizuar mirë dhe likuid dhe ofron mundësinë më të sigurtë për kursimet e qytetarëve. z. Balija gjithashtu ka cekur Fondin e Sigurimit të Depozitave i cili tanimë siguron një pjesë të kursimeve dhe se ky fond është në rritje e sipër. (Radio Televizioni i Kosovës, 31 tetor 2014)

KRIZA POLITIKE RREZIKON SEKTORIN BANKAR

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, ka thënë se ngërçi politik është duke ndikuar drejtpërdrejt në mënyrë negative në sektorin bankar, sikurse në çdo sektor tjetër. Nëse nuk do të ketë zgjedhje të krizës politike deri në fund të vitit, atëherë mund të rrezikohen objektivat e parapara për uljen e normave të interesit për kredi. “Nëse situata e këtillë vazhdon deri në fund të vitit, kjo do të rezultojë me ndikime të drejtpërdrejta negative në zhvillimin e sektorit bankar dhe shumë sektorë të tjerë dhe do të ketë një kosto reale që nuk do të mund të rikuperohet”, është shprehur Balija. Ai ka thënë se sikurse në sektorët e tjerë, edhe në sektorin bankar ngërçi politik ka ndikuar në mënyrë negative. “Si sektorët e tjerë, edhe sektori bankar është ndikuar negativisht nga gjendja e krijuar politike, pasi ka ngecje në masat e nevojshme për ta përmirësuar mjedisin e të bërit biznes në Kosovë”, ka thënë Balija. Sipas tij, ka shumë reforma të cilat duhet të ndërmerren nga ministritë dhe agjencitë e ndryshme, por ka edhe të tilla që kërkojnë miratimin në Kuvendin e Kosovës. “Ka raste kur këshillave dhe bordeve të caktuara u ka skaduar mandati dhe ne nuk mund t’i adresojmë kërkesat tona në këto instanca deri në formimin e institucioneve e që, në disa raste, mund të bartin konsekuenca të mëdha”, ka deklaruar Balija për gazetën “Epoka e Re”. Ai ka shtuar se të gjitha këto vonesa janë shumë negative, kur kemi parasysh dinamiken e zhvillimeve në sektorin bankar. I pyetur nëse do të ketë ulje të normave të interesit për kredi në vitin e ardhshëm, Balija është përgjigjur: “Unë kam thënë se



nëse vazhdon trendi i viteve të fundit i rënies së normave të interesit, ne sigurisht se në vitin e ardhshëm do të jemi në norma njëshifrore të interesit për kredi, por shpresoj se reformat e nevojshme të vazhdojnë të ndoshin në mënyrë që kjo të realizohet deri në vitin e ardhshëm. Por, nëse kemi ngecje të reformave dhe zhvillimit ekonomik siç po shkakton kriza politike në vend, atëherë mund të rrezikohen këto objektiva dhe mund të mos i shohim rezultatet e dëshiruara”. (Epoka e Re, 29 tetor 2014).

KRIZA NË DREJTËSI PËRKEQËSON BIZNESIN



Korrupsioni, mosfunksionimi si duhet i Gjyqësorit, mungesa e profesionalizmit tek gjyqtarët është një nga problemet kryesore, me të cilat po përballen bizneset që veprojnë në Kosovë. Numri i madh i lëndëve po po afekton edhe në veprimtarinë e bankave në Kosovë. Preveza Muharremi, udhëheqëse e Departamentit kundër shpëlarjes së parave dhe përputhshmërisë ligjore në ProCredit Bank, tregoi për problemet që po ua sjellin lëndët e pazgjidhura. Ajo ka treguar se janë mbi 2500 lëndë përmbartimore në bankën që ajo përfaqëson. “Në bankën ProCredit Bank vetëm lëndë përmbartimore I kemi mbi 2500, disa nga këto lëndë datojnë qysh nga viti 2009”, u shpreh ajo. (Kosova Sot, 15 tetor 2014).

RAIFFEISEN KALON TESTIN

Grupi Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB) – që paraqet edhe institucionin qendror të grupit bankar Raiffeisen në Austri, duke e përfshirë edhe Grupin Raiffeisen Bank International (RBI), kompanitë e sektorëve



të specializuar dhe UNIQA – e kaloi me sukses stres testin e Bankës Qëndrore Europiane (BQE). RZB i tejkaloi dukshëm koeficientët e mjaftueshmërisë së kapitalit, si në skenarin bazik ashtu edhe në skenarin e pafavorshëm të stres testit. (Zeri, 28 tetor 2014)

BQE: 25 BANKA EUROPIANE “TË SËMURA”

Bankat në Europë kanë një mungesë prej 25 miliardë eurosh, apo 31,7 mln dollarë, të cilat do të ishin të nevojshme për t’i mbijetuar një krize financiare apo ekonomike. Lajmi është bërë i ditur nga vet Banka Qendrore Europiane këtë të diel. Përfundimi ishte rezultat i një auditi njëvjeçar i huadhënësve të eurozonës, dhe përbën një pikë kthese potenciale për ekonominë e goditur të rajonit. (Kosova Sot, Koha Ditore, 27 tetor 2014)

BANKA GJERMANE APLIKON NORMË NEGATIVE TË INTERESIT PËR KLIENTËT

Një bankë e vogël gjermane ka paralajmëruar të mërkurën se do të ofrojë “interes negativ” për depozitat monetare në shuma të mëdha, përkatësisht se do t’iu marrë klientëve 0.25 për qind në depozita të larta mbi 500,000 euro.

Banka Qendrore Evropiane vitin e kaluar ka caktuar shkallë negative për bankat e mëdha për të ashtuquajtura “depozita të natës” (ruajtja e pazareve ditore), por kjo është hera e parë në Gjermani që klientët duhet të paguajnë bankat për ruajtjen e mjeteve të tyre monetare, transmeton lajmi.net.

Skatbank, një bankë e vogël në qytetin Altenburg, në lindje të Gjermanisë, ka njoftuar se normat negative të interesave do të fillojë t’ia aplikojë nga muaji i ardhshëm. Zëdhënësi i kësaj banke deklaroi se Skatbank, e cila ka 15,000 klientë, momentalisht nuk paguan fare interes për depozita mbi 500,000 euro.

Normat e interesave në Gjermani janë shkruirë pasi Banka Qendrore Evropiane u përpoq që me kredi të lira të gjallërojë zonë e përgjumur të eurozonës, por kjo nuk solli ndonjë rezultat për tu lavdëruar. Tregjet financiare po i përshëndesin kreditë e lira, por gjermanët e pasur protestojnë për arsye të mungesës së mënyrave për investim dobiprurës. Portali Verivox ka njoftuar se bankat afariste (komerciale) tash e sa janë kanë filluar të aplikojnë norma negative të interesit. /lajmi.net/ (Zeri, 31 tetor 2014)

DRAGHI: EUROZONA, NË FAZË KRITIKE

Zona euro gjendet në një fazë kritike, ekonomia ka humbur ritmin, investimet janë të dobëta, besimi ka rënë, besueshmëria është në rrezik, inflacioni ndodhet në nivelet më të ulta të regjistruar ndonjëherë dhe mjaft vendime që janë marrë nuk kanë prodhuar rezultatet e parashikuara. Panorama e zymtë e ekonomisë së kontinentit të vjetër është bërë nga vetë kreu i Bankës Qendrore Europiane, Mario Draghi. (Scan TV, 27 tetor 2014)

LAJME NGA SEKTORI BANKAR QË SHËNUAN MUAJIN NËNTOR 2014

SWIFT-KODI PARANDALON PASTRIMIN E PARAVE



Marrja e Swift-kodit bankar në vitin 2013 dhe e ibanit në vitin që vjen do të ndihmojë bankat në luftën kundër pastrimit të parave. Zëdhënësi I BQK-së, Besnik Kada, tha për “Kosova Sot” se swift-kodet e institucioneve financiare të Kosovës me identifikim unik shtetëror janë efektive nga dhjetori 2013. Drejtori i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balijs, ka thënë për gazetën “Kosova Sot” se e drejta për të përdorur kodin shtetëror të swift-it, përveç që I bën transferet më të shpejta dhe me kosto më të ulët, ka implikimet e veta edhe në sigurinë e këtyre transfereve, duke I bërë ato më të sigurta. Sipas tij, formatizimi I xhirollogarive bankare me iban ndikon në reduktimin e gabimeve në transfere dhe ndikon po ashtu në

ngritjen e sigurisë së transfereve. Balijs tha se në të njëjtën kohë këto avancime në transfere ndërkombëtare lehtësojnë edhe punën e agjencive shtetërore që merren me hetimin dhe luftimin e pastrimit të parave, pasi që e bëjnë më lehtë dhe më të saktë përcjelljen e lëvizjeve të parasë nga Kosova për në vendet e tjera dhe anasjelltas. (Kosova Sot, 3 nëntor 2014).

KRIZA POLITIKE REFLEKTOHET NË SISTEMIN BANKAR



Kriza politike në vend ka filluar të reflektohet edhe në sistemin e bankave të vendit, ku këto të fundit kanë filluar t'i frikësohen lëkundjeve të mundshme, për shkak të problemeve në të cilat po kalon vendi. Shoqata e Bankave dhe bankat konfirmojnë se ka pasur raste kur projekte të caktuara janë shtyrë në mungesë të mjeteve.

Petrit Balijs, drejtor ekzekutiv në Shoqatën e Bankave të Kosovës, ka thënë për gazetën “Zëri”, se kriza politike dhe institucionale ka filluar të ndikojë negativisht te bizneset kosovare dhe shenjat e para kanë filluar të shfaqen. Sipas tij, një numër i madh i bizneseve në Kosovë, që janë të varura nga punët, shërbimet dhe furnizimet që i kryejnë

për sektorin publik, po kanë probleme të likuiditetit. “Kjo sigurisht që ndikon negativisht edhe në portfolion kreditor të bankave dhe mund të ndikojë në rënien e kërkesës për kredi, si dhe rritjen e kredive joperformuese”, ka thënë Balijs. Gjithashtu, ai ka thënë se është edhe efekti zinxhiror apo domino, I cili pastaj po shpërndalet në tërë sektorin privat që ka ndikuar. Por, ai thotë se bankat komerciale në Kosovë I kanë marrë parasysht këta faktorë të riskut dhe janë duke qëndruar mirë në të gjithë indikatorët e tyre të nevojshëm për të qenë stabil.

Balijakapërmendurmeradhedhisaproblemetëtjeratëcilatpondikojnënegativishtnëperformancënesistemit bankar. “Kam potencuar vazhdimisht se reforma në gjyqësor dhe në zbatimin e kontrtave është e domosdoshme për të ulur riskun kreditor në Kosovë”, ka thënë ai. Edhe Iliriana Tahiraj, zyrtare për media dhe marrëdhënie me publikun në bankën “Raiffeisen”, ka konfirmuar se edhe në këtë bankë ka reflektuar kriza politike dhe ajo financiare shtetërore. Gjithashtu nga ProCredit thuhet se nëse vazhdohet edhe më tutje me këtë vakuum institucional, atëherë kjo situatë do të rezultojë me ndikime të drejtpërdrejta negative në zhvillimin e sektorit bankar. (Zëri, Telegrafi, 6 nëntor 2014)

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS NËN SHKRUAN MEMORANDUM MIRËKUPTIMI ME SHSK DHE GIZ

Në kuadër të Forumit të Pronës në Kosovë me temë Tregu i Pronës dhe Financimit të Pronës në Kosovë drejt standardeve Europiane - çelës për zhvillim dhe progres të organizuar nga GIZ dhe BQK, Shoqata e Bankave të Kosovës ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës dhe GIZ. Kontrata është nënshkruar nga z. Petrit Balijs (SHBK), z. Adem Selmani (SHSK) dhe z. Guenther Fehlinger (GIZ). Drejtori i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Balijs tha "Një prej investimeve më të rëndësishme për qytetarët e Kosovës është blerja e pronës për banim. Njëkohësisht edhe për industrinë bankare kreditë hipotekare për banim përbëjnë një prej produkteve kryesore për zhvillimin e sektorit.

Në këtë drejtim bankat komerciale të Kosovës përmes Shoqatës së Bankave të Kosovës, kanë bashkëpunuar me BQK dhe këshilltarët e Thesarit Amerikan për të përgatitur Rregulloren për Financimin e Banimit në Kosovë e cila do të rregullojë tregun e financimit të pronave rezidenciale në Kosovë. Kjo rregullore parasheh masa mbrojtëse për klientët e bankave por edhe mundësi zhvillimi për industrinë bankare. Në këtë kontekst një rol të rëndësishëm do të kenë edhe kompanitë e sigurimeve në Kosovë të cilat do të bëjnë sigurimin e këtyre pronave dhe kështu duke ulur riskun edhe për pronarët por edhe për bankat. (Agjencia e Lajmeve Ekonomia, Infodirekt.tv, 7 nëntor 2014)

HAMZA: SEKTORI FINANCIAR I QËNDRUESHËM

Gubernuratori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Bedri Hamza, priti Jorg Asmussen, Sekretar i perhershëm i Shtetit në Ministrinë Federale Gjermane të Punës dhe Ceshtjeve Sociale, të shoqëruar nga Matthias Kiesler, zëvendës i shefit të Misionit të Ambasades së Gjermanisë dhe Shef i Departamentit Ekonomik të ambasades gjermane. Gubernuratori Hamza i informoi mysafirët e tij në lidhje me zhvillimet e fundit në sektorin financiar në Kosovë, duke nenvizuar qëndrueshmërinë dhe performancën pozitive të sektorit bankar në përgjithësi. Hamza theksoi se përpjekjet e BQK-së për të adoptuar standardet me të larta ndërkombëtare në përputhje me Marrëveshjet e Bazellit dhe Direktivat e BE-së në fushën e rregullatës dhe mbikëqyrjes bankare. Në

këtë kontekst, Gubernuratori Hamza shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e cmuar që BQK-së i kanë dhënë Qeveria Gjermane dhe taksapaguesit gjermanë në përgjithësi, nëpërmjet asistencës teknike të implementuar nga GIZ, që synon përmirësimin e operacioneve të BQK-së dhe rritjen e kapaciteteve teknike dhe njerezore të stafit të BQK-së. (Tribuna, 26 nëntor 2014)

INFLACIONI, KËRCËNIMI I RADHËS

Presidenti i Bankës Qendrore Europiane, Mario Draghi, deklaroi javën e kaluar se është i gatshëm të blejë borxhin e vendeve anëtare. Të dhënat që do të publikohen këtë javë, do të japin një panoramë më të qartë se sa i rrezikshëm është inflacioni në ekonominë 13 trilionë euro të Eurozonës. Një Europë e ngadaltë e ka penguar të gjithë ekonominë globale gjatë viteve të fundit, ndërsa tani po kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në rënien e inflacionit në të gjithë botën.

Sipas një sondazhi të realizuar nga Reuters, analistët mendojnë se inflacioni për nëntorin do të ulet në 0.3 për qind, shumë larg objektivit prej 2 për qind të BQE. Pavarësisht normave të interesit pranë zeros në ekonominë më të mëdha

të globit dhe pavarësisht se me trilionë dollarë janë hedhur në treg nga bankat qendrore, kambanat e alarmit po bien sërish për të gjithë globin. (Zëri dhe Telegrafi, 25 nëntor 2014)



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Bajram Kelmendi nr. 15, Prishtinë, 10 000, Republika e Kosovë

Tel. +381 38 246 171

email: contact@bankassoc-kos.com

www.bankassoc-kos.com